ISSN 1857-6443

Rrjetet sociale

Të rinjtë ia "nxijnë" jetën njeri tjetrit

Fq.3

RRËSHQITJET

Poroji buzë katastrofës

Fq.6

Portieri i së ardhmes

Alban Miftari

Fq.22

www.koha.mk

Koha



Sekreti i romanit "Konti i Montekristos"

Fq.12

E PËRDITSHME INFORMATIVE · Viti XII · Numri 3284 · e hënë 5 shkurt, 2018 · 2°c | 9°c · 15 DEN

EDITORIAL

Cubat e rrjeteve sociale

Raportimet e fundit nga policia dhe gjykatat, tregojnë për një rritje shqetësuese të keqpërdorimit të rrjeteve sociale për qëllime bizare nga ana e përdoruesve. Janë të shpeshta rastet që të rinjtë rrjetet sociale i përdorin për të zënë në kurthë njëri tjetrin, duke shantazhuar me publikim fotografish apo materiale tjera kompromietuese.

Ka rrezik që ky publik i ri që po formohet në këtë mënyrë, të jetë aq shumë i lidhur pas "realitetit të tij", sa të humbë sensin e prekjes në realitetin konkret të jetës së përditshme...

Fq.2

AKTUALE

Maqedonasit heshtin, grekët protestojnë

Fq.5

SPECIALE

Legalisht nga Ballkani në Gjermani

Fq.15

PROTESTË E MADHE NË ATHINË

"DUART LARG MAQEDONISË!"

Me moton "Maqedonia është greke",protestuesit kundërshtojnë çdo lloj përdorimi të termit Maqedoni në emrin e ri që pritet të vendoset pas negociatave intensive mes Athinës dhe Shkupit zyrtar. Një sondazh i zhvilluar nga gazeta konservatore "Kathimerini" tregoi se 70 për qind e grekëve kundërshtojnë përdorimin e termit "Maqedoni" në çfarë zgjidhjeje. Demonstrantët e palëve të kundërta u përplasën në qendrën e Athinës gjatë kohës së protestës së madhe në sheshin Sintagma kundër përdorimit të emrit 'Maqedonia', shkruan gazeta greke 'Greek reporter'. Sipas raporteve, policia ka shfrytëzuar gaz lotsjellës për t'i ndarë grupet e demonstrantëve

Fq.16

U nda nga jeta albanologu Remzi Nesimi

Në orët e vona të datës 3 shkurt u nda nga jeta, gjuhëtari, pedagogu dhe studiuesi Prof. Dr. Remzi Nesimi. Ceremonia e varrimit u bë dje në varrezat e fshatit Odri, Tetovë.

Prof.dr.Remzi Nesimi, ishte pjesëmarrës – delegat në Kongresin e Drejtshkrimit në Tiranë, të mbajtur më vitin 1972, ku mbajti edhe referatin: "Procesi i njësimit të shqipes letrare në Maqedoni". Është personalitet i shquar i botës intelektuale shqiptare i cili ka dhënë kontribut të çmueshëm në shkencat filologjike, në fushën e dialektologjisë, duke promovuar me intelektualizëm të pashoq pasuritë shpirtërore e gjuhësore dhe kulturës shqiptare në përgjithësi. Prof.dr.Remzi Nesimi lindi në fshatin Odri të Tetovës, më vitin 1933. Shkollën e mesme e kreu në Tetovë, të lartën dhe studimet pasuniversitare në Universitetin e Beogradit...

Fq.3

EDITORIAL

CUBAT E RRJETEVE SOCIALE

Emin AZEMI

Raportimet e fundit nga policia dhe gjykatat, tregojnë për një rritje shqetësuese të keqpërdorimit të rrjeteve sociale për qëllime bizare nga ana e përdoruesve. Janë të shpeshta rastet që të rinjtë rrjetet sociale i përdorin për të zënë në kurthë njëri tjetrin, duke shantazhuar me publikim fotografish apo materiale tjera kompromettuese.

Ka rrezik që ky publik i ri që po formohet në këtë mënyrë, të jetë aq shumë i lidhur pas "realitetit të tij", sa të humbë sensin e prekjes në realitetin konkret të jetës së përditshme, por edhe heqjen dorë nga mediat e tjera, të ashtuquajtura konvencionale, ndaj të cilave, me pa të drejtë mund të ngrihet një gardh paragjykues. Derivatet e këtij realiteti virtual sot mund të ndeshen në trajta të çoroditura të përmbysjes së raporteve njerëzore dhe rrjetet social, në vend që t'i afrojnë njerëzit, ato po ndikojnë në ftohjen raporteve mesë tyre.

Askush nga pjesëmarrësit e debatit të madh sot në botë, nuk ka mundur të gjejë një përgjigje fatlume para kësaj dileme që po i mundon sociologët e mediave dhe ekspertët e shumtë të komunikimit. Në kuadër të strategjive të zhvillimit të mediave, vende të ndryshme të botës kanë provuar forma të shumta të vendosjes së njëfarë rregulli brenda standardeve të përgjithshme të komunikimit tek mediat e reja.

Gara në mes të risive teknologjike dhe formimit të publikut, do të duhej të jetë preokupimi kryesor i përpiluesve të strategjive të reja komunikimit dhe medias. Gjithkush sot e ka të qartë se mediat online po thyejnë rekorde avantazhi kundrejt mediave klasike. Mirëpo përparësitë e këtij avantazhi nuk i merr si favore profesionale krejt publiku, për arsye se në fushën e paanë të komunikimit virtual sot kemi një oqean përdoruesish dhe, jo pak prej tyre, po ngrenë 'principatat e tyre' të realitetit virtual.

Një përparësi tjetër shumë e ndjeshme, që pak po trajtohet si vlerë në komunikimin publik e social, është dimensioni i lirisë së shprehjes, në kushtet kur politika provon të monopolizojë hapësirën publike me të vërtetën e saj të njëanshme. Mediat e reja, që janë të pakontrollueshme nga "punëtoria partiake", gjithsesi, do t'i japin një dimension të ri lirisë së shprehjes, por edhe mundësive të pakufizuara për të ndërtuar "mirëqenie publike" pa e patur të domosdoshme ndihmën e aparatit shtetëror e institucional, me kusht që në komunikacionin e zhurmshëm të ketë kulturë të mirëfilltë qarkullimi.

Janë të shumtë në numër ata persona që po e kultivojnë identitetin e tyre qytetar, intelektual e social përmes kësaj bote virtuale dhe favori më i madh që del nga ky realitet është pamundësia e politikës së ditës për të manipuluar me këtë "masë elitare" që po e projekton refuzimin e vet jo vetëm personal, por edhe grupor. Por, në anën tjetër, është shumëzuar numri i përdoruesve pa identitet qytetar e profesional dhe pa një një profil të qëndrueshëm moral. Tallavaja e komunikimit në rrjetet sociale me paturpësinë e saj po mbërthen shumë fate njerëzish, dhe për pasojë nuk ka një ligj që ta ndalojë këtë zgjebë që po përhapet me të madhe.

Mbase, beteja për të triumfuar mbi këtë destruksion profesional, do të duhej të jetë strategjia e re e përballjes së vlerave e produkteve mediatike kundrejt deformimeve që i sjell keqmenaxhimi i tyre dhe të gjithë cubave që shantazhojnë të pambrojturit në saje të përparësive dhe lirive që jep teknologjia e re e komunikimit.

Një grusht të domosdoshëm dhe sa më urgjent ligjor e kërkon ky keqpërdorim i rrjeteve sociale.

8+1

NJË HUMBJE E MADHE!

"Njerezit e mdhenj,gjithmone kane qene modste,sepse,veprat flasin per ta,veprat jane thesari i tyre!I ketille ishte edhe prof.Remzi Nesimi!Ai gjithe jeten qendroi i heshtur,i urte,modest...Por,ai ishte i madh!Ishte intelektual,per t,ia patur lakmine...Punonte ne heshtje,por,veprat e trija,rrezatonin ne fushen e gjuhesise!Ato i dhane emer!E madheruan!E vune ne ball te studiueseve me te mire qe i njeh shkenca e gjuhesise!Ato e bene qe ne,t,i japim merita te jashtezakonshme per se gjalli dhe,sigurisht,edhe pas...!
Prof.dr.Remzi Nesimi,do te mbetet figure e madhe shkencore ne radhet e shqiptareve!Dhe,do te mburremi qe e patem!Dhe,nuk do te harrojme te themi se e patem nje intelektual model,nje profesor te devotshem,e patem nje mik qe ishte thesar! Nje humbje e madhe!Nje dhimbje e madhe! per te gjithe shqiptaret,per farefisin,per familjen! Ngushellime per te gjithe!Ngushellime per ju,z.Hatixhe,apo,Tixhe,sic ju thoshte profesori,ngushellime Ilir dhe Valbona!Ta perkujtoni me dhimbje,por,edhe me mburrje! Perendia ia falte driten e Parajses!", ka shkruar në FB, veterani i gazetarisë shqiptare Alush Kamberi

ASKUSH MË NUK FLET PËR INTERESIN E PËRGJITHSHËM

"Ndjenja e atdhedashurisë tek shqiptarët ka rënë në nivelin më të ulët dhe në pikën më kritike të mundshme.
Si mund të pritet më shumë, për këtë vend, kur ska njeri, datë, ngjarje a personalitet i këtij kombi që nuk është nëpërkëmbë.
Askush më nuk flet për interesin e përgjithshëm, as për ideale, duke harruar se shoqëria pa ideale rrezikon të zhduket, në rastin më të lehtë, tjetërsohet.
O njerëz, zgjohuni e duajeni këtë vend, qoftë edhe nëse keni shumë arsye për të mos e dashtë...!", shkruan në profilin e tij prof. Mustafa Bajrami.

ME (PA) SEBEP!

"Disa ditë më parë, lexova programin për punë (për vitin 2018), të Institutit për trashëgimi shpirtërore dhe kulturore të shqiptarëve në Shkup.
Fatkeqësisht, asgjëkund nuk gjeta asnjë paragraf dedikuar demonstratave të motit 1968 të Tetovës, sidomos tani në vigjilje të pesëdhjetëvjetorit të organizimit të tyre. Tekefundit, kjo vaki që ishte humane dhe po aq emancipuese, asokohe lëre që ua prishi rehatinë politikanëve shovinist por, njëkohësisht tronditi sistemin politik të Jugosllavisë. Sot e gjithë ditën e Perëndisë, organizatorëve dhe dëshmitarëve, u mbetet të parashtrojnë pyetjen: "helbete", e gjithë kjo, është humbje a dobësim i kujtesës së njerëzve që udhëheqin këtë Institut, apo është diç tjetër. Qofsha i gabuar!", shkruan në profiline tij në FB, Fadil Lushi

MEDIACitate

A do të prishen ekuilibart mes maqedonasve dhe shqiptarëve?

"Pas Luftës së Dytë Botërore Titoja e kishte bërë të qartë se Greqia veriore, së bashku me Selanikun, duhet ti takonin Jugosllavisë. Kjo u trumbetua publikisht përsëri nga politikanët nacionalistë grekë dhe pjesëtarë të Kishës Ortodokse greke pas pavarësisë së Maqedonisë 1991. Por sot asnjë politikan serioz maqedonas nuk ka pretendime territoriale ose revizioniste," thotë ekspertin gjerman të historisë, Stefan Troebst, duke shtuar se për grekët antikë, maqedonasit shiheshin si barbarë. Andaj Greqia duhet të jetë më e hapur ndaj kontestit të emrit.
Të qenurit qendra dhe nyja e Ballkanit, ndaj Maqedonisë në të kaluarën kanë pasur pretendime aneksuese të gjithë fqinjët.
"Shtetet fqinje e kanë njohur shtetin e Maqedonisë, por do të ishte mirë që ta njihnin edhe ekzistencën e kombit maqedonas.
Kjo do çtensiononte mjaft situatën në rajon." Në rast të kundërt, nëse qeveria e re socialdemokrate nuk do e zgjidhte kontestin e emrit me Greqinë, "situata do ishte më dramatike sesa dhjetë vjet më parë me qeverinë e VMRO."
Dhe rreziku këtu nuk do ishte nga ndonjë ndarje e Maqedonisë mes Athinës e Beogradit ose ndonjë okupim nga Bullgaria, por mund të prisheshin ekuilibrat mes maqedonasve sllavishtfolës dhe shqiptarëve në Maqedoni.
"Bllokimi i rrugës euro-atlantike e Maqedonisë, do i orientonte gjithmonë e më tepër shqiptarët drejt Shqipërisë, pasi ata thonë: Shqipëria vetëm është anëtare e NATO dhe ka gjasa të mëdha për tu bërë anëtare e BE, në krahasim me Maqedoninë që po qëndron në vendnumero. Atëherë mund të vinte deri te ndonjë skenar i rrezikshëm i shpërbërjes së brendshme të Maqedonisë në vija etnike" *(Der Spiegel)*

NËSE NUK E KENI DITUR...

A E DINI PSE VENDOSET PATKOI NË DERË?

Patkua kali, sy të kaltër madje edhe hudhra shpesh shohim mbi dyer të shtëpive. Në kulturën tonë hasim lloj-lloj simbole të cilat janë të varura në mure apo diku tjetër me mendimin se ai/ajo do t'i mbrojë njerëzit nga të ligat e një ndër to është edhe patkoi i kalit. Është interesante se asnjë nuk vret mendjen se si duhet të vendoset patkoi me kokë poshtë apo me kokë lart, nëse ai duhet të blihet apo duhet të gjetur diku, apo pasi të vendoset në një vend të caktuar nëse ai duhet të preket apo jo.
Ekziston një histori e cila sqaron si ka mbetur kjo simbolikë.Legjenda e patkoit të kalit në fakt është një histori e vjetër kristiane. Ajo ka ardhur në shekullin X, kur një nallban, i cili më pas, me emrin Shën Dastin, u bë peshkop i Kantërbërit në Angli, arriti t'i mbathë patkonj djallit. Ky i lutej dhe i përgjërohej nallbanit që ta linte të lirë.Legjenda thotë se djalli u lirua vetëm kur premtoi se nuk do të kapërcente kurrë një derë mbi të cilën ishte varur një patkua.Kështu nga ajo periudhë njerëzit filluan të blinin patkonj edhe pse nuk kishin kalë dhe i vendosnin kudo duke besuar se djalli nuk do të kalonte aty.Patkoi i kalit njihet gjerësisht si simbol i lumturisë. Për shkak të ndërlidhjes më kuajt, patkoi përfaqëson forcën dhe besueshmërinë. Tek

grekët, një patkua ka simbolizuar pjellorinë.Por, patkoi nga fetë dhe sidomos nga feja Islam konsiderohet si një besëtytni apo besim i kotë.

SHTOHET KEQPËRDORIMI I RRJETEVE SOCIALE

TË RINJTË IA "NXIJNË" JETËN NJERI TJETRIT

Emërues i përbashkët i të gjitha shantazheve që bëhen nëpërmjet rrjeteve sociale, duke u kërcënuar mes veti se do të publikohen foto intime me përmbajtje të turpshme, është lidhja e dashurisë apo ajo martesore mes dy personave.

Koha Omer XHAFERI

Shkup, 4 shkurt- Rrjetet social çdo ditë e më tepër po shndërrohen në një mjet shantazhi dhe kërcënimi. Raportet e përditshme të organeve të rendit tregojnë se shpesh herë keqpërdorimi i rrjeteve sociale bëhet me qëllim arritjen e një përfitimi material. Nëse deri para disa kohe rrjeti social Facebook, ishte aplikacioni on-line i cili më tepër keqpërdoroj për qëllime të ndryshme, kohëve të fundit po vërehet se edhe Instagrami, një faqe tjetër e kësaj natyre, po shënon rritje të keqpërdorimeve, të cilat nuk bëhen nga ana e administratorëve që i kanë krijuar, por siç mund të vërehet nga kallëzimet e denoncuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme, nga vetë shfrytëzuesit.

Përderisa opinioni është në pritje të publikimit të raportit të punës të MPB-së, për vitin e 2017, njoftimet e përditshme të kësaj ministrie thonë se vetëm brenda janarit të këtij viti janë regjistruar pesë raste, ku lëndë e denoncimit kanë qenë shantazhimet përmes rrjeteve sociale. Rastësi ose jo, tre nga këto pesë raste të cilët janë proceduar nga policia e shtetit, kanë ndodhur në rajonin e Pollogut, respektivisht në fshatrat Vrapçisht, Pallçisht dhe Banjicë e Poshtme. Një prej rasteve të para të kësaj natyre, të cilat policia e ka publikuar për rajonin e theksuar, është publikuar me 16 janar të këtij viti. Vepra penale për të cilët është ngarkuar një 29 vjeçar nga fshati Vrapçisht, ka të bëjë me shantazhin të cilët ky i fundi ia ka bërë një vajze nga fshati Dobërdoll, rrethinë e Gostivarit. Sipas policisë së këtij qyteti, i dyshuari B.L, ka pasur dy kërkesa ndaj vajzës, të cilat i ka kushtëzuar me publikimin e fotografive kompromettuese në rrjetet sociale. Banorja e fshatit Dobërdoll, në këtë rast nuk ka pranuar të shihet me të dyshuarin dhe aq më pak t'i jap 400 eurot e kërkuar, por rastin e ka paraqitur në polici, me çka organet e rendit kanë ngritur kallëzim penale për shantazhim ndaj personit në fjalë.

Emërues i përbashkët i pothuajse të gjitha shantazheve që bëhen nëpërmjet rrjeteve sociale, duke u kërcënuar mes veti se do të publikohen foto intime me përmbajtje të turpshme, është lidhja e dashurisë apo ajo martesor mes dy personave. Rasti i cili pason pikërisht ka të bëje më këtë problematikë. Mospëlqimi i prindërve nga fshati Pallçisht, që vajza e tyre të vazhdon lidhjen me një djalë nga fshati Poroi, të dy këto fshatra të rrethinës së Tetovës, ka ndikuar që ky i fundit të ndërmerr hapa radikale dhe ta kërcënojë të dashurën e tij me publikim të fotografe intime. Përveç këtyre shtantazhimeve, i riu nga Poroi i Tetovës, të dashurën e tij nga Vrapçisht e ka shantazhuar edhe me sigurimin e të mirave materiale (ari dhe para). Presioni i vazhdueshme dhe i papërballueshme, ka shkaktuar depresion te vajza, me çka e njëjtat ka konsumuar një numër të konsiderueshëm të barnave, dhe në gjendje të pavetëdijshme është dërguar në Qendrën Klinike në Shkup. I ballafaquar me këtë sfidë, pas rrëfimit të detajuar nga vajza, prindi H.Z nga Vrapçisht e ka denoncuar rastin në polici. Nga policia e Tetovës, lidhur me këtë rast, kanë njoftuar se protagonisti i kësaj ngjarje, M.V është thirrur në stacion të policisë, ku dhe është zhvilluar një bisedë informative, respektivisht së shpejti pritet zbardhja e rastit.

Kronika e keqpërdorimeve vazhdon edhe në muajin janar. Njësia për kriminalistikë e policisë së Gostivarit, bëri të ditur se ka ngritur kallëzim penale kundër personi M.XH (22), nga fshati Banjicë e Poshtme, nën dyshimin se ka kryer veprën penale "shantazh". Ndonëse kjo ngjarje në polici ishte regjistruar gjatë periudhës mars-prill të viti 2017, procedimi i plotë i tij ka ndodhur pothuajse një vit më vonë. Kësisoj i dyshuari, thuhet se të dashurën e tij e ka kërcënuar me publikimin e fotografive të pahijshme dhe kompromettuese, në rast se e njëjta refuzon të vazhdoi kontaktin me të. Krahas këtij kërcënimi, i dyshuari në këtë rast, në emër të dashurës së tij, ka hapur profil në rrjetin social "Instagram", ku dhe i ka publikuar fotografitë intime. Gjithashtu këto pamje ai ua ka dërguar edhe familjarëve të vajzës dhe shoqërisë më të afërt të saj. Njëkohësisht, rritja e denoncimeve për keqpërdorim të rrjeteve sociale është shënuar edhe në rajonin e Maqedonisë, juglindore. Një pjesë e statistikës së publikuar nga Sektori për Punë të Brendshme i Strumicës, tregon se gjatë vitit 2017 ato i kanë proceduar rreth 20 raste të kësaj natyre, për dallim ku në vitin 2016, gjithsej ishin regjistruar pesë kallëzimi për keqpërdorim të rrjeteve sociale. Krahas veprës penale "shantazh", ky sektor i policisë ka vepruar edhe për zbardhje të lëndë për keqpërdorim të të dhënave personale, publikimin e pamjeve pornografike të të miturve e kështu me radhë. Një pjesë këtyre padive i janë dorëzuar Prokurorisë Publike në Strumicë. Kujdesi i madh ndaj komunikimit, kur qytetarët i shfrytëzojnë rrjetet social është apeli kryesor i policisë, ku mes tjerash shtojnë se qytetarët duhet të kujdesën dhe në këto lloje të rrjeteve sociale mos të publikojnë shumë të dhëna personale.

U NDA NGA JETA ALBANOLOGU REMZI NESIMI

Në orët e vona të datës 3 shkurt u nda nga jeta, gjuhëtari, pedagogu dhe studiuesi Prof. Dr. Remzi Nesimi. Ceremonia e varrimit u bë dje në varrezat e fshatit Odri, Tetovë.

Prof.dr.Remzi Nesimi, ishte pjesëmarrës – delegat në Kongresin e Drejtshkrimit në Tiranë, të mbajtur më vitin 1972, ku mbajti edhe referatin: "Procesi i njësimit të shqipes letrare në Maqedoni". Është personalitet i shquar i botës intelektuale shqiptare i cili ka dhënë kontribut të çmueshëm në shkencat filologjike, në fushën e dialektologjisë, duke promovuar me intelektualizëm të pashoq pasuritë shpirtërore e gjuhësore dhe kulturës shqiptare në përgjithësi.

• 1972 - Remzi Nesimi në punimet e Kongresit të Drejtëshkrimit

Prof.dr.Remzi Nesimi lindi në fshatin Odri të Tetovës, më vitin 1933. Shkollën e mesme e kreu në Tetovë, të lartën dhe studimet pasuniversitare në Universitetin e Beogradit, kurse doktoraturën e mbrojti në Universitetin e Prishtinës. Punoi si lektor i gjuhës shqipe në katedrën e gjuhës dhe letërsisë shqiptare në Universitetin e Beogradit (1962-1964), pedagog i gjuhës shqipe në Akademinë Pedagogjike në Shkup (1964-1975), profesor në katedrën e gjuhës dhe letërsisë shqiptare në Universitetin e Shkupit (1975-1999). Është autor i disa librave shkencorë dhe mbi 200 artikuj në revista shkencore e periodike.

Shumë institucione e personalitet e kanë ngushëlluar familjen Nesimi, duke shprehur me këtë rast konsideratat më të thella për veprimtarinë shkencore e pedagogjike të albanologut të shquar.

STIMULIMI I PUNËTORËVE NË RAJON

KOSOVA PRIN ME PAGË MINIMALE

Shtetet në rajon me përjashtim të Kroacisë dhe Sllovenisë, kanë dallime të vogla në nivelin e pagave mesatare dhe minimale që ju paguhen punëtorëve. Kosova me pagat minimale prej 130 euro për moshën nën 35 vjeç dhe 170 euro për moshën mbi 35 vjeç ka pagat minimale më të ulëta në rajon. Nga ana tjetër , të dhënat tregojnë se Shqipëria me 300 euro ka pagën më të ulët mesatare ndër shtetet e rajonit

Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 4 shkurt - Shtetet në rajon me përjashtim të Kroacisë dhe Sllovenisë, kanë dallime të vogla në nivelin e pagave mesatare dhe minimale që ju paguhen punëtorëve. Kosova me pagat minimale prej 130 euro për moshën nën 35 vjeç dhe 170 euro për moshën mbi 35 vjeç ka pagat minimale më të ulëta në rajon. Nga ana tjetër , të dhënat tregojnë se Shqipëria me 300 euro neto ka pagën më të ulët mesatare ndër shtetet e rajonit.

Paga minimale në Maqedoni është 196 euro , ndërsa rroga mesatare e paguar në muajin nëntor ishte 23 196 denarë apo 378 euro. Sipas statistikës së Drejtorisë për të ardhura publike në muajin shtator në Maqedoni 88.000 qytetarë kanë fituar pagën minimale prej 12 mijë denarë.

Sipas analizave të Organizatës së punëdhënësve të Maqedonisë, me ndryshimet e fundit të ligjit për pagë minimale që sollën rritjen e dukshme të saj, nëse sipas dispozitave ligjore në vitin 2012, lartësia e pagës minimale përcaktohej në afër 39.6 për qind të pagës mesatare neto të realizuar në vitin paraprak, tani vlera e pagës minimale është afër 53 për qind e pagës mesatare të realizuar një vit më parë. Ekzekutivi i ri ka premtuar se deri në fund të mandatit apo deri në vitin 2020, paga minimale do të rritet në 16 mijë denarë, ndërsa ajo mesatare në 30 mijë denarë. Ekonomistët thonë se me rritje më të madhe ekonomike dhe investime më të mëdha që nënkuptojnë edhe hapjen e vendeve të punë mund të arrihet një objektiv i tillë ambicioz. Sipas analizave të Institutit Finance Think, paga minimale deri në vitin 2020 mund të tejkalojë 13 mijë denarë , ndërsa ajo mesatare të arrijë 26.500 denarë. " Nëse kemi rritje të përshpejtuar ekonomike dhe investime që do të nxisin këtë rritje ekonomike, atëherë mund të presim rritje të pagës mesatare edhe mbi shumën e lartë përmendur. Megjithatë 30 mijë denarë pagë është e mundur, por duhet të shohim se si politikat ekonomike që do të ndërmerren do të pasqyrohen ndaj ekonomisë në përgjithësi. Kjo është e mundur, por nën supozime të caktuara se rritja ekonomike do të jetë më e lartë dhe nëse politikat ekonomike e nxisin biznesin të investojë më shumë" thonë nga të Instituti Finance Think.

Nga ana tjetër, qytetarët e Kosovës për punën që bëjnë paguhen mesatarisht 400 dhe 500 euro. Kjo sipas raportit që ka nxjerrë Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), për anketën e fuqisë punëtore. Paga neto mesatare në Kosovë për sektorin publik është mbi 420 euro në muaj, derisa, ndërsa sipas të dhënave të organizatave ekonomike në sektorin privat, paga mesatare është rreth 349 euro.

Paga mesatare në Shqipëri për të punësuarit në sektorin shtetëror në vitin 2017 , ishte 60 mijë lekë apo 448 euro bruto . Sipas statistikës zyrtare apo INSTAT, paga mesatare mujore bruto për një të punësuar me pagë sipas grup-profesioneve dhe gjinisë në fund të vitit 2016 ishte 45,845 lekë, që është 342 euro bruto apo afër 300 euro neto. Prej muajit maj të vitit të kaluar në Shqipëri, paga minimale mujore për punonjësit, është 24,000 lekë apo 179 euro dhe është rritur vitin e kaluar për 2000 lekë.

Në ndërkohë, paga minimale e caktuar me vendim të Qeverisë së Kosovës në vitin 2011, nuk ka ndryshuar që nga ajo kohë, përkundër shtrenjtimit të jetesës në vitet e kaluara . Paga minimale në Kosovë ka mbetur 130 euro për të punësuarit e moshës nën 35 vjeç, dhe 170 euro për të punësuarit e moshës mbi 35 vjeç. Në fillim të këtij viti , Këshilli Ekonomik Social i ka propozuar Qeverisë së Kosovës rritjen e pagës minimale, nga 130 dhe 170 euro sa ka qenë deri tani, në 250 euro. Palët që arritën marrëveshjen, shprehen të gatshme të punojnë për zbatimin e saj. Paga minimale në Kosovë mund të rritet në 250 euro, nëse propozimi i Këshillit Ekonomik-Social miratohet nga Qeveria.

Ndryshe, paga mesatare në Mal të Zi është 510 euro , ndërsa ajo minimale është 193 euro , që si vlera janë mbi mesataren e shteteve të tjera të rajonit. Në Bosnje dhe Hercegovinë paga minimale është 208 euro, ndërsa mesatare është 438 euro. Në Serbi paga minimale është 213 euro, ndërsa paga mesatare është 403 euro. Paga mesatare në Kroaci është 812 euro , ndërsa minimale është 366 euro, ndërsa në Sllloveni paga minimale është 614 euro, ndërsa paga mesatare është 1.151 euro.

NEGOCIATAT RRETH EMRIT

ATHINA NDRYSHON KURSIN

Marrëveshja për një emër eventual për përdorim ndërkombëtar me siguri do të thotë që ai të përdoret edhe në pasaportat dhe dokumentet e tjera të ngjashme. Këtë e deklaroi ndërmjetësuesi në kontestin për emrin midis Maqedonisë dhe Greqisë, Metju Nimic, në një intervistë për emisionin 360 Gradë. Ndaj deklaratave të tij ka reaguar ministri i Jashtëm grek Nikos Kocijas.

'Mendoj se pasaportat janë dokumente ndërkombëtare, ende nuk u jemi përkushtuar të gjitha çështjeve, por do të thosha se pasaportat janë dokumente ndërkombëtare. Nëse ka marrëveshje për modifikimin e emrit do të jetë e zbatueshëm për dokumentet si pasaportat', deklaroi ndërmjetësi Metju Nimic.Por, kjo është ndoshta e vetmja përgjigje konkrete e Nimicit, i cili ishte shumë i përmbajtur pas pothuajse të gjitha detajeve rreth negociatave, duke përfshirë edhe pyetjen nëse palës greke më shumë i përshtatet zgjidhja me ndryshime në Kushtetutën e Maqedonisë.'E hapën këtë çështje, edhe publikisht e dëgjova prej tyre. Nëse kjo është ligjërisht e domosdoshme për zbatimin e detyrimeve që mund të merren përsipër... Pasi ende nuk ka një marrëveshje, nuk e dimë se çfarë ka në marrëveshje. Por ky është pozicioni', sqaroi ai.

Nimic ka përshtypjen se ekziston ende shqetësim te të dyja palët, nëse tjetra do t'i përmbushë detyrimet e një marrëveshje eventuale. Prandaj kërkoi që të kapërcehet historia e mosbesimit ndërmjet vendeve. Gjatë vizitës në Shkup, Nimic tha se nuk kishte dëgjuar asgjë nga pala greke që do të thotë mohim i identitetit.

Ndaj deklaratave të tij ka reaguar ministri i Jashtëm grek Nikos Kocijas. Ai në ueb faqen e Ministrisë së Jashtme greke shkruan se Nimic nuk ka autoritet për të folur cila është politika e Athinës, aq më pak për ta përshkruar atë në mënyrë jokorrekte.Shefi i diplomacisë greke beri te ditur se ka komunikuar me Nimic mbi kornizën brenda te cilës duhet te zhvillohen negociatat.

"Realizova bisedë të gjatë me të dërguarin për ndërmjetësim të KB-së, Matthew Nimetz, i cili u kthye nga Shkupi. I kam theksuar atij në mënyrë të qartë dhe rigoroze se nuk është kompetent për të folur për politikën e Athinës, as për ta përshkruar atë qoftë dhe në mënyrën e gabuar."

"Në bazë të takimit që kam pasur, dhe në bazë të diskutimeve të z. Nimetz në Shkup, e kam bërë shumë të qartë se negociatat vazhdojnë vetëm në përputhje me atë që është rënë dakord në Davos."

Përplasja mes ndërmjetësit të OKB-së dhe Kotzias, vijnë vetëm pak orë pas letrave kërcënuese adresuar ministrit të Jashtëm, Koztias dhe katër ministrave të tjerë të qeverisë greke, kundër zgjidhjes së çështjes së emrit. Ndërkohe në Athinë është mbajtur protesta kundër negociatave mes dy vendeve per zgjidhej e konfliktit 25 vjeçar te çështjes së emrit.

TURBULERNCA NË RELACIONIN SHKUP-ATHINË

MAQEDONASIT HESHTIN, GREKËT PROTESTOJNË

Mungesa konsensusit paraprak politik nga të gjitha palët në të dyja vendet, darkodimi që nocioni Maqedoni të jetë në emrin e ri të shtetit, si dhe deklarata e negociatorit Metju Nimic dhe Ministrit të Jashtëm të Maqedonasë, Nikolla Dimitrov se identiteti nuk është temë e bisedimeve, ka bërë që në Greqi të nxiten reagimeve të ashpra në opinion publik që kulmuan me një protestë masive të dielën në Athinë. Në këtë proteste morën pjese edhe partia opozitare "Demokracia e Re" dhe ajo në pushtet "Grekët e Pavarur"

Koha — Fatos RUSHITI

Shkup, 4 shkurt-Bisedimet intensive rreth zgjidhjes së kontestit të emrit mes Maqedonisë dhe Greqisë me ndërmjetësimin e OKB-së, nuk po priten mirë në të dyja vendet nga ana e grupeve të qytetarëve dhe partive politike. Përderisa në Maqedoni mbizotëron heshtje, ndërsa pozita dhe opozita negociojnë fshehtas për kthimin e kësaj të fundit në Parlament që të kontribuojë në agjendën reformuese, në Greqi atmosfera politike është tensionuese e shoqëruar me protesta dhe zëra kritik në opinion. Në sheshin "Sintagma" të Athinës të dielën u mbajt protesta më masive deri më tani nën moton "Maqedonia Greke". Kjo protestë u mbështet edhe nga Demokracia e Re dhe lideri i saj Kiriakos Micotakis, ndërsa merrnin pjesë edhe partia në koalicionin qeveritar "Grekët e Pavarur", si dhe klerët e Kishës Ortodokse Greke.

"MAQEDONIEPËRME" E PAPRANUSHEM PËR GREKËT

Si duket ngutja e Athinës zyrtare dhe Shkupit zyrtar për të negociuar intensivisht çështjen e emrit, duke bërë pak ose asgjë paraprakisht për të ndërtimin e konsensusit të brendshëm politik, nuk do të kalojë mirë drejt në zgjidhje pozitive. Pranimi i nocionit Maqedoni ne emrin e ri të cilët grekët pretendojnë se është nocion antik grek, nga njëra anë, dhe nga ana tjetër pas dakordimit jozyrtar mes të dyja Qeverive për emrin "Maqedoniaepërme", po jep efektin e vet menjëherë. Kjo pasi "Maqedoniaepërme", përsëri duket që nuk krijon distancë të kombit maqedonas dhe shtetit të Maqedonisë me Maqedoninë antike, ndërkaq ndryshe do të ishte në rast se do të arrihej ndonjë kompromis në lidhej me termin Maqedoni e Vardarit apo Republika e Maqedonisë (Shkupi) dhe që mos të thirret askush në maqonasit antik dhe Maqedoninë antike. Nxitje të zërave kritik në politikanët grek pati edhe deklarata e Minitrit të Punëve të jashtme të Maqedonisë Nikolla Dimitrov se nuk po negociohet për identitetin e kombit maqedonas dhe po në të njëjtën vijë ishin edhe deklarimet e negociatorit Metju Nimic se identiteti nuk është temë e bisedimeve. Në këtë pikë palët negocuese nuk dhanë asgjë për opinion se si do të quhen maqedonasit në kushtetutë, ligje, dokumentet personale dhe në të gjitha shkresat zyrtare. Nuk ka informacione as nëse është biseduar dhe janë dakorduar se si do të quhen maqedonasit në librat shkollor në të gjitha nivelet e arsimit gjegjësisht nëse do të ketë distancim nga maqedonasit sllav nga ato antik.

ATHINA ZYRTARE SHQETËSOHET PËR ERGA OMNES

Shqetësime po kështu për përdorim të brendshëm ka pasur zëdhënësi i qeverisë greke Dimitris Xanakopulos. Ai ka thënë për MIA-n tha se në negociatat Athina mendon se ekzistojnë tre çështje të ndryshime për të cilat bisedon.

"E para është emri i ndërlikuar. E dyta është ajo që e quajmë erga omnes gjegjësisht ndaj të gjithëve, emër i ndërlikuar për përdorim të gjithanshëm, që e përfshin edhe fqinjin, që do të thotë se është e nevojshme revizion kushtetues, që të mund erga omnes të realizohet. Dhe e treta është ajo që ka të bëjë me irredentizmin, që gjithashtu lidhet me revizionin kushtetues. Mendoj se do të jetë mirë të mos e parashikojnë rezultatin dhe të mos vendosin linja të kuqe", ka deklaruar zëdhënësi Dimitris Xanakopulos.

Të shtunën e kaluar edhe në Selanik, protestuan me mijëra veta duke bllokuar për 2 orë rrugët e qytetit dhe duke kërkuar që propozimi për zgjidhjen e kontestit me emrin të mos përmbajë fare termin "Maqedonia". Në opinion grek po bëhen dhe anketa ndërsa ajo e fundit dallon për nga përqindja me anketën e vitit 2017 të të njëjtit medium në lidhje me atë se sa përqind e grekëve duan zgjidhje me ose pa termin Maqedoni. Vetëm 22.5% e grekëve pranojnë një emër të bindshëm ndërsa 7 në 10 të anketuar ose 71.5% prej tyre duan zgjidhje pa termin Maqedoni, tregojnë kështu hulumtimet e opinionit publik nga Universiteti i Selanikut dhe fondacioni për politikë të jashtme që të dielën i ka bërë publike gazeta Ketimerini. Në vitin 2016 në të njëjtën përgjigje përqindja që nuk e kanë pranuar termin Maqedoni ka qenë 57% derisa të pranueshëm kanë qenë 37% nga të anketuarit në anketë qytetarët grek janë pyetur edhe në të se tentativat e shtete dhe organizata shkojnë në favor të grekëve dhe maqedonasve ndërsa shumica kanë thënë se shkojnë në favor të maqedonasve dhe shumë më pak në favor të grekëve.

"FUQITË E MËDHA NË ANËN E MAQEDONASVE", MENDOJNË GREKËT

Në lidhje me rolin e Bashkimit Evropian në zgjidhjen e çështjes se emrit, 38.5% e grekëve mendojnë se aktivitetet e BE janë në favor të dy vendeve, 32% në favor të Maqedonisë, 5.5% në favor të Greqisë dhe 24% nuk kanë përgjigje. Lidhur me rrolin e SHBA-së 38% në favor të Maqedonisë, 27% në favor të dy vendeve, 5% në favor të Greqisë dhe 30% nuk kanë përgjigje. Për Gjermaninë 33.5% në favor të Maqedonisë, 24.5 në favor të dy vendeve, 55% në favor të Greqisë, dhe 36.5%nuk kanë përgjigje. Për rolin e OKB në këto bisedime 37% në favor të dy vendeve, 29% në favor të Maqedonisë, 5% në favor të Greqisë dhe 29% nuk kanë përgjigje. Për Rusinë 21.5% në favor të dy vendeve, 20.5% në favor të Maqedonisë, 18% në favor të Greqisë dhe 40% nuk kanë përgjigje. Për rrolin e NATOS : 32.5% në favor të Maqedonisë, 28.5% në favor të dy vendeve, 7% në favor të Greqisë dhe 32% nuk kanë përgjigje. Ndryshe në opinionin maqedonas për dallim nga grekët që janë skeptik dhe nuk duan nocionin "Maqedoni" në emrin e ri të shtetit, maqedonasit janë pro që emri të ndërrohet dhe Maqedonaia të hyj shpejtë në NATO dhe në BE-së edhe prej 61 % e të anketuarve (43 tërësisht, ndërsa 18 për qind deri diku).

Kjo sipas rezultateve të anketës telefonike në 1.000 të anketuar e zbatuar prej 19 deri më 26 janar nga M-Prospekt për Institutin për Demokraci Societas Civilis Shkup. Mbështetje për ndryshimin e emrit me qëllim të hyrjes në BE dhe NATO kanë shprehur 50 për qind e maqedonasve (30 për qind tërësisht, ndërsa 20 deri diku), ndërsa 95 për qind e shqiptarëve (84 tërësisht, ndërsa deri diku 11 për qind). Në pyetjen nëse me ndryshimin e emrit do të ndryshojë edhe rëndësia e asaj çfarë është Maqedonia dhe populli maqedonas, 34 për qind janë përgjigjur se tërësisht do të ndryshojë, 19 se deri diku do të ndryshojë, 33 për qind se aspak nuk do të ndryshojë, ndërsa katër për qind se deri diku nuk do të ndryshojë. Për 60 për qind të maqedonasve të anketuar me ndryshimin e emrit do të ndryshojë edhe identiteti (për 40 për qind tërësisht, ndërsa për 20 deri diku), ndërsa 35 për qind e konsiderojnë të kundërtën. Tek shqiptarët 30 për qind vlerësojnë se do të ndryshojë (13 tërësisht, ndërsa 17 pjesërisht), ndërsa 48 për qind janë se identiteti aspak nuk do të ndryshojë dhe 10 për qind plotësues se deri diku nuk do të ndryshojë.

NEVOJA PËR NJË TAKIM TË RI ZAEV - CIPRAS

Ndryshe mediat greke nuk kanë përjashtuar mundësinë e një takimi të ri mes kryeministrit të Maqedonisë Zoran Zaev dhe atij grek Aleksis Tsipras. "Huffingtonpost" duke u thirrur në burime diplomatike, paralajmëron intensifikim të bisedimeve duke mos përjashtuar që deri ne mesin e muajit shkurt të përpilohet edhe draft marrëveshja ndërkombëtare rreth zgjidhjes së kontestit për emrin e Maqedonisë. Sipas Huffingtonpost, fillimi i muajit mars mund të jetë vendimtar, kur edhe pritet të dihen rezultatet e negociatave për emrin. Duke u thirru në burime diplomatike, mediat greke raportojnë se Qeveria greke është për propozimin "Gorna Makedonia" ndërsa ajo maqedonase për "Nova Makedonia". Megjithatë, ndërmjetësi i OKB-së, Metju Nimic ka hedhur poshtë zërat se palët janë përcaktuar për opsionet e mundshme.

RRËSHQITJET BLLOKOJNË DISA RRUGË

POROJI BUZË KATASTROFËS

Edhe rreshjet më të vogla në fshatin Poroj lënë pasoja të mëdha. Reshjet e djeshme kanë shkaktuar rrëshqitje të dheut në pjesën më të lartë të këtij fshati, ku për pasojë është bllokuar rruga për në fshatin Gjermë. Në ndërkohë rrëshqitja e dheut ka dëmtuar edhe një mur mbrojtës të një shtëpie aty afër.

Koha Urim HASIPI

Tetovë, 4 shkurt -Reshjet e shiut gjatë ditës dhe natës së kaluar nuk kanë kaluar pa probleme në territorin e komunës së Tetovës.Më vështirë ka qenë në rrugën për në Banjën e Tetovës ku edhe kësaj radhe ka patur rrëshqitje të dheut dhe shkëmbinjëve. Në këtë pjesë të qytetit të Tetovës momentalisht mund të qarkullohet vetëm në njërën pjesë të rrugës kurse tjetra vazhdon të jetë e bllokuar.Në ndërkohë reshjet e shiut mbrëmë kanë bërë që të bllokohet rruga Shipkovicë-Brodec në vendin e quajtur Përroi i Madh. Në këtë pjesë si zakonisht kur ka rreshje bllokohet ky aks rrugor. Qarkullimi për automjete vazhdon të jetë i vështirë.

Në ndërkohë nga komuna e Tetovës sot kanë dhënë detaje lidhur me situatën gjatë natës së kaluar në Tetovës.

"Si pasojë e reshjeve të konsiderueshme të shiut të cilat këto ditë kanë kapluar pjesën më të madhe të vendit, shërbimet komunale kanë intervenuar në disa pika ku si pasojë e prurjeve të dheut ka pasur veshtirësi në qarkullimin e lirë të automjeteve dhe qytetarëve. Në mënyrë preventive është intervenuar përgjatë rrjedhës së lumit në fshatin Poroj ku është dëmtuar një urë për këmbësorët dhe në disa pika kritike nëpër qytet. Ekipet intervente janë duke punuar në rrugën e Banjës, ku në disa pjesë ka rrëshqitje të dheut dhe shkëmbinjve. Në rrugën Shipkovicë-Brodec në lokacionin Përroi i Madh qarkullimi i automjeteve realizohet me vështirësi dhe po intervenohet me maqineri përkatëse me qëllim të sigurimit të qarkullimit të lirë dhe pa pengesa. Në Reçicë të Madhe situata paraqitet e qetë dhe nën kontroll dhe po vëzhgohet në vazhdimësi nga ekipet komunale", deklaroi Blerand Rexhepi-komuna e Tetovës.

Ndërkaq rrëshqitja e dheut ka shkaktuar probleme edhe në pjesën mbi lagjen Potok ku disa shtëpi janë të rrezikuar nga rrëshqitja e dheut.Ekipet e njësisë së zjarrfikësve kanë dalur në terren ndërsa situata është kritike.Edhe rreshjet më të vogla në fshatin Poroj lënë pasoja të mëdha.Rreshjet e djeshme kanë shkaktuar rreshqitje të dheut në pjesën më të lartë të fshatit Poroj ku për pasojë është bllokuar rruga për në fshatin Gjermë.Në ndërkohë rrëshqitja e dheut ka dëmtuar edhe një murr mbrojtës të një shtëpie aty afër.Dëmi është i madh në këtë pjesë të fshatit Poroj dhe i njejti përllogaritet rreth 10 mijë euro.Ata kërkojnë që edhe komuna edhe qeveria të mbajë premtimet e dhëna për këtë fshat që do të evintonte vërshimet."Kemi rrëshqitje të dheut në pjesën e lartë të fshatit ku është bllokuar rruga për në fshatin Gjermë.Poashtu është dëmtuar edhe një urë në mes të fshatit, kurse dëme ka edhe në bujqësi.Kjo është duke ndodhur çdo herë kur ka rreshje që të kemi dëme.Nuk janë marrë masat që janë premtuar për këtë vit dhe ne jemi në mëshirë të vet natyrës por mund të ndodh edhe më keqja", tha Sulejman Ramadani, kryetar i Bashkësisë Lokale të fshatit Poroj.

Banorët thonë se gjatë tërë kohës janë të kërcënuar nga vërshime më të mëdha me pasoja katastrofale. Në këtë fshat prej mbrëmë edhe uji nuk është i pijshëm.Banorët me ujë furnizohen nga çezmat e fshatit, pohojnë nga bashkësia lokale e fshatit Poroj. Sikundër dihet, ky fshat më së shumti goditet kur ka rreshje të shiut më të mëdha kurse si zakonisht një urë në mes të fshatit çdoherë dëmtohet. Lumi Ponika në fshatin Dobrosht, në rajonin e komunës së Tearcës, ka shkaktuar vërshime gjatë rrjedhës së saj në fund të fshatit. Në këtë pjesë të këtij fshati ky lum i vogël ka sjellur me vete sasi të mëdha të rërës dhe mbeturinave të cilët kanë bllokuar gypin që ndodhet në aksin rrugor Tetovë-Jazhincë dhe uji ka dalur mbi sipërfaqe. Banorët janë shprehur se pasojat janë nga faktori njeri sepse hidhen mbeturina dhe shtrati i vogël i këtij lumi për pasojë vërshon. Në ndërkohë banorët shprehen se zgjidhja është që lumi të kthehet në shtratin e vjetër sepse në të ardhmen mund të ketë vërshime me pasoja më të mëdha.

Rritet niveli i lumenjëve në Maqedoni

Reshjet e shiut gjatë ditës së djeshme e kanë rritur nivelin e të gjithë lumenjve në vend dhe janë të mundshme vërshime lokale. Sasi më të mëdha të shiut kanë rënë në pjesën perëndimore të Maqedonisë. Sipas DPHM reshje të shiut ka pasur në Llazaropole 92 litra në metër katror, Mavrovë 71, Pozharan 68, Krushevë 65, Tetovë 52, Shkup 48, Dibër 43, Ohë 38, Pretor 34, Manastir 26, Prilep 25, Berovë 18, Kriva Pallankë 17, Vinicë 8, Demir Kapi 7, Strumicë dhe Shtip 6, Dojran 4 dhe Gjevgjeli 3 litra në metër katror.
Nivelet e lumenjve janë shtuar veçanërisht në pjesët e sipëme të lumit Vardar dhe rrjedhat e saj në rajonin e Pollogut, pjesa e sipërme e lumit Treska, lumi Radika, Drini i Zi, Sateska, Lumi i Madh dhe lumenjtë tjerë në rajonin e Prespës, si dhe pjesa e sipërme e Lumit të Zi.

NGRITJA E VETËDIJES PUBLIKE

MASA PËR ULJEN E VDEKSHMËRISË SË FOSHNJAVE

Nuk ka të dhëna se sa fëmijë kanë vdekur në Maqedoni vitin e kaluar, ndërsa në vitin 2016, sipas të dhënave të Entit Shtetëror për Statistikë, prej një mijë foshnjave të lindura të gjalla, kanë vdekur 11,9 për qind foshnja jo më të vjetër se një vit.

Shkup, 4 shkurt - Afatshkurtra deri në tre muaj dhe afatgjata deri në gjashtë muaj janë masat që planifikohen për të reduktuar në minimum vdekshmërinë e foshnjave dhe lehonave në Maqedoni. Pakoja është përgatitur në bashkëpunim me Fondin për Popullsi të Kombeve të Bashkuara (UNFPA) dhe sot i prezantoi ministri i Shëndetësisë, Venko Filipçe, i cili, tha, beson fuqishëm se do ta përmirësojnë kujdesin e përgjithshëm për nënat dhe foshnjat e tyre derisa janë në spital. Mungesa e vendeve për lindje dhe mungesa e kujdesit shëndetësor në kohë për lehonat është shkaku kryesor për vdekjen e tyre, ndërsa përqindja më e madhe nga foshnjat e vdekura është për shkak peshës së tyre të vogël gjatë lindjes dhe lindjes së parakohshme.

Në masat afatshkurtra përgatiten udhëzime për ndjekjen e kushteve të rrezikshme gjatë shtatzënisë, si dhe udhëzimet klinike për trajtimin e sepsës, problemet me koagulimin e gjakut gjatë shtatzënisë dhe gjatë lindjes, udhëzime si të veprohet gjatë tensionit të lartë të gjakut të nënës kombinuar me nivele të larta të proteinave në gjak. "Këto ndërlikime janë shkaqet kryesore të vdekshmërisë së lehonave, ndërsa në Republikën e Maqedonisë mungojnë udhëzimet klinike për të vepruar në situata të tilla që janë kërcënim për jetën", tha Filipçe.

Pjesë e masave është edhe përgatitja e një metodologjie me të cilën do të zbulohen shkaqet reale të vdekshmërisë dhe komplikimeve serioze edhe te lehonat edhe te foshnjat sipas standardeve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë. Me miratimin e standardeve për ordinancat gjinekologjike, spitalet klinike në Tetovë, Shtip ose Manastir do të ofrohen shërbime të cilësisë të njëjtë, si në Klinikën e Obstetrikë në Shkup, e cila është e mbingarkuar për shkak të ridërgimeve, kështu që ka rreth gjashtë mijë lindje në vit , vend të 3500 deri në 4000. Për vendet e lindjes në nivel sekondar do të blihet pajisje adekuate e cila mungon, Në çdo kohë në institucionet shëndetësore të lindjes, tha ministri duhet të ketë ilaçe për shpëtimin e jetës për nënat dhe foshnjat, në pajtim me listën e OBSH-së dhe UNFPA-s. Në tre muajt e parë, gjithashtu, do të realizohen trajnime të trajnuesve për kujdes efikas të foshnjave të sapolindura dhe shërbimet dhe do të vendosen shërbime mobile gjinekologjike - obstetrike për kategoritë e rrezikuara të qytetarëve. Rregullisht do të zbatohet edhe vaksinimi, si dhe skriningu për kancerin e qafës së mitrës. Segment i rëndësishëm është ngritja e vetëdijes publike dhe edukimi i nënave të ardhshme se si të njohin dhe ballafaqohen rreziqet gjatë shtatzënisë. Filipçe nuk ka të dhëna se sa fëmijë kanë vdekur në Maqedoni vitin e kaluar, ndërsa në vitin 2016, sipas të dhënave të Entit Shtetëror për Statistikë, prej një mijë foshnjave të lindura të gjalla, kanë vdekur 11,9 për qind foshnja jo më të vjetër se një vit. Kjo, tha Filipçe, është dy herë më shumë se mesatarja evropiane, e cila është 5,2 për qind dhe të cilën Ministria e Shëndetësisë synon ta arrijë për më së shumti dy vjet.*(RK)*

SUBVENCIONIMI I BUJQËSISË

FERMERËT KËRKOJNË MË SHUMË RREGULL

Fermerët sërish kanë përsëritur kërkesën e viteve të kaluara për kalendar të saktë të ndarjes së subvencioneve. Kërkohet edhe më shumë mirëkuptim dhe rritje e komunikimit me Agjencinë Pagesore që paguan subvencionet si dhe vendosja e komisionit të shkallës së dytë brenda këtij institucioni që bujqit të mos enden nëpër gjykata për gabime të caktuara

Koha — Fisnik PASHOLLI

Shkup, 4 shkurt - Fermerët sërish kanë përsëritur kërkesën e viteve të kaluara për kalendar të saktë të ndarjes së subvencioneve. Kërkohet edhe më shumë mirëkuptim dhe rritje e komunikimit me Agjencinë Pagesore që paguan subvencionet si dhe vendosjen e komisionit të shkallës së dytë brenda këtij institucioni që bujqit të mos enden nëpër gjykata për gabime të caktuara që ndodhin lidhur me procedurat e subvencioneve.

Këto vërejtje u parashtruan para disa ditësh në debatin e tretë me radhë kushtuar Propozim programit për zhvillimin e bujqësisë 2018-2022. Bujqit kanë kërkuar edhe stimulime më të mëdha për krijimin e kooperativave bujqësore, uljen TVSH-së për ilaçet e kafshëve dhe shërbimet e veterinarëve, masa për grumbullimin intervenues të prodhimeve bujqësore me qëllim të mbrojtjes së bujqve në rast të problemeve me plasmanin.

Problemi me plasmanin pritet të zbutet përmes fondit me vlerën prej së paku 6 milion euro, në periudhat kur shfaqen telashet e shitjes së prodhimeve të caktuara bujqësore.

Kërkohet edhe rregullimi i procedurave administrative me rregullore të veçanta, miratimi i kalendarit të subvencionimit që ato të paguhen në kohën kur më së shumti ju nevojiten bujqve, përmirësimi i komunikimit të bujqve me Agjencinë pagesore që është kompetente për pagesën e subvencioneve, ndërsa kërkohet që të ketë komision të shkallës së dytë që do të shqyrtojë ankesat e bujqve dhe jo që ata të enden nëpër gjyqe për lëshime të caktuara.

Në ndërkohë nga Federata e Fermerëve të Maqedonisë thonë se subvencionet dhe mënyrat e tjera të përkrahjes duhet bazohen në nevojat e vërteta të bujqve, duke mundësuar zbutjen e dialogut negativ, ose dialogut mos-ekzistues midis bujqve dhe grumbulluesve.

Nevojitet edhe pagesa me kohë e subvencioneve dhe dëmeve nga ngricat pranverore në pemëtari dhe vreshtari me qëllim që të ruhet dhe zhvillohet bujqësia .

"Të gjithë ne dhe sidomos bujqit, duhet të punojmë në tejkalimin e barrierave tradicionale që pengojnë zhvillimin e grave dhe të rinjve në mjediset rurale. Duhet edhe publikisht të flitet se vendbanimet tona rurale ballafaqohen me probleme të mëdha, qasje të kufizuar ndaj institucioneve kompetente, institucioneve arsimore dhe shëndetësore dhe një infrastrukturë jo edhe aq të mirë. E gjithë kjo rezulton me nxitjen e mërgimit, ose të rinjtë vite me radhë ikin nga fshati në qytete, ndërsa tani edhe në shtetet e tjera duke kërkuar ekzistencë më të mirë", thotë kryetarja e Federatës së Fermerëve të Maqedonisë, Vaska Mojsovska.

Sipas saj, viti i kaluar ishte një ndër më të vështirët për bujqit për shkak se dëmet nga ndryshimet klimatike ishin shumë të mëdha, ndërsa sërish çmimet e ulëta grumbulluese ose plasmani ishte problem i madh për fermerët për shkak të problemeve me prodhimtarinë jo të kontraktuar.

Në ndërkohë, prej muajit qershor pritet që më në fund të rikthehet tarifa e naftës së gjelbër për bujqit, që ata si masë e kërkojnë vite me radhë. Kjo do të thotë se fermerët do të paguajnë dizelin për 50 për qind më të lirë për traktorët e tyre. Planifikohet që çdo bujk të fitojë kartelë elektronike nga ana e Agjencisë për Përkrahje Financiare apo institucionit që ndan subvencionet, me të cilën do të mund të blejë sasi të caktuar në pompat e benzinës.

Për mbështetjen e kësaj masa nga buxheti i shteti për këtë vit ndahen 5 milion euro, ndërsa bujqit në varësi prej kulturës që e mbjellin do të fitojnë më së shumti nga 4 mijë denarë për hektar. Shuma do të përcaktohet në bazë të mjeteve të harxhuara për prodhimtari bujqësore ose të grupeve të prodhimeve të shfrytëzuara për përpunimin e tokës përgjatë një viti prodhues. Ndryshimet e Ligjit për bujqësi dhe zhvillim rural , përmes të cilëve do të vendoset masa e bashkëfinancimit për furnizim me karburant për mekanizimin bujqësor, pritet të kalojnë në mbledhjen qeveritare deri në fund të këtij muaji dhe pastaj të zhvendoset në procedurë kuvendore. Pas miratimit në Kuvend, bujqit do të mund të konkurrojnë për këtë masë deri në përfundimin e afatit për programet për mbështetje të bujqësisë, apo deri në 15 maj të vitit 2018, thonë nga Ministria e Bujqësisë.

Sivjet do të fillojnë të zbatohen dhe ndryshimet ligjore sipas të cilave grumbulluesit do të paguajnë tatimin personal për bujqit prej të cilëve kanë grumbulluar prodhime bujqësore. Shuma pritet të kalkulohet në çmim dhe do të vlejë vetëm për fermerët që bujqësinë e kanë veprimtari themelore dhe jo dytësore. Bujqit me të ardhura deri në një milion denarë, në fillim të vitit do të fitojnë kthim të tatimit që paraprakisht ju është ndalur në 12 muajt paraprak. Pritet që rreth 65 mijë bujq në fillim të çdo viti të fitojnë në llogarinë e tyre shumën e barabartë me tatimin që iu kanë ndaluar paraprakisht. Në ndërkohë më shumë shoqata të bujqve janë ankuar se një dispozitë e tillë ligjore nuk është saktësuar sa duhet, dhe mund të nxisë probleme shtesë gjatë grumbullimit të prodhimeve bujqësore si dhe të stimulojë zhvillimin e ekonomisë informale.

Ministria e Bujqësisë gjithashtu propozon që të mos vlejë më kushti për pagesën e borxheve të mbetura për fermerët që nuk janë nga fusha e bujqësisë me qëllim që të mos humbin të drejtën e subvencioneve Kërkesa pritet të fitojë dritë jeshile nga qeveria dhe parlamenti.

Në ndryshimet e propozuara parashikohet që të shlyhen borxhet që janë në kompetencën e Drejtorisë për të Ardhura Publike, ndërsa ndërlidhen me shfrytëzimin e fondeve të jashtme. Nëse miratohet ky propozim, atëherë fermerët në të ardhmen do ti fitojnë subvencionet pa dallim borxheve ndaj organeve tatimore. Për pagesë me kohë mbeten obligimet për qiranë e tokës shtetërore, shfrytëzimin e kullosave dhe ujit për vaditje si dhe koncesioneve për gjueti. Për këto pagesa ekziston e drejta e Agjencisë Pagesore që të shlyen borxhet me subvencionet e miratuara.

KRONIKË

Përleshje masive në Resnje

Në qytetin e qetë të Resnjes, është regjistruar një përleshje e madhe fizik, në të cilën kanë marrë pjesë dy grupe. Sipas raportit ditor të Ministrisë për Punë të Brendshme, në Spitalin e Manastirit, me një veturë të ndihmës së shpejtë nga Resnja, janë transferuar gjithsej gjashtë persona, prej të cilëve njëri me lëndime të rënda trupore. Pas pranimit të trajtimi të duhur mjekësor, pesë persona janë lëshuar për mjekim shtëpiak, përderisa T.K 47 vjecar, nga Resnja, është mbajtur për kurim të mëtutjeshëm, pasi ndaj tij janë konstatuar lëndime të rënda trupore, të mara nga goditja me thikë. "Ngjarja ka ndodhur mbrëmjen e 3 shkrutit, rreth orës 22:24, në hotelin "Carev Dvor", në të cilën është mbajtur një aheng. Rastin në polici e ka denoncuar personi S.D, i cili ka njoftuar se në këtë loak është prishur rendi dhe qetësia publike. Përleshja fizike masive ka ndodhur mes personave B.A dhe U.F nga Ohri dhe persona T.K, E.K, R.K dhe O.M, nga Resnja. Në këtë ngjarje kanë marrë pjesë edhe persona tjerë që kanë marrë pjesë në këtë aheng", thonë nga policia e Manastirit. Ndryshe, nga ky sektor i policisë së shteti bëjnë të ditur se në vend ngjarje është paraqitur edhe përfaqësuesi i Prokurorisë së Resnjes, me çka janë marrë të gjitha të dhënat për zbardhjen e rastit.

Qentë endacak shqetësojnë qytetarët

Sulmet nga qentë endacak nuk kanë të ndalur. Kësaj radhe cak i sulmi ka qenë një biçiklist në Shkup. Në njoftim zyrtar të MPB-së, thuhet se biçiklistin e kanë sulmuar një grup qensh, rreth orës 11:45 të datës 3 shkurt, në afërsi të rrugës "Kej 13 Nëntori". Ndonëse me biçikletë, qytetari i sulmuar, siç thonë nga policia e Shkupit, nuk ka arritur t'i shmanget sulmi, me çka qentë e kanë kafshuar në këmbët e djathtë. Njëkohësisht në fillim të këtij muaji në sheshin qendror të Shkupit, personi GJ.I, ka denoncuar në polici se ka qenë i sulmuar dhe kafshuar nga qentë endacak. Ndryshe, në të po të njëjtën ditë, në rrugën "Lluka Gero", personi S.M, 59 vjeçar, ka paraqitur sulmin e radhës. Brenda kësaj periudhe qentë endacakë kanë sulmuar edhe disa qytetar në lagjen Gjorçe Petrov dhe rrethinë.

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune, Pëlqimit për punësim nga Ministria e financave të RM nr. 18-651/2 të datës 25.01.2018, Vendimit për publikim të shpalljes numër 0401-280/1 të datës 01.02.2018, të sjellë nga UD Drejtori i IPSH Instituti për sëmundje të mushkërive të bardha tek fëmijët Kozle Shkup, publikohet

SHPALLJE

Për punësim të 1 (një) personi Telefonist – informator për kohë të pacaktuar.

1. IPSH Instituti për sëmundje të mushkërive të bardha tek fëmijët Kozle Shkup ka nevojë për të punësuar 1 (një) person për vendin e punës Telefonist – informator për kohë të pacaktuar.
2. Kandidatët duhet të përmbushin kushtet e përgjithshme të parapara me Ligj:
   - Të jetë shtetas i RM;
   - Të jetë i moshës së rritur;
   - Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore;
   - Të mos i jetë shqiptuar ndalesë për kryerjen e veprimtarisë, detyrës ose profesionit .
3. Krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj kandidatët duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme në vijim:
   - Arsim të mesëm të mbaruar (PMP) dhe deri në dy vjet përvojë pune.
4. Orari javor i punës është 40 orë. Neto pagesa fillestare për Telefonist – informator është 13.853,00 denarë.
5. Si shtojcë të fletëparaqitjes kandidatët janë të obliguar që të parashtrojnë dokumentet në vijim:
   - Fletëparaqitje me të dhënat për kontakt;
   - Biografi të shkurtë (CV);
   - Diplomë për arsim të mesëm të mbaruar në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter;
   - Certifikatë të mjekut jo më të vjetër se 6 muaj në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter;
   - Certifikatë të shtetësisë së Republikës së Maqedonisë në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter;
   - Kopje të letërnjoftimit të vërtetuar në noter;
   - Certifikatë se nuk ka ndalesë për kryerje të veprimtarisë, detyrës ose profesionit.
6. Afati për paraqitje të kandidatëve zgjatë 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit.
7. Dokumentacioni i dorëzuar pas afatit, jo i plotë dhe i parregulluar nuk do të jetë lëndë shqyrtimi.
8. Fletëparaqitja së bashku me tërë dokumentacionin të parashtrohet në IPSH Instituti për sëmundje të mushkërive të bardha tek fëmijët Kozle Shkup, lagjja Kozle pn, Shkup përmes postës ose në arkivin e IPSH Instituti për sëmundje të mushkërive të bardha tek fëmijët Kozle Shkup me shenjë për Shpallje për punësim.

IPSH Instituti për sëmundje të mushkërive të bardha tek fëmijët Kozle Shkup
UD Drejtor
D-r Angellço Andonovski
Ekk Dip. Rijad Alimi

Republika e Maqedonisë
Ministria e Vetëqeverisjes Lokale
Byroja për Zhvillim Rajonal

Në bazë të nenit 35 paragrafi 1 dhe neni 36 paragrafi 1 nga Ligji për Zhvillim të Barabartë Rajonal (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 63/07), Byroja për Zhvillim Rajonal shpall

THIRJE PUBLIKE

PËR GRUMBULLIMIN E PROPOZIM – PROJEKTEVE PËR ZHVILLIMIN E RAJONEVE ME NEVOJA SPECIFIKE ZHVILLIMORE DHE PËR ZHVILLIMIN E FSHATRAVE PËR VITIN 2018.

1. LËNDA E THIRRJES PUBLIKE

Lënda e thirrjes publike është ndarja e mjeteve për financimin e projekteve për zhvillimin e rajoneve me nevoja specifike zhvillimore dhe për zhvillimin e fshatrave, mjete të përcaktuara në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë për vitin 2018, seksioni 191.01 Subprogrami OA Zhvillimi i barabartë rajonal zëri 464 Transferta te ndryshme zëri 488 Dotacione kapitale për NJVL-të.

I.GRUMBULLIMI I PROPOZIM- PROJEKTEVE PËR ZHVILLIMIN E RAJONEVE ME NEVOJA SPECIFIKE ZHVILLIMORE.

2. SHUMA E MJETEVE

Shuma e përgjithshme e mjeteve për financimin e projekteve për zhvillim të rajoneve me nevoja specifike zhvillimore në pajtueshmëri me nenin 2 pika 2.3 nga tabela e Programit për Zhvillim të Barabartë Rajonal për vitin 2018, Subprogrami OA për zhvillim të barabartë rajonal zëri 464 Transfere te ndryshme (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 17/18) është përcaktuar në vlerë prej 35.166.727 denarë.

Shuma e përgjithshme e mjeteve për financimin e projekteve për zhvillim të rajoneve me nevoja specifike zhvillimore në pajtueshmëri me nenin 2 pika 3 nga tabela e Programit për Zhvillim të Barabartë Rajonal për vitin 2018, Subprogrami OA për zhvillimi të barabartë rajonal zëri 488 Dotacione kapitale deri te NJVL-të, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 17/18) është përcaktuar në vlerë prej 20.700.000 denarë.

3. MËNYRA E DORËZIMIT TË PROPOZIM -PROJEKEVE

Të drejtë për dorëzim të propozim-projekteve për zhvillim të rajoneve me nevoja specifike zhvillimore kanë njësitë e vetëqeverisjes lokale të cilat në përbërjen e tyre kanë vendbanime me status të rajoneve me nevoja specifike zhvillimore, të përcaktuara me Vendimin për përcaktimin e rajoneve me nevoja specifike zhvillimore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.33/2014).

Njësitë e vetëqeverisjes lokale aplikojnë me propozim-projekte për ndarjen e mjeteve për zhvillim të rajoneve me nevoja specifike zhvillimore nëpërmjet plotësimit të formularit për aplikim i cili është publikuar në web faqen e Byrosë për Zhvillim Rajonal www.brr.gov.mk

4. AFATI I DORËZIMIT TË PROPOZIM -PROJEKTEVE

Njësit e vetëqeverisjes lokale aplikacionet e tyre për financim të propozim-projekteve për zhvillim të rajoneve me nevoja specifike zhvillimore duhet t'i dorëzojnë në Byronë për Zhvillim Rajonal, rruga Sv. Kirili dhe Metodij nr .20 Shkup, dy formular aplikimi në origjinal dhe në formë elektronike në CD (formular origjinal i skanuar dhe word (ose pdf format)) në afat prej tridhjetë ditësh nga dita e shpalljes së thirrjes publike në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë dhe gazetat publike.

II PËR GRUMBULLIMIN E PROPOZIM – PROJEKTEVE PËR ZHVILLIMIN E FSHATRAVE

1.SHUMA E MJETEVE

Shuma e përgjithshme e mjeteve për financimin e projekteve për zhvillimin e fshatrave nga Programi për Zhvillim të Barabartë Rajonal për vitin 2018, Subprogrami OA për zhvillim të barabartë rajonal zëri 464 Transfere te ndryshme, neni 2 pika 2.4 nga tabela (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 17/18) është përcaktuar në vlerë prej 17.583.363 denarë.

Shuma e përgjithshme e mjeteve për financimin e projekteve për zhvillimin e fshatrave nga Programi për Zhvillim të Barabartë Rajonal e vitit 2018, Subprogrami OA për zhvillim të barabartë rajonal, zëri 488 Dotacione kapitale për NJVL, neni 2 pika 4 nga tabela (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 17/18), është përcaktuar në vlerë prej 10.350.000 denarë.

2. MËNYRA E SHPËRNDARJES SË MJETEVE

Në pajtueshmëri me nenin 32 nga Ligji për Zhvillim të Barabartë Rajonal mjetet e përgjithshme për zhvillim të fshatrave të përcaktuara në Programet e lartpërmendur ndahen sipas rajoneve planore ku çdo rajon merr pjesë të barabartë.

Nga Programi për Zhvillim të Barabartë Rajonal për vitin 2018, Subprogrami OA për zhvillim të barabartë rajonal zëri 464 Transfere te ndryshme, për secilin nga rajonet planore ndahen mjete në vlerë prej 2.197.920 denarë, ndërsa nga Programi për Zhvillim të Barabartë Rajonal, Subprogrami OA për zhvillimit të barabartë rajonal, zëri 488 Dotacione kapitale për NJVL, për secilin nga rajonet planore ndahen mjete në vlerë prej 1.293.750 denarë.

3. MËNYRA E DORËZIMIT TË PROPOZIM –PROJEKEVE

Të drejtë për dorëzim të propozim-projekteve për zhvillim të rajoneve me nevoja specifike zhvillimore kanë njësitë e vetëqeverisjes lokale të cilat në përbërjen e tyre kanë vendbanime me status të rajoneve me nevoja specifike zhvillimore, të përcaktuara me Vendimin për përcaktimin e rajoneve me nevoja specifike zhvillimore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.33/2014).

Njësitë e vetëqeverisjes lokale aplikojnë me propozim-projekte për ndarjen e mjeteve për zhvillim të rajoneve me nevoja specifike zhvillimore nëpërmjet plotësimit të formularit për aplikim i cili është publikuar në web faqen e Byrosë për Zhvillim Rajonal www.brr.gov.mk

Njësitë e vetëqeverisjes lokale me seli në qytet të cilat dorëzojnë propozim-projekte për zhvillimin e fshatrave të cilët hyjnë në përbërjen e tyre janë të obliguar të sigurojnë bashkëfinancim në lartësi prej 50% nga vlera e propozim – projekti.

4. AFATI I DORËZIMIT TË PROPOZIM -PROJEKTEVE

Njësit e vetëqeverisjes lokale aplikacionet e tyre për financim të propozim-projekteve për zhvillim të rajoneve me nevoja specifike zhvillimore duhen t'i dorëzojnë në Byronë për Zhvillim Rajonal, rruga Sv. Kirili dhe Metodij nr.20 Shkup, dy formular aplikimi në origjinal

dhe në formë elektronike në CD (formular origjinal i skanuar dhe word (ose pdf format)) në afat prej tridhjetë ditësh nga dita e shpalljes së thirrjes publike në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë dhe gazetat publike.

Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 pika 1 dhe nenit 23 të Ligjit për marrëdhënie pune – Teksti i pastruar ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 167/2015) dhe vendimit të drejtorit të Shkollës së mesme ekonomike dhe juridike të Qytetit të Shkupit "Arseni Jovkov – Shkup, publikohet

SHPALLJE
Për plotësimin e vendeve të punës për kohë të caktuar për vitin shkollor 2017/2018

1. Një mësimdhënës të sportit dhe aktiviteteve sportive për 20 orë mësimore gjegjësisht 40 orë punë në javë për kohë të caktuar deri më 31.08.2018 për mësimin në gjuhën maqedonase, me studime të mbaruara në Fakultetin e edukatës fizike, studime të mbaruara të edukatës fizike me përgatitje pedagogjike-psikologjike dhe metodike, në Fakultetin e edukatës fizike – drejtimi mësimor me neto pagesë bazë në shumë prej 21.522,00 denarë.

2. Një mësimdhënës të informatikës për 14 orë mësimore gjegjësisht 28 orë punë në javë për kohë të caktuar deri më 31.08.2018 për mësimin në gjuhën maqedonase, me studime të mbaruara nga informatika – drejtimi mësimor dhe drejtime aplikative me përgatitje të fituar përkatëse pedagogjike-psikologjike dhe metodike, matematikë – informatikë drejtimi mësimor, teknika kompjuterike, informatikë dhe automatikë me përgatitje të fituar përkatëse pedagogjike-psikologjike dhe metodike, studime të mbaruara diplomike nga sfera e informatikës, teknologjive informatike ose informative-komunikimit në universitetet e akredituara të RM ose jashtë vendit me akreditim në vend dhe me përgatitje të fituar përkatëse pedagogjike-psikologjike dhe metodike, me neto pagesë bazë në shumë prej 15.065,00 denarë.

3. Një mësimdhënës të historisë së Maqedonisë për 14 orë mësimore gjegjësisht 28 orë punë në javë për kohë të caktuar deri më 31.08.2018 për mësimin në gjuhën maqedonase, me studime të mbaruara nga sociologjia, filozofia, pedagogjia dhe historia, me neto pagesë bazë në shumë prej 15.065,00 denarë.

4. Një mësimdhënës të edukatës qytetare për 14 orë mësimore gjegjësisht 28 orë punë në javë për kohë të caktuar deri më 31.08.2018 për mësimin në gjuhën maqedonase, me studime të mbaruara nga sociologjia, filozofia, pedagogjia dhe historia, me neto pagesë bazë në shumë prej 15.065,00 denarë.

5. Një mësimdhënës të gjuhës shqipe për 12 orë mësimore gjegjësisht 24 orë punë në javë për kohë të caktuar deri më 31.08.2018 për mësimin në gjuhën shqipe, me studime të mbaruara nga gjuha dhe letërsia shqipe – drejtimi mësimor, me neto pagesë bazë në shumë prej 12.913,00 denarë.

6. Një mësimdhënës të historisë së Maqedonisë për 12 orë mësimore gjegjësisht 24 orë punë në javë për kohë të caktuar deri më 31.08.2018 për mësimin në gjuhën shqipe, me studime të mbaruara nga historia – Instituti për histori, me neto pagesë bazë në shumë prej 12.913,00 denarë.

7. Një mësimdhënës të matematikës me 21 orë mësimore gjegjësisht 40 orë punë në javë për kohë të caktuar deri më 31.08.2018 për mësimin në gjuhën shqipe me studime të mbaruara të matematikës, drejtimi mësimor; studime të mbaruara të matematikës, drejtimi aplikativ me përgatitje përkatëse pedagogjike, psikologjike dhe metodike; studime të mbaruara të matematikës – informatikës, drejtimi mësimor me neto pagesë bazë prej 21.522,00 denarë.

8. Një mësimdhënës të lëndëve ekonomike për 10 orë mësimore gjegjësisht 20 orë punë në javë, për kohë të caktuar për mësimin në gjuhën maqedonase, për zëvendësim të ndihmës drejtorit deri në kthimin e tij por jo më gjatë se deri më 31.08.2018, me studime të mbaruara për ekonomi, me neto pagesë bazë në shumë prej 10.761,00 denarë.

9. Një mësimdhënës të lëndëve juridike për 19 orë mësimore gjegjësisht 38 orë punë në javë, për kohë të caktuar deri më 31.08.2018 për mësimin në gjuhën maqedonase, me studime të mbaruara për drejtësi, me neto pagesë bazë në shumë prej 20.446,00 denarë.

10. Një mësimdhënës të lëndëve ekonomike me 20 orë mësimore gjegjësisht 40 orë pune në javë, për kojhjë të caktuar për mësimin në gjuhën shqipe si zëvendësim të ndihmësdrejtorit për mësimin në gjuhën shqipe deri në kthimin e tij, por jo më gjatë se deri më 31.08.2018, me studime të mbaruara të ekonomisë, me neto pagesë bazë në shumë prej 21.522,00 denarë.

Kandidatët për mësimdhënës nën pikën 8, 9 dhe 10 të kenë përgatitje pedagogjike-psikologjike dhe metodike.

Orari i punës së mësimdhënësve është në dy ndërrime edhe atë në ndërrimin e parë prej ora 7,30 deri në ora 13,20, ndërsa në ndërrimin e dytë prej ora 13,30 deri në ora 19,20 në pajtim me orarin e orëve.

Kandidatët për mësimdhënës duhet të njohin gjuhën letrare dhe alfabetin e gjuhës në të cilën zhvillohet mësimi për çka do të bëhet kontrollim nga komisioni në shkollë, edhe atë për ata kandidatë të cilët i plotësojnë kushtet e theksuara në shpallje, ndërsa për terminin e kontrollimit do të informohen enkas me e-mail.

Dokumentet e nevojshme:
* Lutje me CV;
* Diplomë për arsimin e mbaruar përkatës (të vërtetuar në noter);
* Certifikatë të shtetësisë;
*Certifikatë për përgatitje të arritur pedagogjike-psikologjike dhe metodike (për kandidatët me studime të mbaruara që nuk kanë drejtim mësimor).

Shpallja zgjatë 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit.
Zgjedhja do të realizohet në afat prej 15 ditëve pas kalimit të afatit për paraqitje.
Dokumentet dorëzohen në adresën në vijim: Shkolla e mesme ekonomike dhe juridike e Qytetit të Shkupit "Arseni Jovkov"- Shkup, rr "Kosturska" pn – Shkup, tel. 02/2611-195, personi për kontakt është sekretari i shkollës.

SHMEJQSH "Arseni Jovkov" – Shkup

Republika e Maqedonisë

KOMUNA E RESNJËS
Sektori për urbanizëm, punë komunale,
zhvillim ekonomik lokal dhe bashkëpunim tejkufitar

Në bazë të nenit 35 paragrafi 2 i Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 199/14, 44/15, 193/15 dhe 31/16), nenit 50 pika 4 e Ligjit për vetëqeverisje lokale (Gazeta Zyrtare e RM" nr. 5/02), nenit __ të Statutit të Komunës së Resnjës dhe Programit të sjellë vjetor për përpilimin e planeve urbanistike të Komunës së Resnjës për vitin 2017 me vendim nr. 08-1168/9 të datës 28.04.2015 të sjellë nga Këshilli i Komunës së Resnjës, Kryetari i Komunës së Resnjës në vijim jep

L A J M Ë R I M

Për organizim të prezantimit publik dhe anketës publike në lidhje
me Propozim planin për ndryshime dhe plotësime të PDU për UE2 dhe Zonës për shërbime Komuna e Resnjës – Resnjë

Kufijtë e përfshirjes së PDU janë:

- Në lindje: me bosht të Rrugës Sobirna, rr. Novoplaninarna 2
- Në jug: me pjesën e jashtme të trotuarit të Rrugës industriale, rrugës Novoproektirana 4
- Në perëndim: me boshtin e Rrugës magjistrale të qytetit, rr. Boris Kidriq
- Në veri: me boshtin e Rrugës shërbyese, rr. Novoplanirana 4

Kështu përfshirja e caktuar është me sipërfaqe prej 3.37 ha.
Anketa publike dhe prezantimi publik në lidhje me Propozim PDU për UE2 dhe Zonës për shërbime Komuna e Resnjës – Resnjë, Komuna e Resnjës – Resnjë do të realizohet me shfaqjen e Propozim PDU për UE2 dhe Zonës për shërbime Komuna e Resnjës – Resnjë në lokalet e Komunës së Resnjës – Resnjë.
Anketa publike do të zgjasë 10 (dhjetë) ditë pune me fillim prej më 12.02.2018 deri më 23.02.2018, çdo ditë pune prej ora 08 deri në ora 16.
Në afatin e caktuar, qytetarët e interesuar dhe subjektet juridike nga rajoni konkret i përfshirë me planin mund të parashtrojnë shënime me shkrim, propozime dhe mendime në listat anketuese.
Prezantimi publik me prezantim profesional të panit do të mbahet më datë 09.02.2018 në ora 12.30, në sallën e vogël të Komunës së Resnjës – Resnjë.

Komuna e Resnjës
Kryetari i Komunës
Zhivko Gosharevski

Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 pika 1 dhe nenit 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë numër 62/2005), nenit 82, paragrafi 1, paragrafi 3 dhe paragrafi 4 e Ligjit për arsim fillor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë numër 103/2008), pas marrjes së Pëlqimit për financim të ri të marrë nga Ministria e financave të Republikës së Maqedonisë, drejtori i Shkollës fillore komunale "Josip Bros Tito" Vallandovë, Daniella Xhonova publikon:

SHPALLJE

Për punësim të MËSIMDHËNËSIT PËR MËSIM KLASOR

- **1 (një) realizues;**

Krahas kushteve të përgjithshme të cilat i parasheh LMP, kandidatët për mësimdhënës duhet të përmbushin edhe kushtet nga Ligji për arsim fillor, neni 77 dhe neni 80.

Vendi i punës është për kohë të caktuar, deri në fund të vitit shkollor 2017/2018, ose deri më 31 gusht 2018.

Vendi i punës është me orar të plotë të punës (40 orë pune), të shpërndara në 5 (pesë) ditë pune gjatë javës, me neto pagesë mujore prej 20.640,00 denarë + shtesë për punë të kaluar në shumë prej 0,5% për çdo vit të stazhit të punës për orar të plotë të punës;

Së bashku me fletëparaqitjet kandidatët duhet të parashtrojnë:

- **Fletëparaqitje, të shkruar me dorë dhe e nënshkruar;**
- **Diplomë ose certifikatë për arsim të mbaruar përkatës (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter); .**
- **Certifikatë të shtetësisë së Republikës së Maqedonisë;**
- **Vërtetim se nuk është i dënuar;**
- **Vërtetim se nuk është shqiptuar sanksion, ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;**

Shpallja zgjatë 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit të saj.
Dokumentet e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të merren parasysh gjatë shqyrtimit. Fletëparaqitjet dhe dokumentet e nevojshme duhet të dorëzohen personalisht në arkivin e Shkollës fillore komunale "Josip Broz Tito" Vallandovë, në rr. "6-ti Noemvri" pb, Vallandovë deri në ora 14.

SHFK "Josip Broz Tito" Vallandovë
Drejtor
Daniella Xhonova

PROBLEMET E KONSUMATORËVE

ANKESA PËR TELEFONINË DHE LLOGARITË PAUSHALLE

Janë të shumta problemet me servisimin e telefonave celularë, ku shpesh ndodhë të servisohen prodhimet e njëjta për më shumë se tri herë për shkak të gabimeve të fabrikës. Mobilje jocilësore, llogaritë paushale dhe pagesa e borxheve të vjetra për rrymën, ngrohjen dhe ujin, ushqime me afat të skaduar, këto vlerësohen të jenë problemet kryesore të konsumatorëve në Maqedoni në vitin e kaluar

Koha Fisnik PASHOLLI

Shkup, 4 shkurt - Telefona dhe mobilje jocilësore, probleme të ndryshme me llogaritë e telefonisë celulare, llogaritë paushale dhe pagesa e borxheve të vjetra për energjinë elektrike, ngrohjen dhe ujin, ushqime me afat të skaduar , këto vlerësohen të jenë vitin e kaluar problemet kryesore të konsumatorëve në Maqedoni.

Nga Organizata e Konsumatorëve të Maqedonisë thonë se janë të shumta problemet me servisimin e telefonave celularë, ku shpesh ndodhë të servisohen prodhimet e njejta për më shumë se tri herë për shkak të gabimeve të fabrikës. Sipas pohimeve të konsumatorëve, i njëjti gabim mund të ndreqet për shkak se problemi teknik paraqitet në mënyrë të vazhdueshme. Ekzistojnë edhe raste kur telefoni është prishur që në orët e para të përdorimit, ndërsa nga ana tjetër konsumatorët thonë se refuzojnë riparimin e celularit , por kërkojnë prodhim të ri nga tregtari që nuk e fitojnë, theksojnë nga Organizata e Konsumatorëve të Maqedonisë.

Ndodhin edhe raste kur konsumatorëve ju dërgohet në shtëpi një prodhim teknik i dëmtuar mekanikisht si televizor, lavatriçe etj

" Gjatë dorëzimit të prodhimit përderisa ai akoma është u paketuar në kuti , konsumatorët nënshkruajnë se konfirmojnë pranimin e mallit në gjendje të rregullt duke mos ditur se ai është i dëmtuar. Kjo ndodh për shkak të pozitës së pavolitshme në të cilën është i vendosur konsumatori , kur në momentin e ngutjes nuk kontrollon se a është me të vërtetë prodhimi në gjendje funksionale dhe i padëmtuar , andaj edhe nënshkruan duke i besuar tregtarit apo transportuesit" thonë nga Organizata e Konsumatorëve të Maqedonisë për agjencinë MIA.

Në ndërkohë një numër i madh i ankesave ka arritur edhe për prodhimin e llojeve të ndryshme jocilësore të mobiljeve, për materialin jocilësor nga i cili janë prodhuar këpucët dhe veshmbathjet që menjëherë janë dëmtuar dhe nuk mund të kthehen për shkak se konsumatori nuk mund të realizojë të drejtën ligjore për kthimin e prodhimit, këmbimin ose kthimin e të hollave për shkak se prodhimi pak ka ndryshuar formën ose nuk është në paketimin origjinal. Konsumatorë kanë paraqitur edhe prodhime të prishura , sende të ndryshme të gjetura në ushqim , prodhime me afat të skaduar ose jocilësore ku është gjetur insekt apo gjësende të forta. Numri më i madh ankesave ka të bëjë me deklarimin e prodhimeve, ku germat janë tejet të vogla ose mungojnë në gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik. Nga ana tjetër janë zvogëluar ankesat për shërbimet turistike. Sa i takon shërbimeve publike, problemet e ndryshme me llogaritë e telefonisë celulare edhe në vitin 2017, kanë kryesuar ankesat e konsumatorëve në nivel kombëtar. Krahas tyre, konsumatorët janë ankuar edhe për problemet me mbulimin me rrjet apo mungesën e valëve, mosfunksionimin e kartelave, problemet me ndryshimin e operatorëve gjatë bashkimit të dy nga tre operatorët celular, si dhe kompensimin që paguhet gjatë lidhjes së serishme në rrjet në rastin kur konsumatori shkyçet për shkak të mospagesës së llogarisë. Nga shërbimet e tjera publike, sa i takon furnizimit me energji elektrike dhe të ngrohjes, më së shumti ankesa ka pasur për llogaritë paushale dhe pagesën e borxheve të vjetra. Nga Organizata e Konsumatorëve thonë se moslexim i rregullt i aparateve matës ka ndikuar në numrin e madh të llogarive paushall, që sipas pohimeve të vetë konsumatorëve janë shumë më të larta se konsumi mesatar familjar. Ndërprerjet e shpeshta në furnizim me rrymë gjithashtu janë problem me të cilin ballafaqohen konsumatorët në rajone të caktuara shtojnë nga OKM. Konsumatorët kanë pasur probleme edhe me borxhet e mbetura ose të mosfunksionimit si duhet të ujëmatësve. Lidhur me ankesat e konsumatorëve për shërbimet financiare kanë dominuar ato të gjetjes së mënyrës se si të zgjidhet problem me bankat për përllogaritjen e kamatës, hapjen apo mbylljen e llogarisë apo kredisë. Vlen të theksohen edhe ankesat për kështillat shtëpiake, ose për punën joprofesionale të menaxherit të ndërtesës që nuk i përmbush obligimet nga kontrata lidhur për mirëmbajtjen e banesës dhe të ngjashme.

PËRTEJ BITCOIN

Bitcoin nuk është më e vetmja lojtare në vorbullën e kriptomonedhave. Cila mund të jetë monedha e ardhshme dixhitale që do të sundojë mbi të gjitha kriptomonedhat?

Gjithçka filloi si lojë. Dogecoin u hodh në treg në 2013, si një parodi ndaj bitcoin, duke përdorur si logo të saj një qen të racës japoneze, shiba inu, një figurë shumë e famshme në internet. Kjo kriptomonedhë nuk u përdor kurrë me të vërtetë, por së fundmi, vlera e saj është rritur shumë, gjë që ka befasuar kryesisht disa prej themeluesve të saj. Më 7 janar, vlera në dollarë e të gjithë kriptomonedhave, Dogecoin, në qarkullim arriti në 2 miliardë dollarë, një tregues i fortë i "çmendurisë" së kriptomonedhave, shkruan The Economist. Ky është edhe një tregues mjaft i mirë dhe një formë kujtese se Bitcoin nuk është e vetmja lojtare në këtë valle.

Kapitali i tregut të saj tani arrin në vetëm një të tretën e tregut të kriptomonedhave. Një kriptomonedhë e re lind pothuajse çdo ditë, shpeshherë përmes një "oferte fillestare të monedhës" (ICO), një formë e mbledhjes së fondeve online.

CoinMarketCap, një faqe interneti, liston rreth 1,400 monedha dixhitale, duke përfshirë këtu PutinCoin, Sexcoin dhe InsaneCoin (me vlerë rreth 7 milionë dollarë). Shumica e tyre janë jo më shumë sesa thjesht kuriozitete, por deri më 10 janar, rreth 40 prej tyre kishin një kapital tregu prej më shumë se 1 miliard dollarësh.

E para në listë, pas Bitcoin, ishte Ethereum, kriptomonedha e cila arriti një kapital tregu prej 137 miliardë dollarësh.

Pretendimi i Ethereum për të marrë sa më shumë famë është se kjo kriptomonedhë është edhe një platformë për "kontratat e zgjuara", rregullat e biznesit të përfshira në softuer. Shumica e "Ofertave fillestare të monedhave", për shembull, nxirren nga kontrata të tilla. Suksesi i saj ka tërhequr vëmendjen edhe për krijimin e kriptomonedhave të tjera, kopje të kësaj të fundit, të tilla si Cardano (20 miliardë dollarë) dhe NEO (8 miliardë dollarë), e kineze kriptomonedhash. Ripple, gjithashtu, po sfidon gravitetin.

I gjithë zemërimi lidhet me kriptomonedhat e Koresë e Jugut, e cila thuri plane për të ndaluar shkëmbimet tregtare. Softueri i Ripple mundëson lëvizjen e parave midis vendeve dhe mbi 100 banka kanë nënshkruar marrëveshje për të blerë teknologjinë me të cilën ajo funksionon, bazuar kryesisht mbi një kriptomonedhë të njohur me emrin XRP. Kapitali i saj i tregut u rrit me më shumë se 40% në vitin 2017, duke arritur në rreth 149 miliardë dollarë më 4 janar, përpara se të shënonte një rënie tjetër në 78 miliardë dollarë. Kjo ende e bën Chris Larsen, një prej bashkëthemeluesve të Ripple, një nga njerëzit më të pasur në botë. Edhe shumë kriptomonedha të tjera më pak të njohura kanë filluar të fitojnë terren. Monero (6 miliardë dollarë) dhe Zcash (2 miliardë dollarë) janë të përqendruar kryesisht në privatësinë e tyre. Stellar (9.8 miliardë dollarë) ka zhvilluar një sistem për të transferuar fonde me çmim të lirë, që përdoret nga organizatat bamirëse, veçanërisht në vendet e varfra. IOTA (10.1 miliardë dollarë) mundëson shkëmbimin e informacioneve dhe pagesave të sigurta.

Dhe më pas vjen Bitcoin Cash (46 miliardë dollarë) themeluesit e të cilit u ndanë nga Bitcoin në gusht të 2017-s, sepse ata nuk ishin të kënaqur me mënyrën se si ky i fundit menaxhohej. A mundet që ndoshta ndonjë nga këto ditë, e cila mund të jetë edhe e afërt, ndonjëra prej këtyre kriptomonedhave të marrë vendin e Bitcoin, lëvizje që brenda këtij rrethi njihet si "zëvendësimi"?

Por duke marrë në konsideratë edhe problemet e qeverisjes së Bitcoin dhe kapacitetin e kufizuar (një transaksion tani kushton gati 30 dollarë mesatarisht), kjo gjë edhe mund të ndodhë. Por nuk është vetëm Bitcoin ai që ka probleme, edhe të tjerët kanë probleme.

Tarifat e përdoruesve të Ethereum janë rritur dhe sistemi ka hasur sërish vështirësi të ndryshme teknike. Sa i përket Ripple, disa vënë në pikëpyetje sasinë e kriptomonedhave XRP që vihen në përdorim. Por edhe pse shumica e tyre po përballen me probleme të ndryshme, kriptomonedha të reja po krijohen nga dita në ditë. Kodak është nga më të rinjtë e kësaj liste, i cili ka shprehur se shumë shpejt do të hedhë në treg një kriptomonedhë për t'u lejuar fotografëve që të publikojnë veprat e tyre.

Më ambicioze do të jetë "oferta fillestare e monedhës" së Telegram, një shërbim për dërgimin e mesazheve me 180 milionë përdorues që synon të rrisë fitimet me 1.2 miliardë dollarë dhe të hedhë në treg një monedhë të quajtur Gram, e cila do të përdoret për të paguar një sërë shërbimesh, nga ruajtja online në rrjet në rrjetet private virtuale. Edhe Facebook e ka marrë në konsideratë dhe po e trajton me shumë seriozitet faktin e krijimit dhe hedhjes në treg të një kriptomonedhe. Por nëse rrjeti më i madh social në botë do ta bëjë këtë lëvizje, ditët e Bitcoin-it si kriptomonedha lidere me siguri që do të jenë të pakta.

Procesi i Franc Kafkës në kontekstin shqiptar

Nga **Leonora Laçi**

Tek sa lexoja "Procesin" e Franc Kafkës, nënqesha me veten sepse mu duk sikur F.Kafka e kishte shkruar për Shqipërinë e pas viteve '90, për ne. Ai shkruan, përshkruan, një proces që nuk filloi asnjëherë, por as nuk mbaroi kurrë, një proces i nënkuptuar, pa fakte, pa argumente, pa letra, pa gjyq, pa gjykata, pa drejtësi, ku gjithçka mbetet pezull e aludohet. Të gjithë flasin për të dhe e marrin si të mirëqenë por askush nuk di të thotë më tepër se kaq, nuk e njeh atë, thjesht flasin si për një fantazmë që duhet besuar.

Kjo dramë njerëzore ngjanë me dramën shqiptare të dy dekadave të fundit a më shumë, pasi dhe ne jemi në procese të ndryshme por nuk dimë se çfarë procesesh janë, kush i drejton, çfarë konkluzionesh kanë, cilat janë përfundimet, ne jemi "aktorë" të një drame me perde të ulura që nuk ka asnjë mesazh të qartë, aktorë që nuk e punojnë vetë tekstin, u jepet i gatshëm.

Ndonëse në të vërtetë tek ne realizohen vërtetë procese, apo kështu emërtohen, procese integruese s'dihet se për ku, e procese denigruese që avancojnë si era, procese demokratizuese të avashta, procese politike e lojëra partish pa programe, procese tranzicioni të dukshme që i ka dal era...etj etj.

Personazhi K. personifikon popullin shqiptar, i cili është ai që i merr vesh gjërat i fundit, nuk di ku shkon, nuk di as nuk do të di, ose dhe kur do të informohet gjenë njerëzit e gabuar në kohën e gabuar, nga ana tjetër gjykatat dhe sistemi i Procesit të Kafkës, personifikon sistemin politik shqiptar dhe të gjithë aleatët e saj.

Populli është merhumi, i pambrojturi, që gjendet në situata të tilla ku ligji punon kundër tij, e po ai ligj interpretohet sipas interesave të sistemit, ndryshe shkruhet, ndryshe thuhet e ndryshe bëhet. Në një vend që "drejtësia" është bërë term klishe, të gjithë flasin për të por askush nuk e kupton, e shohin si diçka të largët iluzive. Procesin shqiptar ashtu si atë Kafk-jan e udhëheqin të njëjtit, të gjithë japin mend për drejtësi qoftë shërbëtori, piktori, qiraxhesha, X e Y, por askush nuk e di të vërtetën -dhe as nuk i intereson vërtetë e vërteta, ose nuk ka një të tillë- janë pjesë integrale e sistemit, e mbajnë me dhëmbë atë sepse nuk do të dinë të integrohen më, nëse sistemi bie.Llogari s'jep kush se çfarë luhet në "mullirin" tonë, por askush nuk e kërkon atë. Nuk dihet se kush jemi, ku shkojmë, duam të ikim nga "procesi" ta shmangim por nuk dimë se si. Ndonëse ka zgjidhje; të heshtësh e të shohësh se çfarë ndodh me ty, të shpëtosh është e përkohshme, pasi "procesi shqiptar" do të vazhdoi dhe pa ne, madje nuk ka nevojë për ne, ne e pengojmë atë, zgjidhja tjetër është përfshirja, një jetë kemi a thua ja vlenë?! Po nëse përfshirja punon kundër nesh dhe jemi në krahun humbës, gjithsesi çdo "proces" ka humbës dhe fitues ata një qime i ndanë.

Apo të bëjmë paktin e heshtjes, ashtu siç kemi bërë deri tani, ku të gjithë e kemi pranuar, e kemi dashur si të ishte një kompromis për diçka më të madhe por pa ose me dashje ne vetëm sa i kemi dhënë legjitimitet me heshtje çdo procesi regresiv. Duket sikur ne kemi vendosur një ekuilibër të ri, jemi përshtatur e adaptuar duke u justifikuar se kështu funksionon sistemin, pa i vënë gishtin kokës se ne jemi vetë sistemi.

Mosreagimi ynë na bënë palë dhe të mendojmë që gjithçka ndodh e kemi merituar dhe kemi punuar për këtë gjë.

Ky legjitimitet i gjendjes sonë nuk ka ardhur në një ditë, është një proces shumëvjeçar, ndoshta dhe i trashëguar, por a duhet të vazhdojmë të fajësojmë të kaluarën a mos duhet të gjejmë fajtorët e sotëm dhe të mund të riparojmë atë që mundemi?! Politikbërja në Shqipëri është një proces që ka kaluar dorë me dorë dhe duke ndryshuar mbajtës jo vetëm që është tjetërsuar qëllimi fillestar por dhe është harruar qëllimisht, e kjo po vazhdon pambarimisht.

Proceset tona s'po kanë fund. Procese që fundosin të dobëtin e nxjerrin pa lagur të fortin, sistemi i të fortëve.

Gjithçka është një proces i filluar por pa datë përfundimi, gjithçka nis e lihet përgjysmë. Ne kemi nevojë të fillojmë një proces më të thellë në vetëdijen tonë të dimë se çfarë duam për vendin tonë dhe jo se çfarë të tjerët duan për ne. Apo duam të jetojmë në një kasaphanë sfilitëse deri sa të lodhemi nga vetja, po pastaj ?! Thonë që kur dhimbja bëhet e vazhdueshme mësohesh me të dhe bëhet pjesë e jotja integrale, e kështu nuk është më diçka e huaj, nuk është më dhimbje, nuk e lufton, ka imunitet edhe ndaj teje dhe ngadalë të shkatërron...

> **Gjithçka është një proces i filluar por pa datë përfundimi, gjithçka nis e lihet përgjysmë. Ne kemi nevojë të fillojmë një proces më të thellë në vetëdijen tonë të dimë se çfarë duam për vendin tonë dhe jo se çfarë të tjerët duan për ne. Apo duam të jetojmë në një kasaphanë sfilitëse deri sa të lodhemi nga vetja, po pastaj ?!**

Kafka shkruan dhe për hierarkinë gjyqësore, që s'ka dallim të madh nga hierarkia e sistemit tonë, dhe ne e hasim në jetën e përditshme, burokracia që fillon nga roja tek dera, punonjësit e pastrimit të institucionit, punonjësit e tjerë, e deri sa mbërrijmë tek drejtori, secili është me rëndësi di për sistemin ose bënë sikur di, nëse do të krysh punë të fusin në labirinthet e tyre deri sa të të rrjepin mirë...Flitet në emër të popullit por s'janë përfaqësues real të tij, flitet për ideale por s'kanë asgjë të përbashkëta me ta, flitet për lulëzim në betonizim, flitet për varfërinë të rrethuar nga luksi, flitet për vlera nga të pa vlerë, për fjalë të lirë që rrallë kush nga ata guxon, për përparim me mendje të mjerë, procese pa proces.

Përfundimi dihet, është paracaktuar, pa kompromise me sistemin të pret shuarja, e jo thika pas shpine, por në kraharorë përballë, një fytyrë djalli që qesh më të madhe fundin tonë. Ky djall mund të jetë kushdo, mik apo armik, i huaj apo vendas, i bardh apo i zi, ndoshta dhe njëri...

Ngjarja e Kafkës, personazhi K. përfundon si një qen, po ne...?!

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS

Koha Epërdítshme informative www.koha.mk

Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovasja lok.14 - përdhesë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi:"Adria Media Ballkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e diel 4 shkurt | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhirollogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

Koha për Kulturë

Koha, e hënë 05 shkurt, 2018

NË PËRVJETORIN E 550-TË TË JOHANNES GUTENBERGUT

AI QË DEMOKRATIZOI DIJEN

Me shpikjen prej tij të shtypshkronjës ai konsiderohet si ati i komunikimit masiv. Por a ka qenë vërtet ai i pari që shtypi libra? Edhe 550 vjet pas vdekjes së Gutenbergut, shumë çështje mbeten pa përgjigje.

"Të gjithë e njohin Johannes Gutenbergun, megjithëse për të thuajse nuk dihet asgjë", thotë zëvendësdrejtorja e muzeut Gutenberg në Mainz, Elke Schutt-Kehm. Kjo nis që me ditën e tij të lindjes dhe përfundon me datën e vdekjes, me të cilën ka lidhje përkujtimi i sivjetshëm i 550 të vdekjes së Gutenbergut. Vetëm kaq dihet: Johannes Gutenberg është shpikësi i shtypjes së librave me gërma të lëvizshme metali dhe me këtë ai kontribuoi në mënyrë vendimtare në suksesin e Reformacionit. Për këtë gazetarët amerikanë e zgjodhën atë "njeriun e mijëvjeçarit".

Ai lindi rreth vitit 1400. Ndoshta në Mainz, por ndoshta edhe në Eltville në anën tjetër të Rinit në Rheingau. Ai vinte nga familja e pasur tregtare Gensfleisch. Më vonë ai e ndryshoi emrin e lindjes, siç ishte moda atëherë, dhe mori emrin e rezidencës së familjes "Hof zum Gutenberg".

Ndoshta Johannes Gutenbergu studioi në Erfurt. Këtë e tregon një shënim në regjistrat e Universitetit. Rreth vitit 1428 familja Gensfleisch u largua nga Mainzi për shkak të konflikteve midis familjeve drejtuese të qytetit. Se ku qendroi pas kësaj Gutenbergu, nuk është dokumentuar. Qëndrimi i tij dokumentohet sërish në vitin 1434 në Strasburg.

Në këtë qytet, që sot është qytet francez, atij ju ofruan mundësi të shumta fitimi. Gutenbergu punoi atje ndër të tjera në zejet e monedhave dhe të argjendarisë, themeloi një shoqëri financimi dhe prodhoi objekte për t'i marrë me vete në pelegrinazhe. Ai kaloi atje gjithsej dhjetë vjet.

Pasi u kthye në Mainz ai vazhdoi punën për shtypjen e librave me ndihmën e tregtarit Johannes Fust dhe të shkruesit Peter Schöffer. Midis 1452 dhe 1454 puna përfundoi: u prodhuan gërmat e tij metalike të lëvizshme. Dhe meqenëse Guttenbergu qe mekanik i aftë dhe njëkohësisht sipërmarrës që i hynte rrezikut, ai ndërtoi për to edhe shtypshkronjën manuale me levë. Për shekuj të tërë librat qenë shkruar me mundim me shkrim dore, shumicën e herëve në dhomat e shkrimit të manastireve. Vetëm kleri dhe shtresa e lartë mund t'i blenin ato produkte të shtrenjta - pa folur për leximin. Kurse tani gërmat mund të shtoheshin si dëshiroje, fjalë dhe fjali të tëra mund të hidheshin në faqe - dhe e gjitha të riprodhohej sa herë të doje. Një shpikje që e revolucionarizoi shkëmbimin e dijes dhe solli ide të reja në popull me tirazh të lartë - për kushtet e Mesjetës.

Në vitin 1450 mjeshtri ndërmori punën më ambicioze të tij: brenda dy vjetësh ai shtypi me ndihmën e 20 të punësuarve të tij 180 kopje të Biblës së Luterit. Bibla është jo vetëm vepra e parë, por edhe libri më i bukur, që është shtypur ndonjëherë, mendon Elke Schutt-Kehm.

Teknika e Gutenbergut u shpërndaj tepër shpejt. Në vitin 1500 shtypshkronja në të gjithë Evropën prodhonin jo vetëm vepra dijetarësh, por edhe shkrime denigruese kundër tregtisë së çertifikatave të faljes së mëkateve. Rreth 100 vjet më vonë u shfaq gazeta e parë.

Po a ishte Gutenbergu i pari që e mundësoi shtypjen e librit? Përgjigja është: jo. Shtypja e librave me gërma të këmbyeshme qe shpikur që në shekullin e 11-të në Kinë dhe qe përhapur në shekullin e 13-të edhe në Kore. Por në një kohë kur në Azi gërmat gdhendeshin me procese të derdhjes së dyllit ose gdhendeshin në dru, Gutenbergu shpiku një teknikë krejt të vetën me një instrument që pikonte bojën dhe me një shtypshkronjë me levë. Ai është "i pari që konceptoi një prodhim serial të pjesëve të veçanta të standardizuara", thotë Schutt-Kehm. Kjo ishte një metodë e re dhe një hap shumë i madh në historinë e teknikës. Në 3 tetor në Mainz dhe jo vetëm aty kremtohet 550 vjetori i ditës së vdekjes së pionerit të mediave - edhe nëse shkencërisht për 03.02.1486 si datë të vdekjes ka diskutime e mendime që e kundërshtojnë.*(DW)*

"Kadare dhe regjimi komunist"

Ismail Kadare vjen me dokumente të panjohura arkivore që dëshmjnë për denoncimin e autorit dhe veprën e tij. Gazetari Dashnor Kaloçi pas librit të parë "Kadare i denoncuar" ka sjellë për lexuesin botimin "Kadare dhe regjimi komunist" ku vijnë dëshmi të reja për shkrimtarin duke rihapur debatin e pakryer qe lidhet drejtëpërdrejtë me hapjen e dosjeve e sidomos denonsimin e krimeve të komunizmit. 101 dokumente nga aparati diktatorial shtetëror në vitet 1959-1961 të cilat hedhin dritë mbi hijet në raportin që ka patur shkrimtari me regjimin.

"Çështja është se nuk ja kanë errësuar dot veprën. Çdo shkrimtar i madh ka patur konflikt të brendshëm jo vetëm Ismail Kadare" tha ish i përndjekur politik, politikani Spartak Ngjela. "Është lufta e përjetshme e mediokrit me njeriun e talentuar, me talentin e madh" shto ai.

Për gazetaren Monika Stafa "...ky libër ja ka dalë objektivit të tij: Të paraqiti shkrimtarin në raport me diktaturën aty ku duhej. Janë ndarë në grupe ata që e duan shkrimtarin dhe ata që hedhin baltë ndaj tij". "Kjo që është botuar tashmë nuk është një e vërtetë e fshehur është një e vërtetë e publikuar si çdo krim i cili mundohet të fshihet" shtoi gazetarja.

Botimi i përgatitur nga Dashnmor Kaloçi është konsideruar nga vetë shkrimtari shumë i rëndësishëm. I gjithi një libër denoncimesh, raportesh të fshehta dhe përgjimesh.

"Unë kam vite që kërkoj të hapen dosjet dhe jo vetëm unë, thotë shkrimtari, që kërkojmë të zbulohen të vërteta të fshehta".

"KASTRIOTA", FILMI ITALIAN MBI JETËN E SKËNDERBEUT

Një dokumentar me metrazh të shkurtër, që shpalos jetën dhe aksionet e heroit tonë kombëtar Gjergj Kastriotit, është prodhuar nga regjisori italian Steven Renso. Skënderbeu interpretohet nga aktori shqiptar Rimi Beqiri, i cili transformohet në heroin e popullit shqiptar.

Dokumentari tregon jetën e Skënderbeut dhe një periudhë të errët në jetën e tij; farë e shtyu atë që të braktiste pozicionin e tij të lartë në ushtrinë osmane dhe të kthehej në Shqipëri?

Një udhëtim në kërkim të vetes dhe qëllimit të tij, në këtë film do të

portretizohen edhe disa nga personazhet që ndikuan thellë në jetën e Gjergjit, si Sulltan Murati II, i interpretuar nga Mario Diodati, nipi i tij Hamza që luhet nga Ivan Kingston dhe shoqëruesi misterioz i Skënderbeut, që luhet nga Davide Gambarini.

"Ky është një prezantim i shkurtër i projektit që zë një vend të rëndësishëm në zemrën tonë, ku ne kemi dhënë shumë nga vetja dhe shpresojmë që edhe ju ta pëlqeni atë si ne"-, shkruhet në profilin zyrtar të këtij filmi në Facebook, pasi është shpërndarë traileri.

Filmi është xhiruar në një nga malet e "Dossenas" në 1200 metra lartësi në temperaturën -5 gradë, që ndodhet në një provincë të Bergamos. Pritet që ky produksion të shfaqet në disa festivale filmi të ndryshme jashtë vendit gjatë 2018, që përkon edhe me 550 vjetorin e vdekjes së heroit kombëtar.

SEKRETI I ROMANIT “KONTI I MONTEKRISTOS”



Një tregim i fortë, më shumë tregime së bashku, personazhe me një fat unik. Ja përse “Konti i Montekristos” është modeli i një krijimi të mirë. Konti i Montekristos është një thesar i vërtetë pasurie – pasuri sigurisht e gënjeshtërt, por e destinuar që të rrisë nevojën tonë për një realitet “tjetër”, që nuk reduktohet në meskinitetin e jetës sonë të përditshme

Çfarë është “romani”? Në çfarë konsiston? Kur e kemi të drejtën ta përdorim këtë term, jashtë e brenda letërsisë? Qetësohuni lexues: nuk është qëllimi të jepet këtu një leksion retorike e teorie letrare. Do të doja vetëm të ndaja me ju disa ndjesi të vogla, të cilat i kam nxjerrë nga rileximi tani së fundmi, të monumentit kolosal në realitetin imagjinar (në kuptimin e dyfishtë) që është Konti i Montekristos nga Aleksandër Dumas (1803-1870).

Rreth Kontit ka shkruar gjëra të bukura Umberto Ecco (supermeni masiv, 2001). Por ndoshta ndonjë konkluzion mund të shtohet për kanonizimin e tij fisnik. Të shohim, duke u nisur nga fillimi.Konti i Montekristo-s u shkruajt dhe u botua rreth 1844-ës.Pothuajse në të njëjtën kohë, “makineria” e rëndë e prodhimit letrar, që ishte Aleksandër Dumas, konceptoi e realizoi kryeveprat e sagës së musketjerëve, “Tre musketierët”, “Njëzet vite më vonë”, “Viskonti i Brageleone”.

Por Konti ishte një hap më lartë, më shumë ambicioz, për vendosjen dhe pothuajse bashkëkohësinë e ngjarjeve në lidhje me lexuesit e tij të asaj kohe.Në sintezë ekstreme: protagonisti i romanit, Edmond Dantes, është në origjinë një marinar i ri, shumë ekspert në punën e tij dhe tejet i ndershëm, të cilit, i vihen prangat prej tre personazheve të pabesë: Fernand Mondego, Gerard de Villefort e Danglars. Ai burgoset në burgun e tmerrshëm francez të quajtur Kështjella e Ifit, e kalon disa vite në një izolim pothuajse absolut dhe në dëshpërim ekstrem (Dantes akuzohet për bonapartizëm, prandaj nuk përjashtohet që Dumas lejon që në rrëfimin e tij të pikojë nga pakëz helm antiburbonik).

Aty njihet me një tjetër të burgosur të pafajshëm, Abatin Faria, i cili erdhi e u shfaq papritur në qelinë e tij, pasi kishte gërrmuar, mes vuajtjes çnjerëzore, një tunel nëntokësor, që duhej ta nxirrte përjashtë, por një llogaritje të gabuar, e çon tamam në qelinë e Edmondit. Nga abati Faria, prifti italian i kulturuar, Edmondi kupton shumë gjëra; por mbi të gjitha njihet, përpara se Faria të vdesë, me ekzistencën e një thesari të fshehur në ishullin e Montekristos. Edmondi arratiset nga kështjella e Ifit me një mashtrim sa makabër, aq edhe të zgjuar, vihet në zotërim të thesarit dhe fillon një jetë të re.

Në pjesën e dytë të romanit Edmondi kalon nga një maskim në tjetrin, në një kërkim këmbëngulës për të mbërritur deri tek hakmarrja.

Vepra megjithatë, ka një fund të lumtur, si rjedhim i të cilit Edmondi rifiton të drejtën njerëzore të faljes dhe dashurisë.Konti i Montekristos ka vuajtur negativisht në kohë “njollën” e të qënurit një roman shtojcë, i votuar në thelb për shkak të komercializmit të produktit ose, siç thuhet në kohët e sotme, prej “ligjeve të tregut”. Nuk ka dyshim që në fillim kështu ka qenë. Megjithatë rezultati e bën sot të denjë për një vëmendje më të madhe.Le të provojmë të rilidhemi me pyetjet fillestare.

Romani 1) është një tregim i fortë e kompleks, që nuk mund (e përsëris: nuk mund) të mos pretendojë dimensione të mëdha; 2) pjesë e një historie të vetme, por që do të thotë shumë; 3) është i përbërë nga personazhe që janë secili bartës të një “fati” të veçantë, i cili, megjithatë, është i thurur ekzaktesisht me atë të shumë të tjerëve; 4) mediton e përfaqëson strukturalisht një sistem raportesh midis reales dhe imagjinares, midis të mundurës dhe të pamundurës – domethënë midis asaj që është e asaj që mund të jetë, e cila gjithashtu bëhet në një pikë të caktuar, ajo që është.

Tani Konti i Montekristos paraqet pa pikë dyshimi të gjitha këto karakteristika. Po a nuk mund të vlejë i njëjti diskutim për një vepër tjetër, që sipas një gjykimi të përgjithshëm ka një shtrirje shumë më të gjerë, si “Lufta dhe Paqja”? Po sigurisht, mundet. Cila është diferenca, atëherë? Kam frikë që diferenca të jetë, siç thuhej njëherë e një kohë, në ”përmbajtje”. Pesha logjike, sentimentale, Ideali i Luftës dhe Paqes është i pashoq në krahasim me atë të shprehur nga fillimi në fund tek Konti i Montekristos.Megjithatë, thënë kjo, gjithçka tjetër mbetet e vlefshme edhe për Kontin e Montekristos, që do të thotë që “makina” e tij rrëfyese zotëron një vitalitet kaq të jashtëzakonshëm, që e bën të ketë një vlerë të madhe edhe për lexuesit modernë. Lexuesit të sotëm, atij të cilit nuk ka më nevojë t’i thuhet që duhet të lexojë një tekst sepse do t’i jetë i “dobishëm”, i mjafton të dijë se do të jetë apasionant dhe argëtues.

Nga ky këndëvështrim, Konti i Montekristos rezervon surpriza që vështirë se veprat bashkëkohore na bëjnë të eksperimentojmë. Kjo është lehtësisht e vërtetueshme: nëse sot fillojmë të lexojmë cilindo prej kapitujve të tij, është shumë e vështirë ta heqim nga dora, pa i shkuar deri në fund.

Përvoja e lexuesve të parë të Kontit, të cilët e lexonin çdo javë në një shtojcë të një organi të kohës, dhe me sa duket shprehnin pritjen e mbushur me ankth që diçka do të ndodhte, mund të ripërjetohet edhe nga lexuesit e sotëm të cilët do të lodhen jo pak për t’u shkëputur nga teksti në pika kyçe të tregimit, për t’u kthyer tek përditshmëria e tyre, shumë më banale.

Fakti është se “romanceskja”, ajo origjinalja, është tjetër gjë, në krahasim me atë që ne kemi renditur tashmë. Është projektimi i një botëkuptimi që nuk do të ishte në qoftë se ky roman nuk do të shkruhej. Është e gënjeshtërt në çdo rast, të kërkosh për dëshmi të vërteta të asaj që ne shohim të rrëfyer. Ajo që ne shohim në tregim është gjithashtu një Realitet – një realitet që dallohet qartësisht prej faktit që ne vazhdojmë të besojmë në të dhe ta quajmë “realitet”.

Nga kjo pikëpamje, Konti i Montekristos është një thesar i vërtetë pasurie – pasuri sigurisht e gënjeshtërt, por e destinuar që të rrisë nevojën tonë për një realitet “tjetër”, që nuk reduktohet në meskinitetin e jetës sonë të përditshme.

(Alberto Asor Rosa / La Repubblica)

NJË KRONIKË POETIKE E LUFTËS

(Izet Sarajliq, “Përmbledhja sarajevase e luftës”, “Armagedoni”, Prishtinë, 2017)



Pothuajse në të gjitha poezitë shpaloset shpirti human i poetit, dashuria për njerëzit, miqtë e tij dhe shqetësimi për fatin e jetës së tyre në katrahurën e luftës. Por ka edhe vargje ku ndihet zëri protestës i poetit ndaj miqve të dikurshëm që tani kanë hyrë në radhët e bandave vrastare. Fati i njeriut të luftës, i cili mundohet të mbijetojë, na vjen përmes këtyre vargjeve herë në formë monologu e herë si dialog, ku poeti arrin që komunikimin krijues ta derdhë në vargje herë me nota nostalgjie e herë me zë proteste ndaj një zezone së cilës i bëhen krah edhe shkrimtarët serbë si: Qosiqi, Maksimoviqi, Karaxhiçi, Beqkoviqi etj.

Me një varg të thjeshtë që rrjedhë krejt spontanisht në dukje, jepen mesazhe të fuqishme. Vargjet e tij dalin nga ambiente e rrethana të pazakonshme. Ato shkruhen në Sarajevën e rrethuar, në bodrumet e shtëpive, nën krismat e armëve të dorës dhe artilerisë. E zëri i poetit nuk heshtë. Muza e tij shpërthen muret e nëntokës, shpërthen rrethimin e hekurt të kolonave vrastare. Ai firon i gjallë dhe drita këtyre vargjeve rrezaton më bukur se kurrë me lirinë e Sarajevës. Ëndrra e poetit del më e fuqishme se tytat vrastare dhe ai arrin t’i gëzojë frytet e kësaj lirie.

Duke lexuar këtë libër që është shkruar në Sarajevë, shpeshherë e mendon veten se je në Kosovë, ngaqë janë të njëjtit (anti)njerëz, të njëjtat formacione paramilitare, është e njëjta makineri vrastare. Prandaj, si lexues i këtyre vargjeve, porosia ime për ju është: lexojeni këtë libër që ta kujtoni Bosnjën, që ta kujtoni Kosovën. Me këtë përmbledhje poetike Izet Sarajliqi ka skicuar episode të një lufte të pakuptimtë që fundos ëndrrat e pafajshme të mijëra njerëzve të pafajshëm. Thjesht, kjo mund të lexohet edhe si një kronikë poetike e luftës. *(Izet Abdyli)*

RRËFIMET PËR ROBËRINË DHE LIRINË, OSE SHTEGTIMI I PAMBARUAR I NJË DISIDENTI

(Përkitazi me librin "RRËFIME LIRIE – Shtegtimi i një mësuesi shqiptar nga burgjet serbe te Zëri i Amerikës", e autorit Shaqir Salihu, botoi "Faik Konica", Prishtinë)

Koha Nga Emin AZEMI

Shaqir Salihu, një fëmijë i lindur në luftë, në një fshat ku kishte berber dhe dentist dhe ku banorët nuk e dinin nëse ishin turq a shqiptarë, por që e dinin me saktësi se nuk ishin sllavë, do ta provojë në shtegtimin e tij të gjatë gjithë parabollën e zhvillimit dialektik të jetës, e cila kufizohej brenda ekstremeve, kthesave të lumtura herë herë, por edhe paradokseve.

Libri "RRËFIME LIRIE – Shtegtimi i një mësuesi shqiptar nga burgjet serbe te "Zëri i Amerikës" është i organizuar si një tërësi organike me një funksionalitet të brendshëm përmbajtësor, i ndarë në tri pjesë: PJESA E PARË – RINIA IME NË KOSOVË, BURGU POLITIK DHE NISJA E MËRGIMIT, PJESA E DYTË, ZËRI I AMERIKËS SHQIP: ARRITJET DHE PËRPLASJET NË MEDIEN EPOKALE, PJESA E TRETË VEPRIMTARIA E SHQIPTARËVE TË AMERIKËS

Djalëria e Shaqir Salihut kaloi duke matur mallin e tij përvëlues për vendlindjen me hapat e vegjël por të sigurt të ngritjes në karrierë, fillimisht jashtë fushës së gazetarisë, për të vazhduar dhe burrnuar ciklin e gjatë por të frytshëm të jetës e punës në një medie prestigjioze ndërkombëtare siç është "Zëri i Amerikës" sepse "Historia e Zërit të Amerikës nuk është vetëm historia e një medie, por edhe historia e një galerie të tërë personazhesh që kishin parakaluar aty, ishin personazhe të rëndësishme që kishin lënë gjurmë në kohën kur kishin jetuar e vepruar", shkruan autori.

"RËFIME LIRIE", SEMANTIKA E NJË SINTAGME KONTEMPLATIVE

E kisha dëgjuar zërin e tij jo rrallë në eter dhe pati momente kur bashkëpunuam ngusht gjatë periudhës së shkurtër sa isha raportues i kësaj radioje nga Shkupi, në fillimet e nëntëdhjetave.

E di se Shaqa, siç i thoshim atëherë e sot, ishte shumë i ngrohtë në komunikim dhe përvojën e tij mundohej t'ua bartte edhe të tjerëve jo duke e bërë me imponim e diktat por me takt e mirësjellje të një njeriu që mbi të gjitha çmonte korrektësinë në punë.

Ai me këtë libër që sot kemi në duar, po na thotë se për të qenë i ndershëm nuk mjafton ta duash atë që të takon, por edhe të sakrifikohesh për atë që të mungon.

Është e gjatë lista e atyre gjërave që shqiptarëve iu kanë munguar, me shekuj, madje shumë prej tyre i kishte provuar në lëkurën e tij edhe vet autori, dhe pasi ta kemi lexuar këtë libër, do ta kuptojmë se sakrificat individuale kolektive të shqiptarëve kanë patur një cak të vetëm: Lirinë e atdheut të tyre, të cilit serbët i thoshin "Kosovo i Metohija", kurse shqiptarët Kosovë, e cila më vonë do të bëhet shtet i pavarur, pas një lufte heroike gjithëpopullore dhe një mbështetjeje të fuqishme euroatlantike. Por, gjithashtu, përmes këtij libri, do ta kuptojmë edhe zhgënjimin e autorit me proceset aktuale shtetndërtuese të Kosovës, sepse siç e thotë ai vet : " Kosova për mua është krthyer në makth e jo në realitet".

Duke jetuar një kohë të gjatë në Amerikë dhe duke qenë afër institucioneve dhe aktiviteteve lobuese për Kosovën, autori kishte vërejtur se pas pavarësimit të Kosovës, shumë individë nga nomenklatura politike e Prishtinës, lidhjet me Uashingtonin i përdornin jo për të afirmuar Kosovën, por për të denoncuar kundërshtarin, i përdornin për nevoja personale e jo shtetërore, ngandonjëherë edhe për pak të holla, shkruan autori.

"RËFIME LIRIE", titulli i gjetur jorastësisht i librit, është semantika e një sintagme kontemplative që autori e ndërton vit pas viti, dekadë pas dekade, duke mbledhur grimca përvoje, gëzimi, hidhërimi e zhgënjimi dhe duke formuar prej tyre një ngrehinë vrojtimi për të vëzhguar proceset nëpër të cilat kishte kaluar vet autori, por edhe populli të cilit i takon ai.

Gjeturia e autorit për të përshkruar, fillimisht, jetën në fshat, pastaj edhe hapësirat jashtë vendlindjes, përmes detajeve që shumë lehtë syri ynë i shndërron në imazhe, siç janë livadhet e vendlindjes, lejleku shtegtar, aroma e bukës që piqte nana, treni që kalonte afër fshatit dhe zëvendësonte orën e munguar, dimrat e acartë dhe rrugët e vështira për në pyll ku duhej furnizuar me dru për ngrohje, loja me top arnash, strukja mbi trapazanin e odës, prej ku mund të dëgjoje këngët heroike të shahirëve të kohës, larja të shtunave te hamami i qytetit në Prishtinë, do ta bëjnë këtë libër një model të mirë të publicistikës sonë, e cila ka elemente të mjeshtërisë letrare.

ZHGËNJIMI

Vëzhgimi i detajuar i situatave, përmes përshkrimeve të hollësishëm të njerëzve e ngjarjeve është një proces mjaft kreativ që autori e përdor për të nxjerrë në pah idetë, por edhe porositë. "Fati na fali vërtetë shkrimtarë, poetë dhe apostuj, po jo një personalitet, një burrë shteti me cilësi të jashtëzakonshme që të na udhëhiqte dhe drejtonte , të paktën që nga Lidhja e Prizrenit", ose "Mirënjohja që kemi për SHBA nuk duhet të kthehet në servilizëm për të pranuar çdo gjë, kurse udhëheqësit e Kosovës duhet të mësohen që në raste kur cenohet territori i Kosovës apo sovraniteti i saj, t'i thonë jo kujtdo shteti, përfshirë edhe SHBA-të", shkruan autori, prandaj edhe librin që kemi në duar nuk duhet kuptuar thjeshtë vetëm si kronikë ngjarjesh, por edhe si një projekt ambicioz i mbështetur në premisat e studimit por edhe të sintetizimit të një trashëgimie të dokumentuar, jo aq për individin, sa për kolektivitetin.



"Synimi i kësaj trashëgimie nuk është rrëfimi i jetës sime, por i vuajtjtjeve të miliona shqiptarëve nga serbët dhe grekët. Edhe ajo fosh nje që ndodhet në djep, le të shfletojë nesër këtë libër e shumë e shumë libra të tjerë që tregojnë për dhunën serbo-malazeze e greke ndaj shqiptarëve".

Kështu shprehet autori, teksa shpalos një nga premisat e kësaj kronike studimore.

Shaqir Salihu, siç del nga vetë dëshmia e tij në libër, ishte burgosur për motive politike në v. 1966, vit ky që shënon edhe fundin e karrierës së tij në arsim, konkretisht në fshatin Krajishtë të Liplanit, për t'u arrestuar për të dytën herë më 1969. Përkushtimin e tij për profesionin e mësuesit ai e kishte kuptuar si mision, por edhe si ndërgjegje për gjithë ato sakrifica që edhe Kosova të kishte kandilët e vet të diturisë. Ishin fillimisht mësuesit e Ernest Koliqit që po çjerrnin perden e territ në Kosovë, por edhe këmbëngulja e arsimtarëve patriotë, siç ishte Zekerija Rexha që në në truallin e Kosovës të hidhnin farën e dijes e emancipimit kulturor e kombëtar.

Produkt i kësaj atmosfere politike, e arsimore të viteve 60 në Kosovë, është edhe Shaqir Salihu, figurën e të cilit e shohim pastaj të shkrihet në arealin më të gjerë të ambicjeve liridashëse për të kulmuar në demonstratë e viti 1968, ngjarje këto që shënuan një kthesë të madhe edhe në jetën e autorit. Vetëm një vit pas këtyre ngjarjeve ai vendos përfundimisht ta braktis vendlindjen, fillimisht duke qëndruar përkohësisht në qytezën Atina të Italisë, konkretisht në bujtinën e restorantit Tratoria "La Pineta", rruga San Nicola nr. 12 , sistemim ky që u bë falë bujarisë së pashoqe të klerikut shqiptar Dom Prenka , dhe takimi pastaj me Ernest Koliqin në Romë dhe patriotë të tjerë, për t'u vendosur përfundimisht në SHBA , ndonëse atë gjatë kohë e kishte munduar një krimb ndërgjegjeje, apo siç do ta thoshte vet ai : "Vendimi që mora për të ikur nga Kosova ishte egoist , për të shpëtuar veten e jo popullin e Kosovës...." një formulim ky që e hasim vetëm te autorët që dilemat etike i bënte publike, kurse pastërtinë e ndërgjegjes ishte i gatshëm ta testonte publikisht dhe tepër sinqertë.

Kalimi nga aparthejdi rankoviqian i viteve 60 në Kosovë në një demokraci të konsoliduar siç ishte Amerika, është trajektorja që përmbledh një seri ngjarjesh, përjetimesh, gëzimesh e zhgënjimesh të autorit. Kur jemi te zhgënjimet, Shaqiri nuk e fsheh pezmin por edhe keqardhjen për gjendjen e shërbimit shqip të "Zërit të Amerikës", që fillon me eliminimin, siç thotë ai, të kosovarëve të VOA, për të vazhduar me një seri problemesh, përçarjesh, përjashtimesh arbitrare e ndërskamsash që kishin përshkuar këtë radio. Sipas tij, kriza që kaploi seksionin shqip të VOA ndikoi edhe në rënien e moralit për punë.

PËRTEJ KRONOLOGJISË STEREOTIPE

Shkruar me një bazament të lakmueshëm etik e profesional, libri i Shaqir Salihut ' RRËFIME LIRIE" tejkalon pretendimet e një kronologjie stereotipe.

Janë disa tipare që do ta veçonin këtë libër të jetë përtej këtyre pretendimeve, kurse ne po veçojmë tri më kryesoret:

E para – duke qenë kronikë e jetuar e ngjarjeve dhe kontakt i drejtpërdrejt me protagonistë të shumtë, ky libër synon të plotësojë arkivën e një historie të bujshme, siç ishte mërgata shqiptare e Amerikës, me një histori mbi një shekullore

E dyta – sinqeriteti dhe çiltërsia e autori i kanë dhënë librit dimensionin e ngritjes në vlera humane e utilitare të veprave që nuk bëhen për individin dhe për aktualitetin, por bëhen për kolektivitetin dhe brezat që pasojnë

E treta – e shkruar me një gjuhë të drejtpërdrejt, qasja e autorit është e pa kompromis ndaj padrejtësive që i janë bërë atij personalisht, edhe popullit që i takon, por me një plotësim domethënës se kjo qasje nuk kishte asnjë dozë hakmarrjeje dhe qërim personal të hesapeve me jobashkëmendimtarët

Përmbyllja më e natyrshme e kësaj qasjeje për librin "RRËFIME LIRIE" të disidentit, veprimtarit dhe gazetarit Shaqir Salihu do të mund të bëhej në bashkëshoqërim me një mendim të tij: "Një problem kryesor sot është se drejtuesve të politikës në trojet shqiptare u duket se transformimet në Ballkan kanë mbaruar".

Çfarë shkruante Jul Çezari për Ilirinë?

Gaius Jul Çezari (100-44 pr. K) u shqua jo vetëm për strategji e mendjemprehtësi politike, por edhe për veprimtari letrare historike, të cilat e radhitin atë ndër shkrimtarët më të mirë të kohës. Nga Çezari janë ruajtur dy vepra të plota me përmbajtje historike. "Komentarët" (Ditarët) "Mbi Luftën Gale" dhe "Mbi Lufën Civile".

Kjo e fundit ka një rëndësi të posaçme për historinë e ilirëve, mbasi një pjesë e ngjarjeve që përshkruhen në këtë vepër zhvillohen në trevën tonë në vitet 49-48 pr.K, kryesisht në brigjet detare nga Akrekeraunet gjer në Lis.

Lufta Civile (Libri III-12, 16, 42)

...Pas dorëzimit të Orikut, Çezari pa u vonuar,... u nis për në Apoloni. Lue Stabori sundimtar i atjeshëm, sa mori vesh se Çezari po afrohej urdhëroi të sillnin ujë në kështjellë, ta fortifikonin atë, e njëkohësisht kërkoi pengje për Apollonianët.

Por ata u përgjigjën se nuk do të jepnin pengjet, nuk do t'ia mbyllnin portat konsullit dhe nuk do të merrnin ajnjë vendim kundër asaj që kish caktuar mbarë Italia e populli romak. Stabori, pasi mori vesh qëllimet e tyre, iku nga Apolonia fshehurazi.

Atëherë apollonianët dërguan delegatë te Qezari dhe e pranuan në qytet. Shembullin e tyre e ndoqën edhe bylnët e amantët bashkë me qytetet e tjera që ishin afër, përfshi gjithë Epirin. Dërguan delegatë te Qezari dhe i premtuan se so të bënin si të urdhëronte ai...

Në këtë kohë, Çezari, kishte shkuar për të shtënë në dorë, me një legjion, disa qytete të largëta dhe për të rregulluar furnizimin e ushtrisë, e cila ishte e ngushtë me ushqime për arsye se këto ndodheshin në Buthrot, përkundrejt Korkyrës. Këtu, me të marrë vesh nga letrat e Acilit dhe të Murkos dëshirën e Libonit dhe të Bibulit, la legjionin dhe vetë u kthye në Orik...

Në këtë kohë Pompeu ndodhej në Kandavi dhe prej Maqedonie po udhëtonte për Apoloni dhe Dyrrah për dimërim.

Po i tubulluar nga këto lajme, filloi ta shpejtonte udhëtimin për Apolloni, që të mos i pushtonte Çezari qytetet e bregdetit. Po Çezari si zbarkoi ushtrinë, poa të ditë u nis për në Orik. Këtu, Luc Torkuati, që sundonte në qytet me urdhër të Pompeut, dhe që kishte aty garnizionin e partinëve, mbylli portat dhe u mat ta mbronte qytetin.



JANIS RICOS

AKUARELE

Ditët e fundit me diell të vjeshtës - varka peshkimi
Të trishta që kthehen në mbrëmje
Anës detit kinkaleritë mbyllur, përpara derës së xhamtë
të kafenesë
të ngadalta gjestet e erës,
oktapodin në sofat godet një peshkatar,
pulbardhat në shkëlqimin e ujit
varen si maska të vogla prej gipsi.

Ah, ajo vajzë fqinje me rrobat e ngushta,
Me duart e ashpra të punës, me barin e njomë në flokë,
Me aromën e sapunit mëngjesor në hapin e saj,
Me dy jargavanë të hershëm të lulëzuar në durimin e saj,
Ka një push nëne në prekje, thua se e morën retë prapa maleve,
Larg – larg, të ndreqë dhomat e tyre,
Të lajë ndërresat e të pikëlluarve? Mirmbrëma ylli im i mbrëmjes, tha,
Është e vetmuar shtëpia jonë. Nuk erdhi ende.
Porta ka mbetur si libër i mbyllur.
Koha veshrëndë, molën tërheq duke pirë llullën vet,
As britma, as heshtje, as kënga nuk e kthen pas.
Në grinë e dritares një degë ku vareshin katër yje,
Të ishin ato tonat të paktën, kish thënë. Nuk janë.

Jashtë në lagje zëra fëmijësh. Një aromë gështënjash të pjekura.
Zbatharake vjeshta me xhepat mbushur me fara luledielli të kripura.
Hija e observatorit fisarmonika e një të verbri dhe një kitarë,
Dy fëmijë të heshtur që shëtisin në stacion zënë dorë për dore.

Dhe vrenjtet. Në qoshen e rrugës shurron furrëtari.
Nuk mbeti asgjë,
Vetëm varkat në gjëmimin e furtunës
Do kërcasin tani dërrasat e tyre, do të njomen.
Nuk do durojnë deri vitin tjetër.

PO BIE MBRËMJA

U shua perëndimi në pasqyrën e dhomës së gjumit.
Prej kohësh gjimnazistët janë kthyer në shtëpi.
I thellë qielli, i trishtuar, i heshtur
Dhe nëpër xhama hija e tij qumështi.

Të hidhura shtëpitë e peshkatarëve,
Si athere kur ishim të vegjël dhe krejt vetëm iku nëna,
Dhe gjëmon fishkëllima e anijes mes kabinave
Aty në vëndet bosh ku ishin valixhet ngjyrë kafe.

Shërbëtori ndez llambën e dhomës së ngrënies
Dhe dalin nga hija fytyrat e largëta,
Ashtu , si gjahtari zbraz çantën në mbulesën blu
Dhe bien zogj të verdhë me krahë të mbyllur.

I NJËJTI YLL

Strehët e lagura shkëlqejnë nën dritën e henës.
Në boçen e tyre mbyllen gratë. Të fshihen në shtëpi nxitojnë.
Edhe pak po të qëndrojnë në prag, hëna do t'i shikojë tek qajnë.

Ai dyshon mes çdo pasqyre
Një tjetër grua, të tejdukshme, të përjashtuar
Mes lakuriqësisë saj,
Sado që të duash ta zgjosh, nuk zgjohet.
Ra në gjumë duke nuhatur një yll.
Dhe ai nuhat po të njëjtin yll duke qëndruar pa gjumë.

VERË

Të katërta dritaret në dhomë varin
Katërvargësha të rimuar nga diell dhe det.
Një lulëkuqe e vetmuar është një sahat i vogël
Në dorën e verës, që të tregojë
Ora është dymbëdhjetë, mesditë.
Dhe kështu ndjen mes gishtave të diellit
Flokët e kapur mes dritës e ajrit të të mbajnë të lirë.

THJESHTËSI

Fshihem pas gjërave të thjeshta, që të më gjeni;
Po të mos më gjeni, do gjeni gjërat,
Do prekni ato që ka prekur dora ime,
Do takoni gjurmët e duarve tona.

Hëna e gushtit shkëlqen në kuzhinë
Si tenxhere e kallaisur (për çka u them kështu ndodh)
Ndriçon shtëpinë e zbrazët dhe heshtjen e gjunjëzuar
të shtëpisë,
heshtja e gjunjëzuar mbetet gjithmonë.
Çdo fjalë është një portë daljeje
Për një përpjekje shpesh herë pa qëllim
Dhe atherë është një fjalë e vërtetë,
Tek ngulmon për takim.

KALIMI PRANVEROR I NJË GRUAJE

Kaloi në rrugicën e bardhë përballë,
E hijshme, mes sigurisë së pa faj të bukurisë së saj.
Dita ishte e artë dhe e dëndur. Trupi i gruas
Në çdo lëvizje, linte një zbrazëti në ajër,
Pikërisht në formën e trupit. Kështu prapa
Mbesnin një sërë statujash të tejdukshme, gjer tutje,
Deri në kthesën e rugës ku humbi. At'herë
Menjëherë u zbraz dita. U ulën grilat në dyqanin e luleve,
Ndërsa statujat e tejdukshme, të zhveshura, mermeroheshin
Deri në skaj të horizontit si një varg pemësh
Dhe një shi i hollë fillojë të bjerë mbi supet e tyre të mermerta.

NGA BRËNDA APO NGA JASHTË

Është një ngjyrë e kuqe e furishme, si e qeshura,
Në atë strehë, ndërmjet pemëve,
Është dhe ngjyra e shkurtët e hijes së një dege sipër ujit.
Një grua bëri një gjest ajror sikur do mbërthente fustanin
Me zërin e një zogu. Dhe ndjeva i habitur
Që hyja aq thjeshtë mes zërit tim.
Më lart
Vetëm një gjethe krejt e gjelbër sundon në peizazh
Dhe zëmra vendoset kaq mirë te bota
Si çelsi te dera e shtëpisë sime. Do ta hap...

DRITË

Një degëz bajame
Përpara dritares
Një degëz vetëm
Të fsheh gjysmën e fshatit.

Dashuria me pëllëmbë
Të fsheh botën të tërë.
Mbetet vetëm drita.

Që nga nëntori i 2017-ës procedura e vizave të punës për shtetasit e Ballkanit Perëndimor është më e thjeshtë dhe realizohet brenda një etape

LEGALISHT NGA BALLKANI NË GJERMANI

Kur rregullorja për Ballkanin Perëndimor hyri në fuqi, më 1 janar 2016, procedura për marrjen e vizës ishte e dyfishtë. Punëmarrësit shtronin kërkesë për vizë te përfaqësitë e Gjermanisë në vendet e tyre, dhe njëkohësisht punëdhënësit kërkonin leje paraprake te Zyra e Punësimit në vendndodhjen e kompanisë. Kjo procedurë zgjaste me muaj dhe binte ndesh me dëshirën për punësim sa më të shpejtë. Prandaj prej nëntorit të vitit 2017 procedura është thjeshtëzuar. "Miratimi paraprak nga Zyra e Punësimit nuk është më i nevojshëm", sqaron për Deutsche Wellen Sascha Andreas Kienzle (Sasha Andreas Kincle) nga Ministria e Punëve të Jashtme të Gjermanisë. "Tani mjafton që kandidati të paraqesë në Ambasadën e Gjermanisë të gjitha dokumentet e nevojshme, duke përfshirë edhe vërtetimin nga punëdhënësi".

KONTROLLIMI NË GJERMANI

Pasi të jenë dorëzuar dokumentet në konsullatë, kontrollohen nga autoritetet përkatëse në Gjermani. "Nëse plotësohen të gjitha kushtet, atëherë jepet viza", thotë Kienzle më tej. Me kontrollin e dokumenteve, krahas Ministrisë së Punëve të Jashtme, pjesë e së cilës janë ambasadat, merren edhe Ministria e Brendshme dhe Ministria Federale e Punës dhe e Çështjeve Sociale, nëpërmjet Agjencisë Federale të Punësimit. "Kur shtrohet kërkesa për vizë pune, ne kontrollojmë se a ka ndonjë shtetas gjerman ose evropian me të njëjtin kualifikim që ka aplikuar për të njëjtin vend", thotë për DW, Paul Ebsen, zëdhënës i Agjencisë Federale të Punësimit. Prandaj dokumentet duhet të dërgohen në zyrën e punës të qytetit ku ndodhet vendi i punës dhe, pasi të jenë kontrolluar, kthehen sërish. Zyra e punës kontrollon vetëm formalisht, se a ka ndonjë kandidat të përshtatshëm me shtetësi gjermane ose nga vendet e BE-së për këtë vend. Kjo nuk zgjat më shumë se 14 ditë, siguron Paul Ebsen. Nëse marrja e një vize zgjat më shumë, kjo varet nga rrethanat individuale të aplikuesit".

KUSHTET NUK KANË NDRYSHUAR

Kushtet që duhen plotësuar për marrjen e vizës së punës kanë mbetur të njëjtat: punësimi në ndërtim ose gastronomi nuk kërkon as njohuri gjuhe e as njohuri profesionale. Vetëm për infermierët ose kujdestaret mjekësore kërkohen njohuri gjuhe dhe dëshmi licencimi a diplomat e shkollës profesionale. Kushtet përshkruhen në mënyrë të hollësishme në fletushkat informative të ambasadave. Azilantët mbeten të përjashtuar nga ky rregull. "Azilkërkuesit, që deri 24 muaj para se të shtrojnë kërkesën kanë marrë ndihma në bazë të ligjit të azilkërkuesve, nuk kanë të drejtë të marrin vizë pune", thotë Kienzle. Këtu bëjnë përjashtim azilantët që kanë shtruar kërkesën për azil nga 1 janari 2015 deri më 24 tetor 2015, por që deri më 4 maj 2016 kthyen vullnetarisht në vendet e tyre. Të përjashtuar nga ky rregull janë edhe azilantët që jetojnë në Gjermani. I ashtuquajturi "ndërrim korsie", pra kalimi nga statusi i refugjatit në atë të imigrantit ekonomik, të cilin e kërkojnë tashmë prej kohësh shumë organizata refugjatësh, nuk lejohet ende. Azilantët duhet të kthehen në vendet e tyre për të hyrë sërish si imigrantë në hapësirën Schengen.

MBI 35 000 VIZA PUNE PËR BALLKANIN

Në vitin 2017, Gjermania lëshoi 35 200 viza pune për vendet e Ballkanit Perëndimor, siç bën të ditur për Deutsche Welle-n Ministria e Punëve të Jashtme të Gjermanisë. Vendin e tretë e zënë shtetasit nga Kosova (me 6087 viza pune), pas Bosnjë-Hercegovinës (9913) dhe Serbisë (9577). Shqipëria (3126) vjen pas Maqedonisë (5584), ndërsa Mali i Zi ishte vendi që solli më pak imigrantë ekonomikë (913) në Gjermani, në vitin 2017. Pjesa dërrmuese punojnë në sektorin e ndërtimit dhe gastronomisë, por ka edhe shumë që janë punësuar si pastrues apo kujdestarë shëndetësorë. Specialistët e kualifikuar janë të paktë dhe zënë vetëm 2.5 për qind të gjithë imigrantëve nga Ballkani.

GASTARBEITER TË RINJ

Viza e punës jepet për aq sa zgjat kontrata. Kur kontratës i përfundon afati, imigrantët duhet të kthehen sërish në vend. Por nëse kanë paguar sigurime shoqërore, ata mund të gëzojnë përfitimet nga asistenca e papunësisë, sigurimet shëndetësore dhe pensionet. Prandaj nuk përjashtohet mundësia, që sikurse të ashtuquajturit Gastarbeiter, edhe imigrantët e dikurshëm të viteve '60 dhe '70, të mbesin në Gjermani, edhe pasi e kanë humbur vendin e punës. *(DW)*

GASTARBEITER TË RINJ

**Viza e punës jepet për aq sa zgjat kontrata. Kur kontratës i përfundon afati, imigrantët duhet të kthehen sërish në vend.
Por nëse kanë paguar sigurime shoqërore, ata mund të gëzojnë përfitimet nga asistenca e papunësisë, sigurimet shëndetësore dhe pensionet. Prandaj nuk përjashtohet mundësia, që sikurse të ashtuquajturit Gastarbeiter, edhe imigrantët e dikurshëm të viteve '60 dhe '70, të mbesin në Gjermani, edhe pasi e kanë humbur vendin e punës.**

PROTESTË E MADHE NË ATHINË

“DUART LARG MAQEDONISË!”

Nga të gjitha skajet e Greqisë u mblodhën të dielen në Athinë në sheshin përpara parlamentit mbi 1 milion e 500 mijë qytetarë në tubimin masiv kundër emrit të Maqedonisë. Një sondazh i zhvilluar nga gazeta konservatore “Kathimerini” tregoi se 70 për qind e grekëve kundërshtojnë përdorimin e termit “Maqedoni” në çfarë zgjidhjeje.

Me moton “Maqedonia është greke”,protestuesit kundërshtojnë çdo lloj përdorimi të termit Maqedoni në emrin e ri që pritet të vendoset pas negociatave intensive mes Athinës dhe Shkupit zyrtar, raportojnë agjencitë e lajmeve.

Në mesin e protestuesve të dielen në Athinë kanë qenë edhe kryetarë, figura të larta fetare, zyrtarë ushtarak grekë, ish kryeministri, Antonis Samaras, i cili ka qenë ministër i Jashtëm i Greqisë, kur ka filluar konflikti më 1991.

Të parët që mbërritën para parlamentit ishin qytetarët nga Kreta dhe Selaniku. Në drekë, protesta pritët të shënojë kulmin me fjalimet që pritet të mbajnë figura të njohura, mes tyre dhe kompozitori grek 87-vjeçar Mikis Theodhorakis, shtëpia e të cilit u sulmua dje nga persona të panjohur.

Fjalim do të mbajnë gjithashtu dhe përfaqësues të Sinodit të Shenjtë, të cilët janë shprehur kundër përdorimit të termit Maqedoni.

Për tubimin ishte përgatitur një flamur grek me përmasa shumë të mëdha.Në të gjitha rrugët e Athinës shiten flamuj të Greqisë me emblemë të Bizantit.

“Maqedoni do të thotë Greqi” shkruan në një baner të madh në sheshin e Sintagmës, që ka qenë sheshi kryesor i protestave kundër masave të ashpërsuara që kur nisi kriza e borxheve të Greqisë më 2010. Protestuesit valonin flamujt grekë dhe mbanin në duar banerë me mbishkrime “Duart larg Maqedonisë!”.

Në mesin e folësve para protestueseve është edhe kompozitori grek me famë botërore, Mikis Theodorakis. Disa orë para tubimit, keqbërës të panjohur hodhën ngjyrë të kuqe para shtëpisë së artistit majtist 93 vjeç, që njihet si simbol i rezistencës gjatë viteve 1967-1974, dhe shkruan slogane në mure kundër përfshirjes së tij.

Një sondazh i zhvilluar nga gazeta konservatore “Kathimerini” tregoi se 70 për qind e grekëve kundërshtojnë përdorimin e termit “Maqedoni” në çfarë zgjidhjeje.

Qeveria e Tsipras ka thënë se është e përgatitur për të pranuar një emër të përbërë që e dallon atë qartë nga Maqedonia greke.

Po ashtu ka thënë se protestat nuk do të ndikojnë për përpjekjet për ta zgjidhur këtë çështje.

“Duke mos pasur një zgjidhje dëmtojnë interesin tonë kombëtar”, ka thënë kryeministri Tsipras së fundmi.

Jugu i Shqipërisë nën ujë

Reshjet e dendura të shiut kanë shkaktuar përmbytje në pjesën jugore të Shqipërisë duke dëmtuar dhjetëra shtëpi. Ndërkaq, i menjëhershëm ka qenë edhe reagimi i qeverisë duke dërguar ekipe shpëtimi nga ana e ushtrisë. Këtë e ka bërë të ditur edhe ministrja Mbrojtjes të Shqipërisë, Olta Xhacka duke shprehur se Forcat e Armatosura janë në terren. “Po ndjekim minutë pas minute situatën në Gjirokastër dhe Zallbastar ku Forcat e Armatosura janë pranë komunitetit. Me bashkitë, prefekturat dhe të gjitha strukturat përkatëse në të gjithë vendin prej ditësh kemi informuar dhe koordinuar paraprakisht, për t’i paraprirë situatave të mundshme te shkaktuara nga reshjet e dendura. Jemi pranë qytetarëve për çdo nevojë të mundshme”, ka thënë ajo. Ndërkaq, sipas Institutit Meterologjik reshjet e shiut do të vazhdojnë edhe gjatë ditës së sotme. Vetëm në orët e mbrëmjes do të ketë pakësim të reshjeve.

Prej 48 orësh trageti i linjës Vlorë-Brindisi nuk ka kryer asnjë lundrim. Kapiteneria ka njoftuar pezullimin e përkohshëm të lundrimit, për shkak të motit të keq.

Si pasojë e erërave të forta disa pemë dekorative në zonën e Lungomares janë thyer, po ashtu dhe shumë biznese përgjatë bregdetit kanë pësuar dëme.

Edhe në Durrës, është e njëjta situatë. Një nga dy tragetet e linjës Bari-Durrës për shkak të detit të trazuar është detyruar të ndryshojë kursin e lundrimit duke regjistruar një vonesë mbi 3 orëshe në mbërritje.

Lidhur me këtë situatë, ka reaguar kryeministri Edi Rama, ku përmes një status në ‘Facebook’, ka bërë me dije se shteti është në krye të detyrës.

“Që prej ditës së djeshme vazhdon pa ndërprerje angazhimi në terren i të gjitha strukturave të shtetit në përballimin e situates së krijuar nga moti i rënduar si edhe për të qenë pranë familjeve të prekura.”, shkruan Rama

ALBERT ROHAN

Pavarësia e Kosovës është e pakthyeshme

“Pavarësia e Kosovës është e pakthyeshme edhe nëse Serbia e Rusia e disa vende tjera vazhdojnë ta mohojnë atë”. Kështu thotë në një shkrim të tij Albert Rohan, një diplomat austriak dhe ish-emisari i OKB-së në negociatat për statusin e Kosovës. Rohan tregon kur Kosova shpalli pavarësinë më 17 shkurt të 2008-ës, duke u bërë kështu shteti më i ri në Evropë. Por, tregon se si kosovarët përjetuan edhe shtypjen nga Beogradi. “Ishte moment që kishte dy parime të së drejtës ndërkombëtare- integritetin territorial të shteteve dhe të drejtën e njerëzve për vetëvendosje”, shkruan ai, transmeton Koha.net.

Rohan thotë se baza për pavarësinë e Kosovës ishte pikëpamja mbizotëruese në të drejtën ndërkombëtare që pakicat që pësojnë diskriminim sistematik kanë të drejtë të shkëputen. Pra, kjo siguroi bazën për njohjen e Kosovës edhe nga shumica e shteteve anëtare të OKB-së.

Daçiq: Jemi të gatshëm për marrëveshje historike me Kosovën

Ministri i jashtëm në Serbi, Ivica Daçiq ka thënë edhe një herë se shteti serb nuk ka asnjë gjasë ta pranojë pavarësinë e Kosovës.

Por ai ka deklaruar se janë të gatshëm për një kompromis në mënyrë që të arrihet një marrëveshje historike.

“Ne duam që të arrijmë një kompromis me Kosovën, por nuk mund ta miratojmë shkëputjen e njëanshme të tyre”, deklaroi ministri serb, transmeton lajmi.net.

Ai kritikoi shtete e mëdha që sipas tij po i bëjnë presion Serbisë ta njohin pavarësinë e Kosovës.

“Si mund të mos i’u vije turp që të na propozojnë një gjë të tillë. Ne ju kemi treguar se marrëveshja është e domosdohsme me Kosovën, por kjo nuk do të thotë se ne e njohim pavarësinë”, ka theksuar Ivica Daçiq.

“Kosova kurrë nuk do të bëhet e pavarur, sepse Serbia ka miq në anën e saj, e mbi të gjitha Rusinë dhe Kinën”, ka përfunduar ministri serb, Ivica Daçiq.

E ARDHMJA E KOALICIONEVE NË GJERMANI

A VJEN ORA E SOCIALDEMOKRATËVE?

Nëse bisedimet për koalicionin gjerman përfundojnë me sukses, vjen ora e socialdemokratëve. Anëtarët e kësaj partie do të vendosin për koalicionin me bazë të gjerë me konservatorët. Por çfarë ndodh, nëse ata thonë „Jo"?

Pak pas bashkimit të Gjermanisë, SPD numëronte rreth 1 milionë anëtarë. Ndërkohë vetëm 440.000 vetë janë anëtarë të Partisë Socialdemokrate. Pa miratimin e anëtarëve nuk do të ketë koalicion të madh me konservatorët, thonë krerët e partisë. Kjo do të thotë që 440.000 anëtarët e saj do të marrin një letër nga posta së shpejti, marrëveshjen e koalicionit. Shumë do të lexojnë me vëmendje e do të pyesin- a mund të kuptohet toni socialdemokrat në këtë marrëveshje?

Ashtu si para katër vjetësh ishin socialdemokratët që e thanë fjalën e fundit për një koalicion me CDU e CSU-në. Ata votojnë me letër me „po" ose „jo". Kundërshtarët e koalicionit kanë bërë thirrje për anëtarësime të reja që të pengojnë një aleancë të tillë. Vërtet pas kongresit të jashtëzakonshëm, SPD shënon rritje të anëtarësimeve, por nuk dihet nëse anëtarët e rinj janë pro ose kundër koalicionit.

Ndryshe nga zgjedhjet e fundit, kur 76% e anëtarëve socialdemokratë ishin pro një qeverie të re, kësaj here anëtarët e partisë mund të bëjnë që të bjerë koalicioni me bazë të gjerë. Shumë socialdemokratë nuk shohin se po përmbushen kërkesa të rëndësishme të partisë së tyre. Po ashtu ata ende nuk e pranojnë kthesën që bëri Martin Schulz pas dështimit të negociatave për koalicionin „Xhamajka". Nëse në fillim ai e pa vendin e SPD-së vetëm në opozitë, tani Schulz po e çon SPD-në rishtazi një koalicion të madh si partneri më i vogël. E kjo megjithëse, SPD nën qeverisjen e Merkelit është dëmtuar gjithnjë e më shumë. Miratimi për Martin Schulz brenda partisë ka rënë dukshëm.

Janë anëtarët e organizatës rinore socialdemokrate që bëjnë thirrje për „jo". Ata nuk duan më „politikë të emëruesit më të vogël të përbashkët". „Demokracia jeton nga përplasja e kampeve të ndryshme, por ky ballafaqim nuk zhvillohet dot në një koalicion të madh", argumenton zëri më i fuqishëm i kundërshtarëve të koalicionit të madh, Kevin Kühnert.

Por çfarë ndodh, nëse anëtarët e SPD-së votojnë kundër koalicionit të madh? „Atëherë ka zgjedhje të reja", thuhet shpesh. Por kaq e thjeshtë nuk është. As Bundestagu nuk e shpërbën dot veten e as Merkel apo Schulz nuk i shpallin zgjedhjet e reja. Kushtetuta gjermane parashikon stabilitetin e jo zgjedhje të shpeshta të reja. Cilat janë hapat e mundshëm? Në rast të tillë e ka radhën, presidenti gjerman Frank-Walter Steinmeier. Ai mund të propozojë një kandidate apo kandidat për kancelar. Para se të thirret të votojë populli, duhet që përfaqësuesit e tij në parlament, të mblidhen për të zgjedhur një kancelare apo kancelar të ri.Nëse ajo apo ai vijnë nga qeveri pakice apo shumice kjo nuk është parësore. Nga një zgjedhje e tillë varen të gjitha zhvillimet e tjera.

Presidenti Frank-Walter Steinmeier do t'i propozojë pra Bundestagut kandidatin për kancelare ose kancelar. Edhe nëse dështojnë negociatat e koalicionit të madh, me shumë gjasë kandidatja do të jetë Angela Merkel. Ajo është kryetare e partisë që fitoi më shumë vota në zgjedhje. Për zgjedhjen e saj, ajo ka nevojë për 709 vota deputetësh, shumicën. Deri më tani të gjithë kancelarët gjermanë, edhe Merkel, janë zgjedhur në raundin e parë.

Në këtë rast ka gjasa që të kemi ndryshime. Pas dy përpjekjeve të dështuara për koalicione, Merkel me gjasë do të humbiste shumicën. Pas kësaj – sipas kushtetutës- ka një afat prej 14 ditësh. Në këtë kohë, Bundestagu mbi bazën e propozimeve të veta do të mund të propozojë një kancelare apo kancelar. Edhe këtu kërkohet shumica absolute. Nëse kjo nuk arrihet, duhet që të zhvillohet „pa vonesë një votim i ri", parashikon neni 63 i kushtetutës që ul barrierën – në zgjedhjen finale mjafton një shumicë e thjeshtë e votave.*(DW)*

Erdogan viziton Romën

Masat e sigurisë janë rritur në nivelin më të lartë në Romë për shkak të vizitës zyrtare dyditore të Presidentit të Turqisë, Recep Tayyip Erdoğan, në Vatikan, me ftesë të Papa Françeskut, transmeton Anadolu Agency (AA). Për shkak të vizitës zyrtare dyditore që fillon të dielen të Presidentit Recep Tayyip Erdoğan në kryeqytetin e Italisë, Romë, janë marrë masa të jashtëzakonshme të sigurisë. Në qytet do të jenë në detyrë 3.500 forca të sigurisë.
Gjatë vizitës së Presidentit Erdoğan do të jenë të angazhuar edhe njësitë NBCR të cilat janë të trajnuara kundër rreziqeve "bërthamore, biologjike dhe kimike".
Në Vatikan pas 59 vitesh për herë të parë zhvillohet një vizitë në nivel presidencial nga Turqia, ku në kuadër të kësaj vizite, Erdoğan pas takimit me Papa Françeskun do të takohet edhe me sekretarin e shtetit të Vatikanit, Pietro Parolin. Pas vizitës në Vatikan, Erdoğan do të takohet në Romë me Presidentin e Italisë, Sergio Mattarella dhe me kryeministrin e vendit, Paolo Gentiloni.
"Europa duhet të mbajë premtimet e bëra sa i takon aderimit të Turqisë në Bashkimin Europian". Kështu është shprehur presidenti turk, Recep Tayyp Erdogan, para vizitës së tij zyrtare në Itali, ku do të takohet me Papa Françeskun, kryeministrin Paolo Gentilioni dhe Presidentin e Republikës, Sergio Mattarella.
"Hyrja e Turqisë në BE, – shpjegon ai, – nuk mund të sakrifikohet me përllogaritje politike të brendshme".

TURQIA PO PLANIFIKON TË VAZHDOJË LUFTIMET

Ka hyrë në ditën e 16-të ndërhyrja ushtarake e Turqisë në Siri për të luftuar grupet kurde të ashtuquajtura PYD dhe luftëtarët e grupit terrorist ISIS. Sipas një njoftimi për shtyp nga Forcat e Armatosura të Turqisë, bilanci i këtyre operacioneve është 932 kurdë dhe terroristë të vrarë si dhe pesë shënjestra të shkatërruara. Ushtria turke thekson se asnjë avion luftarak i saj nuk është sulmuar gjatë luftimeve. E njëjta komunikatë bën me dije gjithashtu se 13 ushtarë turq kanë rënë dëshmorë dhe 57 të tjerë janë plagosur në kuadër të operacionit "Dega e Ullirit". Pavarësisht se fillimisht ky operacion nuk u mirëprit nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Turqia më 20 janar filloi operacionin 'Dega e Ullirit', kundër kurdëve dhe DEASH-it në Afrin të Sirisë. Pas marrjes së qytetit Afrin, Turqia po planifikon të vazhdojë luftimet në qytetin e Munbijit, por në këtë qytet ndodhen edhe ushtarë amerikanë dhe një ndërhyrje e mundshme mund të shkaktojë konflikt me këta të fundit. Ndërsa, ushtria amerikane ka bërë të ditur se nuk do të largohen nga ky qytet. Zëvendëskryeministri i Turqisë, Bekir Bozdag ka kërcënuar ashpër duke shprehur se do të luftojnë edhe ushtarët amerikanë nëse dalin me veshje të terroristëve. Një konflikt ushtarak SHBA-Turqi do të ishte fatale për organizatën ushtarake NATO, pasi këto dy shtete kanë shumë influencë në të. Ushtria Amerikane është më e avancuar nga ana teknologjike, por Turqia ka numrin më të madh të ushtarëve në NATO.

MAGJIA E BROKOLIT PËR SËMUNDJET E MUSHKËRIVE

Perimet si brokoli janë në gjendje të rrisin efektivitetin e një lloji të veçantë të qelizave të bardha të gjakut që është vija e parë e mbrojtjes së zorrëve kundër patogjenëve. Por nuk është vetëm brokoli që është i ngarkuar me përfitime shëndetësore...

Boronicat janë të përbëra nga qeliza që shërbejnë si 'vrasës' natyror që luftojnë kundër viruseve dhe qelizave të kancerit. Lakra e kuqe, siguron disa nga nivelet më të larta të antioksidantëve tre herë më shumë boronica. Domatet gjithashtu duket se kanë fuqi të posaçme për rritjen e imunitetit: pirja e lëngut të domates mund të shpëtojë funksionin imunitar të njerëzve të cilët nuk kanë pasur konsumuar fruta dhe perime për dy javë.

Sëmundjet e mushkërive po përhapen shumë vitet e fundit dhe për shkak të faktorëve të shumtë që përballemi çdo ditë. Dr Michael Greger i cili është zëri kryesor për fuqinë shëruese të dietës dhe mënyrës së të jetuarit shëndetshëm, kur me librin e tij "Si të mos vdesim" në vitin 2016, u bë një best-seller në Mbretërinë e Bashkuar, na tregon se si një dietë me bazë bimore mund t'ju mbrojë ndaj sëmundjeve të mushkërive.

Në Mbretërinë e Bashkuar 10.000 njerëz janë diagnostikuar me sëmundje të mushkërive çdo javë, dhe dikush vdes nga kjo sëmundje çdo pesë minuta, ku 20 për qind e vdekjeve vijnë nga kjo sëmundje. Studimet e fundit, siç transmeton ATSH, tregojnë se një dietë me bazë bimore e shëndetshme mund të ndihmojë në zbutjen e efekteve dëmtuese të ADN-së nga tymi i duhanit, si dhe ndoshta të ndihmojë në parandalimin e përhapjes së kancerit të mushkërive. Për fat të keq, nuk ka shërim për COPD (sëmundje kronike të mushkërive), e cila, përveç gulçimit, shkakton kollitje të rënda, prodhim të tepërt të mukozës, ngacmim dhe ngushtësi në gjoks. Por ka disa lajme të mira: një dietë e shëndetshme mund të ndihmojë për ta parandaluar ose të mbajë sëmundjen nën kontroll. Ky mund të jetë një lajm shumë i rëndësishëm për 1,2 milionë njerëz që vuajnë nga sëmundja e mushkërive në Mbretërinë e Bashkuar.

Studimet tregojnë se konsumi i mishit si (proshuta, salçiçe) mund të rrisë rrezikun e COPD. Mendohet të jetë për shkak të përmbajtjes së nitritit në mish, të cilat janë njësoj të dëmshme në dëmtimin e mushkërive si tymi i duhanit. Por të dhënat e 50 viteve më parë tregojnë se një konsum i lartë i frutave dhe perimeve është i lidhur me funksionin e mirë të mushkërive. Vetëm një vakt shtesë i frutave çdo ditë mund të përkthehet në një rrezik 24 për qind më të ulët të vdekjes nga COPD. Një dietë me bazë bimore mund të jetë në gjendje për të rritur imunitetin tuaj dhe për të ofruar mbrojtje. Në një studim të vitit 2012 vullnetarët e moshuar që konsumonin pesë ose më shumë vakte frutash dhe perime çdo ditë kishin imuntitet më të shëndetshëm ndaj një vaksine pneumonie krahasuar me 82 për qind të atyre që konsumuan dy ose më pak vakte fruta perimesh në ditë. Duhet të siguroheni që ndryshimet e thjeshta në dietë të ndihmojnë në rindërtimin e dëmit të shkaktuar në mushkëri nga dy faktorë kryesor duhanpirja dhe asma. Hulumtuesit morën një grup duhanpirësish për një kohë të gjatë dhe i kërkuan atyre që të konsumonin 25 herë më shumë brokoli se mesatarja .Krahasuar me duhanpirësit që shmangën brokolin, duhanpirësit që hëngrën brokoli pësuan 41 për qind më pak mutacione të ADN-së në gjakun e tyre gjatë dhjetë ditëve. Në fund të hulumtimit studiuesit arritën në përfundim se është e domosdoshme që dietën e përditshme të futen perimet ku në krye të listës të jetë brokoli e cila quhet ndryshe dhe "perimja magjike", lakra , lulelakra, pra të gjitha perimet jeshile të cilat kanë veti dhe vlera për të ndihmuar në parandalimin e dëmtimeve të mëtejshme të mushkërive. Brokoli është me të vërtetë i pabesueshëm. Studimet tregojnë se mund të ndihmojë në parandalimin e dëmtimit të ADN-së dhe përhapjen e kancerit metastatik. Ai gjithashtu nxit aktivitetin e enzimave detoksifikuese në mëlçi, duke ndihmuar në heqjen e qelizave kancerogjene. Hulumtimet gjithashtu sugjerojnë se mund të aktivizojë mbrojtje kundër patogjenëve dhe ndotësve; ndihmon në parandalimin e limfomës; nxit enzimat që detoksifikojnë mëlçinë, qelizat staminale të kancerit të gjirit,dhe zvogëlon rrezikun e progresit të kancerit të prostatës. Kompoenti kyç i bimës përgjegjës për të gjithë këtë mendohet të jetë sulforaphane, një substancë që formohet pothuajse ekskluzivisht në perimet si lakra brukselit, lulelakra, rukolat etj. Por ka një mënyrë tjetër. Enzima që ju nevojitet për sulforafanin gjendet gjithashtu në pluhur mustardë. Prandaj mund të spërkasësh pluhurin e mustardës mbi brokolin e gatuar.

Perimet si brokoli janë në gjendje të rrisin efektivitetin e një lloji të veçantë të qelizave të bardha të gjakut që është vija e parë e mbrojtjes së zorrëve kundër patogjenëve. Por nuk është vetëm brokoli që është i ngarkuar me përfitime shëndetësore - shumë fruta dhe perime të tjera janë gjithashtu ku mund të përmendin:

Boronicat janë të përbëra nga qeliza që shërbejnë si 'vrasës' natyror që luftojnë kundër viruseve dhe qelizave të kancerit.

Lakra e kuqe, siguron disa nga nivelet më të larta të antioksidantëve tre herë më shumë boronica .

Domatet gjithashtu duket se kanë fuqi të posaçme për rritjen e imunitetit: pirja e lëngut të domates mund të shpëtojë funksionin imunitar të njerëzve të cilët nuk kanë pasur konsumuar fruta dhe perime për dy javë.

Gratë që bëhen nëna në moshën 30-vjeçare, kanë fëmijë më inteligjentë

Disa çifte nuk duan të kenë fëmijë menjëherë, sepse dëshirojnë ta 'shijojnë' jetën për një kohë të shkurtë. Por kur të vendosin të lindin fëmijë, ata janë tejet të gatshëm, ndërsa tani edhe shkenca e ka konfirmuar kohën më të mirë për të lindur fëmijë. Hulumtimet e kryera në Shkollën Londineze për ekonomi kanë studiuar të dhënat e ndryshme dhe kanë konstatuar se gratë të cilat lindin në moshën 30 vjet ose më shumë kanë fëmijë më inteligjentë sesa ato që lindin më herët. Studimi ka analizuar sjelljen e 18,000 fëmijëve britanikë dhe duket se fëmijët me nëna më të vjetra janë më të mirë në aftësitë njohëse. Ata ishin testuar për shkrim, lexim, mendim dhe memorie kur ishin 10 apo 11 vjet të vjetër. Kjo ndodhë për shkak se gratë të cilat vendosin të lindin më vonë, fillimisht ndërtojnë karrierë dhe ia dedikojnë jetën vetes, dhe tek atëherë ndihen të gatshme për të lindur. Si rezultat i kësaj, nënat 30-vjeçe ose më të vjetra u kushtojnë më shumë vëmendje fëmijëve pasi ta kenë një punë të përhershme. Në anën tjetër, femrat të cilat presin shumë gjatë, p.sh. deri në moshën 40 vjet, në vitet e mëvonshme mund të kenë probleme me obezitet.

Lavdëroni fëmijët për mundin, jo për inteligjencën

Hulumtimet e reja tregojnë se fëmijët të cilët marrin lëvdata për inteligjencën, shpeshherë kopjojnë në testime. Këto hulumtime mbështeten edhe nga studimet e kryera nga Carol Dweck, i cili për 40 vite kishte hulumtuar dhe kishte dëshmuar se fëmijët të cilët lavdërohen për mundin e tyre, e jo për aftësitë e tyre, kanë më shumë shanse për sukses sepse janë më të motivuar, transmeton Telegrafi. Nëse fëmijët besojnë se inteligjenca e tyre mund të zhvillohet, ata e kanë më të lehtë të ballafaqohen me pengesa. Hulumtimet e fundit tregojnë se fëmijët të cilët kryesisht lavdërohen për shkak të inteligjencës dhe jo për shkak të mundit, shpeshherë kopjojnë dhe bëjnë hile në teste. Sipas hulumtuesve, lavdërimi i inteligjencës së fëmijëve ua ulë atyre motivimin dhe i "detyron fëmijët të kopjojnë në tekste për të arritur më së shumti pikë sepse presin që të jenë më të mirët".

Koha për Sport
Koha, e hënë 5 shkurt, 2018

Fillim i mbarë i Kaçes

U transferua te Panatinaikos vetëm në ditën e fundit të merkatos, por duket se Ergys Kaçe ka bindur trajnerin Marinos Ouzounidis. Mesfushori i kombëtares shqiptare luajti që nga minuta e parë në sfidën ndaj Panetolikosit, ndërsa qëndroi në fushë gjatë gjithë takimit. Korçari mbajti në shpinë fanellën me numrin 5, në këtë takim që përfundoi në barazim pa gola, ndërsa bëri një paraqitje të mirë, duke marrë edhe vlerësimet e mediave greke. Ergys Kaçe u largua nga PAOK-u në huazim, me synimin për të gjetur sa më shumë hapësira, për të ruajtur vendin në kombëtaren e Panuçit dhe duket se aventura në kryeqytetin helen ka nisur në mënyrën më të mirë të mundshme.

QATIP OSMANI FLET PËR KANALIN ZYRTAR TË KF SHKËNDIJA

I KËNAQUR ME PËRGATITJET DHE PËRFORCIMET

"Mendoj se ia arritëm qëllimit, sollëm disa lojtar kualitativ të cilët mendojmë se do të na ndihmojnë shumë në realizimin e qëllimeve tona. Pra Mevlan Adili, Visar Musliu, janë lojtar që kanë luajtur në Ligën e parë të Maqedonisë, kështu që paraqitjet e tyre në përgatitje ka qenë të mira dhe shihet se mbrojtja po funksionon mirë", shprehet trajneri i Shkëndijës

Shkup, 4 shkurt - Një muaj përgatitje gjatë pauzës dimërore, me Shkëndijën e Tetovës që mbyll edhe mini-fazën e zhvilluar në Antalia. Trajneri Qatip Osmani në një intervistë për kanalin zyrtar të klubit tetovar shprehet i kënaqur me ecurinë e përgatitjeve. "Jam i kënaqur me punën që e kemi bërë deri më tani, pos disa lëndimeve jo serioze. Kushtet i kemi pasur shumë të mira dhe e gjithë puna ka ecur sipas planit që e kemi paraparë", shprehet Osmani, i cili ka vlerësuar afatin kalimtar të janarit. Cekim, Shkëndija ka afruar në janar gjashtë lojtarë të rinj, ndërsa i fundit ishte Visar Musliu, duke u fokusuar kryesisht për blindimin e mbrojtjes. "Pas ndeshjeve të kampionatit vjeshtor ne jemi munduar të përforcojmë mbrojtjen. Mendoj se ia arritëm qëllimit, sollëm disa lojtar kualitativ të cilët mendojmë se do të na ndihmojnë shumë në realizimin e qëllimeve tona. Pra Mevlan Adili, Visar Musliu, janë lojtar që kanë luajtur në Ligën e parë të Maqedonisë, kështu që paraqitjet e tyre në përgatitje ka qenë të mira dhe shihet se mbrojtja po funksionon mirë. Edhe të tjerët janë lojtar të cilët i presim të tregojnë veten si futbollist. Në Tetovë do të na bashkëngjitet edhe Vaikili, mbrojtës i majtë dhe me ardhjen e tij, Shkëndija sa i përket mbrojtjes është e kompletuar", shtoi më tej trajneri i skuadrës tetovare. Ndryshe, Osmani ka folur edhe për ndeshjet miqësore, ku pavarësisht rivalëve si Pobeda, Olimpik Donjetsk apo Dinamo e Zagrebit Shkëndija është paraqitur mjaft mirë duke demonstruar stabilitet. "Fati jonë edhe si trajner është se nuk kemi bërë shumë ndryshime në ekip prej ndeshjes së parë me Pobedën me ata ndeshje që i kemi zhvilluar në Antalia, shihet një cilësi në ekip. Një lojë ku kemi pasur oscilime, por shumë shpejtë janë tejkaluar dhe shumë shpejt ekipi me përvojën e saj ka treguar një cilësi, sidomos në ndeshjen me Dinamon, ku e kemi zhvilluar një pjesë të mirë. Me një fjalë unë si trajner jam i kënaqur me ndeshjet kontrolluese që i kemi zhvilluar në Antalia". Tanimë trajneri Qatip Osmani duket se e ka gati edhe 11-shin titullarë për të përballuar fazën e dytë të sezonit. Derisa, ka folur edhe për objektivat e klubit, ku prioritet është fitimi i titullit kampion. "Përafërsisht po, kam vetëm dy dilema për dy pozita, e cila do ta startojë ndeshjen e parë të sezonit pranveror ndaj Vardarit. Sa i përket objektivave, jemi të gatshëm i realizojmë dhe për këtë kemi një bindje të fortë", përfundoi Qatip Osmani. Ndërkohë, Shkëndija dje u largua nga Antalia ku qëndroi dy javë, me bindje se këto përgatitje do të jenë bazë e fortë për të rrëmbyer titullin e kampionit.

Futbollistja kosovare që ngjan me Ronaldinjon

Futbolli femëror në Kosovë është në hapat e parë të zhvillimit të tij dhe ende duhet të punohet për të krijuar kushte më të mira dhe për të synuar rezultate konkrete në nivel vendi dhe në nivel ndërkombëtar. Një nga diamantet e futbollit femëror kosovar është Jehona Shala e cila ka lindur me 28.05.2001 në Prizren, ajo merret me futboll që gjashtë vite por që dy vite është futbolliste në klubin e futbollit femëror KFF Liria nga Prizreni dhe është anëtare e kombëtares së Kosovës U-19. Ajo shquhet për driblimet, goditjet dhe shpërthimet e saj në mbrojtjet kundërshtare. Ngjashmëria e Jehonës me magjistarin brazilian RonaldinJo e bën këtë futbolliste edhe me të veçantë, ajo është tifoze e skuadrës së madhe angleze Mançester Junajted. Jehona shpreson që së shpejti të depërtoj në arenën ndërkombëtare dhe ta jetësoj ëndrrën e saj për tu bërë një lojtare e famshme.

Krasniqi rikthehet me fitore, mposht polakun Grafka

Boksieri shqiptar, Haxhi Krasniqi, apo Robin, siç njihet më së shumti, arriti të triumfojë në sfidën ndaj polakut Grafka, pas 8 raundesh. Në një atmosferë fantastike, të krijuar nga tifozëria shqiptare, që nuk rreshti së mbështeturi Robin Krasniqin, 30-vjeçari nga Juniku ia doli të zhvillojë një ndeshje mjaft të mirë në 4 raundet e parë, ndërsa në 4 të tjerët ndjeu lodhjen dhe si rrjedhojë, lëshoi terren ndaj kundërshtarit. Gjithsesi, ia doli të ruajë avantazhin fillestar dhe të triumfojë në këtë sfidë. Krahas Robinit, këtë mbrëmje triumfuan edhe boksierët shqiptarë, Elvis Hetemaj dhe Jurgen Uldedaj. Krasniqi rikthehej në ring pas thuajse 10 muajsh, kur humbte përballë gjermanit Arthur Abraham.

Bajrami shënon fitoren e dytë në ringun profesional

Shkup, 4 shkurt - Boksieri shqiptar me prejardhje nga Tetova, Lulzim Bajrami ka shënuar fitoren e dytë në ringun profesional. Ai mbrëmë në Lajpcig të Gjermanisë, u ngjit në ring për të zhvilluar ndeshjen e tij të parë në vitin 2018 dhe nga ajo doli fitues. Bajrami pas katër raundeve me vendim të referëve e mundi gjermanin 34-vjeçar Mazen Girke. Për gjermanin Girke ishte kjo lufta e tij e 108 profesionale. Nga ana tjetër për Bajramin ishte kjo vetëm lufta e tij e dytë në ringun profesionist, ku ka shënuar po aq fitore. Ndryshe, Lulzim Bajrami, mban një rekord sa i përket boksit amator ai ka 41 ndeshje të zhvilluara dhe ka po aq fitore prej të cilave 27 me nokaut.

REALI PËRGATIT ZËVENDËSIMIN E KEJLOR NAVAS

OBLAK, BLERJA E SHEKULLIT

Deri më sot, favoritët për të arritur në portën e "Santiago Bernabeu" ishin De Gea dhe Kourtoa. Por që të dy tentativat rezultuan të komplikuara, derisa sipas "Don Balon" është përqendruar tashmë te një tjetër portier, Jan Oblak

Një bombë e vërtetë. Kjo është ideja e Florentino Perez në tentativën e tij për të zëvendësuar Kejlor Navas, përpara fillimit të sezonit të ardhshëm. Është e qartë që për portën madrilene do të ketë më shumë konkurrencë, por portieri që do të vijë, nuk ka qenë kurrë më parë në listat e të preferuarve. Deri më sot, favoritët për të arritur në portën e "Santiago Bernabéu" ishin David De Gea dhe Thibaut Kourtoa. Por që të dy tentativat rezultuan të komplikuara. E para sepse Mançester Junajted nuk ka asnjë qëllim të lërë të lirë një prej futbollistëve më të mirë, ndërsa e dyta, sepse PSZH është future në garë dhe mund të ofrojë më shumë para. Përpara këtyre problemeve, presidenti i Real, Florentino Perez, të paktën sipas "Don Balon" është përqendruar tashmë te një tjetër portier, Jan Oblak.

Nuk ka dyshim se slloveni është një prej më të mirëve në rolin e tij, dhe është pikërisht ajo që presidenti i Real Madridit po kërkon për sezonin e ardhshëm. Florentino Pérez ka treguar tashmë edhe më parë se nuk do t'ia dijë për paktin me Atletiko Madrid. Në fakt, ai pakt nuk ekziston. Dëshmia është Theo Hernandez, i cili nuk do të vishte fanellën e bardhë, nëse pakti do të ishte i vërtetë. Sot, Oblak është opsioni i tretë, por nëse dy të parët janë të komplikuar, Madrid nuk do të ndalet në luftën për të blerë sllovenin. Padyshim do të ishte një prej blerjeve më të bujshme të viteve të fundit te "Los Blancos".

Eliminimi nga Suedia, zhgënjim i jashtëzakonshëm!

Leonardo Bonuçi gjatë një interviste të gjatë të dhënë për "Vanity Fair", ka risjellë nga kujtesa atë eliminim nga finalet e Kupës së Botës "Rusi 2018", ku Italia nuk do të udhëtojë, për shkak të asaj përballje të dështuar ndaj Suedisë, sikurse dhe finalen e humbur në Kardiff ndaj Real Madridit, nga koha kur aderonte te Juventusi dhe humbi përballë "Los Blancos". "Deri në momentin e fundit mendonim se mund të përsosnim ndeshjen. Ishte një zhgënjim i pabesueshëm edhe për ne futbollistët, por sporti ndonjëherë rezervon zhgënjime të thella. Asgjë nga ato që është thënë në lidhje me pushimin e ndeshjes në finalen e Ligës së kampionëve ndaj Real Madridit nuk është e vërtetë", deklaroi Bonuçi.

Është një nga sezonet më të dobëta të Realit

Sergio Ramos mendon se ky vit është një nga më të dobëtit e Real Madridit. "Los Blancos" janë në vendin e katërt të La Liga-s me 18 pikë më pak se Barcelona kryesuese. Të shtunën skuadra e Zidan nuk arriti më shumë se një barazim 2-2 ndaj në transfertën e Valencias. Ramos autori i golit të parë për të tijtë ndaj Levantes, është mbrojtësi i parë në historinë e La Ligas që shënon në 14 sezone radhazi. "Ne duhet të vazhdojmë të luftojmë dhe të qëndrojmë sa më lart të mundemi. Liga e Kampioneve dhe pjesa tjetër e sezonit duhet të na shërbejë për të riorganizuar grupin", u shpreh Ramos. Numri 4 i Real ndali gjithashtu te diferenca me rivalin historik Barcelonan. "Nuk është normale të jesh në këtë distancë. Kemi bërë diçka gabim duke lënë kaq shumë pikë në ndeshje të cilat i kemi kontrolluar. Ky ka qenë një nga sezonet më të këqija për ne. Skuadra funksionon, askush nuk po fshihet, të gjithë janë përpara dhe kur ke një situatë të komplikuar duhet të mbrohesh, të jesh i bashkuar dhe kjo është mënyra e vetme për të bërë diçka që vlen Ligën e Kampioneve", u shpreh mbrojtësi i madrilenëve. Pas dorëzimit në luftën për titullin e La Liga-s, "Los Blancos" do të jenë tërësisht të përqendruar te Liga e Kampioneve dhe nëse do ta arrinin ky do të ishte trofeu i tretë radhazi, si askush tjetër në historinë e futbollit. Sfida e radhës në skenën më madhore të futbollit evropian në nivel klubesh është ndaj PSG-së në 1/8. Përplasja e parë mes dy gjigantëve të Evropës do të jetë ditën e Shën Valentinit më 14 shkurt në Madrid dhe kthimi në Paris më 6 mars.

Publicitet

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e RM nr. 16/2010), nenit 80, 82 dhe 84 të Ligjit për arsim fillor (Gazeta Zyrtare e RM nr. 103/2008, 33/2010, 116/2010, 156/2010, 18/2011, 42/2011, 51/2011, 6/2012, 100/2012, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 135/2014, 10/2015, 98/2015, 145/2015, 30/2016, 127/2016 dhe 67/2017) dhe Pëlqimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës me numër 12-15235/2 të datës 30.01.2018 dhe Vendimit të Drejtorit të SHFK "Mançu Matak" – Krivogashtani nr. 02-47/1 të datës 1.02.2018, publikohet:

SHPALLJE
Për pranim të kuadrit mësimor dhe jomësimor për kohë të caktuar për vitin shkollor 2017/2018

1. Mësimdhënës të historisë – një (1) realizues me fond prej 16 orëve – me neto pagesë prej 16.500,00 denarë – zëvendësim për u.d drejtorin, por jo më vonë se deri më 31.08.2018;
2. Mësimdhënës të arsimit qytetar – një (1) realizues me fond prej 4 orë, me neto pagesë prej 4.275,oo denarë - zëvendësim për u.d drejtorin, por jo më vonë se deri më 31.08.2018;
3. Një (1) realizues për vendin e punës arkëtar – 40 orë pune, me neto pagesë prej 17.500,00 denarë – deri në kthim të punëtorit në pushim mjekësor, por jo më vonë se deri më 31.08.2018.

- Orari i punës së mësimdhënësve është sipas numrit të orëve nga orari për vitin shkollor 2017/2018;
-Orari i punës së arkëtarit është prej ora 7:00 – 15:00;

Kushtet:
Kandidatët nga pika 1 dhe 2 krahas kushteve të përgjithshme të parapara me Ligjin për marrëdhënie pune duhet të përmbushin edhe kushtet e parapara me nenin 80 të Ligjit për arsim fillor dhe duhet të kenë të mbaruar arsimin përkatës.
Kandidatët nën pikën 3 krahas kushteve të përgjithshme të parapara me Ligjin për marrëdhënie pune duhet të kenë edhe arsim përkatës – shkalla IV e përgatitjes profesionale, drejtimi ekonomik.

Dokumentet e nevojshme:
- Lutje me të dhënat personale dhe të dhënat për kontakt,
- Diplomë ose certifikatë për arsim të mbaruar,
- Certifikatë të lindjes dhe
- Certifikatë të shtetësisë.

Dokumentet duhet të jenë në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter. Të parashtrohen personalisht ose përmes postës në shkollë në adresën: SHFK "Mançu Matak", rr. "Edvard Kardelj" nr. 9 – Krivogashtani. Kontakt telefoni: 070-343418
Shpallja zgjatë 5 ditë pune nga dita e publikimit në shtypin ditor. Zgjedhja do të realizohet më së voni 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e skadimit të afatit për parashtrimin e dokumenteve.
Lutjet e parashtruara pas afatit dhe dokumentacioni i pakompletuar nuk do të shqyrtohen.
Për kandidatët nga pika 1 dhe 2 testimi për njohje të gjuhës amtare do të realizohet më datë 13.02.2018 (e hënë) në ora 9.00 në lokalet e shkollës. Të gjithë kandidatët e paraqitur me dokumentet përkatëse, janë të obliguar të marrin pjesë në testim.

SHFK "Mançu Matak"- Krivogashtani

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e RM nr. 16/2010) dhe Pëlqimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës me numër 12-1119/1 të datës 30.01.2018 dhe Vendimit të Drejtorit të SHFK "Mançu Matak" – Krivogashtani nr. 02-48/1 të datës 1.02.2018, publikohet:

SHPALLJE
Për pranim të mirëmbajtësit të higjienës për kohë të pacaktuar

1. Një (1) realizues për vendin e punës mirëmbajtës i higjienës në SHP f. Sllavej – 40 orë pune, me neto pagesë prej 12.000,00 denarë.

-Orari i punës së mirëmbajtësit të higjienës është prej ora 6:00 – 14:00;

Kushtet:
Kandidatët nga pika 1 krahas kushteve të përgjithshme të parapara me Ligjin për marrëdhënie pune duhet edhe të kenë të mbaruar arsimin fillor.

Dokumentet e nevojshme:
- Lutje me të dhënat personale dhe të dhënat për kontakt,
- Dëftesat për arsim fillor të mbaruar,
- Certifikatë të lindjes dhe
- Certifikatë të shtetësisë.

Dokumentet duhet të jenë në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter. Të parashtrohen personalisht ose përmes postës në shkollë në adresën: SHFK "Mançu Matak", rr. "Edvard Kardelj" nr. 9 – Krivogashtani. Kontakt telefoni: 070-343418
Shpallja zgjatë 5 ditë pune nga dita e publikimit në shtypin ditor. Zgjedhja do të realizohet më së voni 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e skadimit të afatit për parashtrimin e dokumenteve.
Lutjet e parashtruara pas afatit dhe dokumentacioni i pakompletuar nuk do të shqyrtohen.

SHFK "Mançu Matak"- Krivogashtani

URGJENTISHT
Shitet shtëpi në lagjen Serava-Shkup në rr. "7 korriku" nr. 8 afër spitalit gjinekologjik, shtëpia është e ndërtimit të ri me dokumentacion të kompletuar.
Kontakt tel. 070-775-703; 071 372 221

AUBAMEJANG RREZIKON 1 VIT BURG?

Sulmuesi afrikan, në fakt, ka përfunduar në gjyq me akuzën se ka refuzuar t'i nënshtrohej kontrollit të policisë për të verifikuar nivelin e alkoolit në gjak pasi është ndalur nga forcat e rendit 28 qershorin e 2014-ës

Probleme për Pierre-Emerik Aubamejang, i cili sapo është transferuar nga Borussia Dortmund tek Arsenali për rreth 64 milionë euro dhe ka debutuar me gol me fanellën e "Topçinjve" në Premier Ligë. Sulmuesi afrikan, në fakt, ka përfunduar në gjyq me akuzën se ka refuzuar t'i nënshtrohej kontrollit të policisë për të verifikuar nivelin e alkoolit në gjak pasi është ndalur nga forcat e rendit 28 qershorin e 2014-ës. Aubamejang, 25-vjeçar në atë kohë, luante me Borussia Dortmund, por ka qenë në drejtim të Maseratit të tij, në krahinën e Lombardisë, duke ecur me shpejtësi të lartë. Pasi është ndalur nga policia, ai ka refuzuar t'i nënshtrohej kontrollit dhe është identifikuar vetëm falë pasaportës së Gabonit. Ky rast është publikuar në "La Stampa" dhe është kthyer të flitet për të në Novara, por në një sallë gjyqi. Tani, ai rrezikon arrestin dhe një dënim nga gjashtë në një vit burg, përveç një gjobe që mund të shkojë nga 1.500 deri në 6.000 euro. Futbollisti i "Topçinjve", sot 28 vjeç, nuk është paraqitur në gjyq. Policët e rrugores, të intervistuar nga "La Stampa", kanë kujtuar ngjarjen: "Në një moment kemi parë një Maserati që po ecte me shpejtësi shumë të lartë. I kemi bërë shenjë të ndalet dhe shofer ka hapur krahun pas rreth 50 metrash. Dukej se donte t'i shmangej kontrollit. Pas shumë tentativash, kemi arritur ta bindim që të zbresë. Që në momentin që uli dritaren kemi ndier erën e alkoolit; i kishte sytë e kuq dhe nuk qëndronte dot në këmbë". Dhe të mendosh se, me rastin e kalimit të tij tek Arsenal, vetë Aubamejang ka thënë disa ditë më parë: "Ndoshta nuk kam zgjedhur mënyrën më të mirë për t'u larguar, por të gjithë e dinë se Auba është i çmendur! Kam bërë shumë gabime në jetë, por kurrë me dashakeqësi".

"Dorashka inteligjente", risia e radhës në Formula 1

Një dorashkë inteligjente për të monitoruar gjatë gjithë garës shëndetin e pilotit. Kjo është risia e radhës që Federata Ndërkombëtare e Automobilizmit (FIA) do të aplikojë në Botërorin 2018 të Formula 1. Teknologjia e re quhet "dorashka biometrike" dhe në brendësi të saj ndodhet një sensor, i cili monitoron frekuencën kardiake të pilotit, sasinë e oksigjenit në gjak. Kjo "dorashkë biometrike" është testuar nga pilotët e Ferrarit, Mercedes dhe Red Bull në garën e Çmimit të Madh të Hungarisë, një vit më parë. Ky projekt ka si qëllim që të rritë sigurinë e pilotëve, sidomos në aksidentet e rënda, në pritje që komisarët e pistës dhe ndihma e parë të mbërrijë të piloti i aksidentuar. Kjo ide lindi pas aksidentit të Karlos Sainz në Soçi, në garën e vitit 2015, kur ai qëndroi për disa minuta poshtë makinës Toro Rosso pas aksidentit. "Nuk dinim asgjë për gjendjen e tij shëndetësore deri sa e nxorëm nga makina e tij. Nëse do të kishim të dhëna, do të planifikonim edhe më mirë ndërhyrjen, gjë që na e lejon teknologjia e re", tha Ian Roberts, mjeku i FIA-s.



Ëndërroj Botërorin "Rusi 2018"

Pas eksperiencës dëshpëruese në Kinë, me fanellën e Shanghai Shenhua, Karlos Tevez është rikthyer sërish te Boka Juniors. "Apashi" ka rigjetur buzëqeshjen dhe tashmë synon edhe grumbullimin me kombëtaren e Argjentinës për Botërorin e "Rusi 2018". I intervistuar nga "Clarin", ish-sulmuesi i skuadrave të Mançester dhe Juventus, u shpreh optimist mbi shanset për një vend në përfaqësuesen bardhekaltër në botëror. "Jam i sigurt që do të luajë gjithmonë e më mirë, ndihem mirë, jam i lumtur, kam më shumë shanse për të luajtur mirë dhe për të vënë në vështirësi trajnerin, më shumë tani se në 2016. Ndonjëherë nuk e kisha kokën në vendin e duhur dhe nuk përgatitesha mirë për ndeshjet. Kjo ka ndryshuar dhe është e qartë që kam një ëndërr, por për të bërë këtë dhe për të vënë në vështirësi Sampaolin duhet të bëj mirë këtu. A është Argjentina favorite për shkak të prezencës së Messi? Të kesh futbollistin më të mirë në botë të bën favorit", deklaroi Tevez. "Të gjithë i njohin cilësitë e Tevez si futbollist, kur isha trajner doja ta merrja te Sevilja, për të luajtur në Ligën e kampione", tha Jorge Sampaoli.

REVOLUCION NË MOTO GP

Shtatë gara do të jenë më të shkurtra

Jo vetëm në Formula 1, por edhe në Moto GP do të ketë disa ndryshime të rëndësishme për sa i përket Botërorit 2018. Duke nisur nga ky sezon, është vendosur që 7 gara të kampionatit të jenë më të shkurtra se zakonisht. Bordi drejtues i motoçiklizmit ka vendosur që garat të cilat do të zhvillohen në pistat e Austin, La Mansh, Katalonjës, Brno dhe San Marino do të kenë nga një xhiro më pak se vjet, ndërsa në pistën e Jerez do të zhvillohen dy xhiro më pak se një vit më parë. Ndërsa në pistën e Valencia do të zhvillohen 3 xhiro më pak se zakonisht. Ky vendim është marrë pas ankesave që kanë pasur mjaft pilotë në komisionin e sigurisë, ku kanë deklaruar se distanca e gjatë e garës është një problem për sigurinë e tyre në pistë. Kjo masë sigurie është marrë edhe për kampionatet e Moto 2 dhe Moto 3. Në kampionatin e Moto 2 do të jenë 9 gara më të shkurtra se vjet, ndërsa në atë Moto 3 do të jenë 7 gara që do të shkurtohen me nga një xhiro. Kjo ulje e numrit të xhirove në disa pista bëhet edhe për të konsumuar më pak gomat dhe për t'u dhënë mundësi pilotëve të jenë më agresivë në pistë.

Rikthehet Nadal



Tenisti spanjoll Rafael Nadal ka bërë me dije se rikuperimi pas dëmtimit të pësuar në grand slemin e "Australian Open", që e detyroi të tërhiqej në çerekfinale, tashmë i përket të shkuarës dhe se synon të rikthehet në fushën në turneun e Akapulko. "Për fat të mirë nuk ishte dëmtim i rëndë, por ishte një mëkat që u detyrova të tërhiqesha, pasi po luaja mirë. Rikuperimi po shkon mirë dhe dua të jem në formë në turneun e Akapulko, që do të jetë një test i mirë në prag të turneve "Masters" në "Indian Wells" dhe "Majami". Por objektivi im kryesor këtë sezon është të jem sërish më i miri në fushat me dhè", tha Nadal. Nadal ruan kreun e renditjes së përgjithshme, por tashmë diferenca mes tij dhe Rogjer Federer është mjaft e vogël, sidomos pas triumfit të tenistit spanjoll në "Australian Open".

ALBAN MIFTARI, PORTIER

PORTIERI I SË ARDHMES

Albani, portieri shkupjan për gazetën KOHA ka shpalosur detaje se si e filloi karrierën e tij në futboll dhe arsyet se pse zgjodhi rolin e portierit, poashtu ka rikujtuar edhe momente nga fëmijëria e tij. Albani, gjithashtu tregon se kush ka qenë mbështetja e tij më e madhe që e ka drejtuar tek futbolli

Koha — Bujar KURTAJ

Shkup, 4 shkurt - Skuadra e FC Shkupi (ish-Slloga Jugomagnat) gjithmonë ka pasur portier të mirë të cilët kanë lënë gjurmë në ekip, ndërsa ka pasur edhe prej atyre që përkundër talentit nuk iu është dhënë mundësia që të njëjtin ta tregojë. Si rezultat i kësaj ata kanë qenë të detyruar të provojnë fatin në klube tjera. Njëri prej atyre portierëve që e nis karrierën te Shkupi, ku arriti deri në ekipin e parë, por që nuk pati rast ti dëshmojë vlerat e tij, është edhe Alban Miftari. Albani, portieri shkupjan për gazetën KOHA ka shpalosur detaje se si e filloi karrierën e tij në futboll dhe arsyet se pse zgjodhi rolin e portierit, poashtu ka rikujtuar edhe momente nga fëmijëria e tij. Albani, gjithashtu tregon se kush ka qenë mbështetja e tij më e madhe që e ka drejtuar tek futbolli. "Ajo që më shtyri më së shumti që të merrem me futboll me konkretisht si portier ka qenë vëllai im Dardani, i cili gjithashtu është portier. Ai ishte arsyeja pasi doja ti ndjek edhe un hapat e tij dhe ishte inspirimi im për tu marr edhe me futboll. Hapat e par i fillova në shkollën e futbollit F.C. Shkupi ku i kalova të gjitha grupmoshat aty deri në U-19. Deri në këtë rrugëtim kam pasur përkrahje të madhe nga familja, trajnerët si Jeton Musliu, Halim Bilalli, Alisa Vishi, mirëpo ata të cilët më qëndruan pas si në momente të mira poashtu edhe në ato të këqija, ka qenë familja ime, ku pos vëllait Dardanit, ka qenë edhe babai im i ndjerë" rrëfehet për gazetën KOHA, Albani.

ME GRUPMOSHAT DY HERË NË FINALE

Siç thamë Albani te F.C. Shkupi i kaloi të gjitha kategoritë, ndërsa nuk kanë munguar sukseset. "Te F.C. Shkupi i kam kaluar gjitha grupmoshat, ndërsa kemi pasur shumë suksese me gjeneratën tonë kemi arritur dy herë në finalen e Kupës së Maqedonisë, që nuk është një sukses i vogël, sepse deri sa kemi arritur aty, kemi kaluar nëpër shumë sfida të rrënd duke u ballafaquar me skuadra të fortë. Gjithashtu dua të vlerësoj edhe gjysmëfinalen kundër Rabotniçkit, ku pas penalltive, isha unë lojtari vendimtar, duke mbrojtur dy penallti dhe duke bërë që të plasohemi në finale ku aty u takuam me Metalurgun", shtoi më tej Albani, njëri prej portierëve me më perspektivë në Maqedoni.

ME 16 VJEÇ INKUADROHET NË EKIPIN E PARË TË F.C. SHKUPI

Pas paraqitjeve të mirë me grupmoshat, për Albanin vjen ftesa për t'iu bashkuar ekipit të parë, ftesë të cilën ai e ka pritur me shumë kënaqësi. "Me ekipin e parë u inkuadrova që në moshën 16-vjeçare. Ftesën që e mora e prita me shumë kënaqësi, pasi që ishte një ëndërr e imja të jem pjesë e ekipit të parë të F.C. Shkupi. Aty qëndrova plot tre vite duke arritur të inkuadrohemi në Ligën e parë të Maqedonisë si kampion të Ligës së dytë. Fatmirësisht arrita të debutoj për ekipin e parë, mirëpo duke marr parasysh se portieri me përvojë Suat Zendeli ishte titullar, mundësitë për të zënë vendin e tij ishin të vogla. Duke mos dashur të humb unë nga ndeshjet, u detyrova të largohem dhe të kërkoj klub tjetër ku unë do të fitoja më shumë eksperiencë".

"SKOPJE", "FERIZAJ", "LEPENCI"

Pas largimit nga Shkupi, Albani arriti marrëveshje me KF "Skopje", në të cilin siç thonë ai ka arritur të fitojë një eksperiencë të bukur. "Pas largimit nga Shkupi u transferova te KF 'Skopje' edhe atë si portier i parë. Aty kalova një eksperiencë shumë të bukur duke u kurorëzuar me titullin kampion të Ligës së dytë dhe duke u inkuadruar në Ligën e parë. Mirëpo, pasi nuk arritëm të merremi vesh rreth çështjes financiare të kontratës, u detyrova të largohem dhe të transferohem te KF "Ferizaj" në kampionatin kosovar. Në Ferizaj kalova një sezon relativisht të mirë si për mua poashtu edhe për ekipin. Por, tani deri në fund të sezonit jam lidhur me KF "Lepenc" nga Kaçaniku, ndërsa më pas do të tentoj të transferohem jashtë vendit, pasi ky është edhe synimi im kryesor".

SYNON TË NDJEK HAPAT E VËLLAIT DARDANIT

Si çdo i ri edhe Albani ka synimet e tij. Por synimi i Albanit është që të ndjek hapat e vëllait Dardanit, i cili ka pasur një karrierë të pasur duke kaluar nëpër klube të njohura nga vendi dhe rajoni. "Dua që të ndjek hapat e vëllait Dardanit duke pasur parasysh se ai ka qenë portier titullar te F.C. Shkupi, KF Shkëndija, F.C. Prishtina, KF Bashkimi nga Kumanova dhe shumë ekipe tjera elitare. Mirëpo, qëllimi im dhe synimi im është që ta bëj krenar vëllain tim, pra të arrij edhe unë siç arriti ai në karrierë, pse jo edhe më shumë, pra të luaj në ndonjë nga Ligat e njohura evropiane edhe pse jam i vetëdijshëm se kjo arrihet vetëm me punë dhe vullnet", përfundoi Alban Miftari.

DASHI 21. mars - 20. prill

Do bëni çmos qe ta ruani qëndrueshmërinë dhe harmoninë ne jetën tuaj ne çift gjate kësaj dite. Edhe partneri, pavarësisht se nuk do ketë shume kohe te lire, do mundohet t'ua beje qejfin. Beqaret do kenë takimin qe aq shume kane pritur dhe do ndihen me se miri. Financat do jene te mira, kështu qe mund te kryeni investimet qe keni menduar prej kohesh.

DEMI 21. prill - 21. maj

Planetët nuk do kenë ndikim shume te madh gjate kësaj dite ne jetën tuaj ne muft, prandaj ju mund te bëni atë qe dëshironi ne mënyrë qe ambienti te ngrohet me tepër. Beqaret do mbështeten gjithë kohës nga Marsi dhe do e takojnë personin e ëndrrave. Rrethanat do jene te përshtatshme edhe për te përmirësuar buxhetin. Do jeni shume te zotet ne këtë fushe.

BINJAKET 22. maj - 21. qershor

Dita e sotme do jete e mire për te dashuruarit edhe pse pasioni nuk do jete aq i zjarrte sa mendohej. Përfitoni për te folur me partnerin mbi te ardhmen. Beqaret do kenë shume sukses ne dashuri dhe do e gjejnë personin qe do iu përshtatet me se miri. Ne planin financiar do arrini te kryeni investimet e duhura dhe situata do jete serish jo problematike.

GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik

Një klime goxha e ngrohte do mbizotërojë gjate kësaj dite ne jetën tuaj sentimentale. Do e keni me te lehte te flisni lirisht me partnerin dhe do i shprehni ndjenjat qe para disa kohesh nuk keni mundur. Beqaret duhet te presin edhe disa dite për te gjetur dashurinë e madh. Financat nuk do jene ne gjendjen me te mire, prandaj bëni mire te kujdeseni me shume për shpenzimet.

LUANI 23. korrik - 22. gusht

Dite e mbushur me surpriza te shumta kjo e sotmja për ata qe janë ne një lidhje. Shfrytëzojeni ditën deri ne sekondën e fundit dhe pranoni te bëni ndonjë çmenduri te vogël. Beqaret do kenë dashuri me shikim te pare dhe me ne fund do i japin fund vetmisë. Situata financiare do jete e favorshme edhe për te kryer ndenje shpenzim me tepër.

VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator

As mos e mendoni ta tradhtoni partnerin tuaj gjate kësaj dite sepse reagimi i tij nuk do iu pëlqejë aspak. Nëse nuk e doni me mire ja shprehni drejtpërdrejt. Beqaret do kenë takime te ndryshme, por asnjeri nuk do ua mbushe mendjen aq sa për te krijuar një lidhje. Ne planin financiar duhet te bëni shume sakrifica qe te ruani një situate te qëndrueshme.

PESHORJA 24. shtator - 23. tetor

As mos e mendoni ta tradhtoni partnerin tuaj gjate kësaj dite sepse reagimi i tij nuk do iu pëlqejë aspak. Nëse nuk e doni me mire ja shprehni drejtpërdrejt. Beqaret do kenë takime te ndryshme, por asnjeri nuk do ua mbushe mendjen aq sa për te krijuar një lidhje. Ne planin financiar duhet te bëni shume sakrifica qe te ruani një situate te qëndrueshme.

AKREPI 24. tetor - 22. nëntor

Kujdes me xhelozinë e tepruar gjate kësaj dite sepse mund te keni probleme serioze me partnerin. Mos kërkoni ta detyroni atë te qëndrojë vetëm pranë jush, por lëreni te dale edhe me miqtë e ngushte. Beqaret do vazhdojnë te jene ne kërkim, por nuk do e gjejnë personin e duhur. Financat do jene ne gjendje shume me te mire nga sa mendohej.

SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor

Do jeni shume kërkues ndaj partnerit tuaj sot dhe nuk do kënaqeni me aq sa ai do iu japë. Mendohuni njëherë se sa i keni dhënë ju atij. Beqaret nuk duhet te pranojnë asnjë takim për sot sepse personat qe do ua kërkojnë këtë nuk do jene te përshtatshëm për ta. Ne planin financiar do iu pushtoje optimizmi. Pak nga pak do filloni ta përmirësoni buxhetin.

BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar

Dite shume e zakonshme dhe pa asgjë te veçante kjo dite për ata qe janë ne një lidhje. Do vazhdoni ta jetoni jetën ashtu si t'iu vije. Beqaret do kenë një dite te mbushur me takime dhe emocione. Do argëtoheni pa fund me personat qe do njihni. Ne planin financiar mos dëgjoni këshillat e te tjerëve, por veproni ashtu si ju mendoni ne mënyrë qe ta përmirësoni këtë sektor.

UJORI 21. janar - 19. shkurt

Nëse partneri juaj tregohet i rrepte me ju dhe e tepron me ngritjen e zërit tregojani menjëherë vendim, mos prisni qe situata te ndërlikohet edhe me shume. Beqaret me shume gjasa do nisin një histori dashurie te sinqerte dhe te bukur. Situata financiare do jete shqetësuese, prandaj do iu duhet te merrni disa masa strikte ne këtë plan.

PESHQIT 20. shkurt - 20. mars

Nëse kohet e fundit marrëdhënia me partnerin ishte ftohur paksa, sot gjithçka do marre një tjetër drejtim. Do flisni hapur dhe do sqaroni çdo keqkuptim qe keni pasur. Për beqaret nuk ehte momenti i duhur për te filluar angazhime serioze. Prisni edhe pak kohe me tepër. Perspektivat financiare janë goxha te mira. Do shpenzoni aq sa doni dhe serish buxheti do jete i mire.

Mensur Mamuti	AKTORI SHQIPTAR NË FOTO	ROLI I AKTORIT NË FOTO TE "FEJESA"	LLOJ LIKERI ITALIAN	AUTORI I NDJERË KOSOVAR, REDAKTOR I REVISTËS "JETA E RE"
ZOT, PERËNDI				
KOMPOZITORI SHQIPTAR, SIMAKU / ORGANIZATË PALESTINEZE				
H				
XHUDISTJA KOSOVARE, GJAKOVA				
KOMPANI AMERIKANE E KOZMETIKËS				
SILLICIUMI			1000 ROMAK / RRUZULLI I TOKËS	
BORI / ROLI I AKT. NË FOTO TE "NJË TRAGJEDI OPTIMISTE"		BERILIUMI / MONEDHA TURKE		

KOHA	FILM ME AKTORIN NË FOTO	SATELIT I JUPITERIT (SIPAS GALILEUT)	SKLLAV	KOHA	MALËSOR / METRI					
NJË LIDHËZ				ZOTI I INDIANËVE AMERIKANË / AUTORI ANGLEZ, UILJEM						
SHUMË I RI NË MOSHË					JO URBAN / GRUPI ANGLEZ, TOMASI					
ENERGJI		ISH KRYETARI SHQIPTAR, SALI / E NGRATA							ITALIA / BEKIMI	
RELIGJION / KOHA E VEPRIMTARISË SË NJË ORGANI TË LARTË GJATË ZGJEDHJEVE			TRUP GJEOMETRIK / ISLAMIC RESEARCH & EDUCATIONAL FOUNDATION					URUGUAJI / NDËRTUES UTASH		DISKU DIELLOR SIPAS MITOLOGJISË EGJIPTASE
L										
ORGANIZATAT E PUNONJËSVE PËR TË MBROJTUR INTERESAT E TYRE										
HIMNI KOMBËTAR RUMUN "... CULORI" / SHTETI I VETSHPALLUR NË NIGERI VITEVE TË 70-TA					KRYENEÇËSI (SH. PASHQ.) / ANGSTREMI					
B						QYTET BREGDETAR NË ALGJERI				

ZGJIDHJET: ALLAH, THOMA, HAMAS, NORA, AVON, SI, M, B, BE, MALOK, POR, MANITU, RIOSH, RURAL, E, BERISHA, I, FE, KONI, U, LEGJISLATURA, KORPORATAT, TREI, INATE, BIAFRA, ORAN.

Sudoku

shumë i lehtë

9	4	1				3	6	2
					6			
2	5						4	7
				4				
			3		5			
8		3		9		4		1
5	8						1	4
			8					
1	6	2				5	8	3

mesatar

	5		6	8				4
	1			4	3			
								6
	9		4		2			8
4	8						1	3
5			8		1		9	
			3	9			7	
1		9		7	6		8	

Shumë i lehtë: 941587362, 738426195, 256139847, 615748239, 429315678, 873692451, 587263914, 394851726, 162974583. **Mesatar:** 953687124, 618243759, 274915836, 791432568, 486759213, 532861497, 367128945, 825394671, 149576382.

VENDI KU JETOHET MESATARISHT 120 VITE

Në një krahinë malore në Pakistan, njerëzit jetojnë mesatarisht deri në 120 vite. Aty është një fis i tërë për të cilët të jetosh kaq shumë vite është bërë diçka normale. Banorët e Hunzas shprehen se ka disa arsye të cilat ndikojnë në jetëgjatësinë e tyre. Një 116 vjeçare ka treguar se sekreti i jetëgjatësisë së saj është fakti që ajo është beqare dhe nuk ka pranuar të dominohet nga askush. Ata nuk stresohen për gjëra pa rëndësi dhe e marrin jetën me shumë sportivitet. Madje për ata është e zakonshme që të bëhen prindër pas moshës 60 vjeç. Punojnë gjithë kohën, janë aktivë, konsumojnë vetëm produktet që i prodhojnë vetë dhe për një periudhë 2 deri në 5 muaj konsumojnë vetëm lëngun e kajsisë. Ndërkohë ata nuk janë një popull shumë i zhvilluar. Rreth 95% e popullsisë dinë që të lexojnë dhe po ashtu praktikojnë edhe meditimin. Ata, thuajse nuk sëmuren asnjëherë.

Galaxy S9, akoma edhe më i shtrenjtë

Ndërsa më 25 shkurt pritet të dalë në shitje edhe versioni i Samsung, Galaxy S9, që do të shoqërohet në një moment të dytë nga modeli më i madh S9+, kanë filluar edhe aludimet për çmimet që këta dy telefona do të kenë. Pavarësisht se nuk pritet që të ketë diferenca të mëdha nga versionet S8 dhe S8+, modelet e re S9 dhe S9+ do të dalin të paktën 50 dollarë më të shtrenjta. Në SHBA pritet që ato të shiten për 885 dollarë dhe 935 dollarë, por çmimet janë të ndryshme në vende të ndryshme.

Vaksina që zhduk kancerin testohet me sukses

Studiuesit në Universitetin e Stanfordit thonë se kanë testuar me sukses tek njeriu një vaksinë që nxit sistemin imunitar t'u kundërvihet të gjitha formave të kancerit. Bëhet fjalë për një vaksinë të ndërtuar nga kombinimi i dy ilaçeve ekzistuese që ndodhen në treg kundër tumorit. Studiuesit thonë se vaksina, që ndodhet ende në fazë testuese ka dhënë rezultate pozitive në të gjitha rastet kur është provuar tek njeriu. Testimi është i thjeshtë. Vaksina injektohet tek masa tumoriale e pacientit, duke riaktivizuar qelizat e sistemit imunitar të "ringrihen" duke shkatërruar qelizat kancerogjene deri kur masa tumoriale është e shkatërruar e gjitha. Por nuk ndalet me kaq, studiuesit thonë se kanë vënë re që vaksina ka shkaktuar një efekt zinxhir në gjithë organizimin dhe sistemi i imunitetit ka shkatërruar të gjitha format e tumorit në të gjithë trupin.

MERCEDESI SHPËRBLEN PUNËTORËT PAS REKORDIT MË 2017

Pronari i Mercedesit, Daimler, ka shitur numër rekord të veturave më 2017, dhe një pjesë e fitimit do t'u shkojë punëtorëve. Daimler vitin e kaluar shiti gjithsej 3.3 milionë automjete në të gjithë botën, ose 9% më shumë krahasuar me 2016. Një rezultat i tillë reflektoi edhe në bonuset vjetore, të cilat kompania ua paguan punëtorëve të vet, të cilat u rritën me 300 euro krahasuar me një vit më parë dhe arrinin në 5,700 euro.

KALENDARI HISTORIK 5 SHKURT

1488 - Perandori gjerman i Perandorisë Romake Maksimiliani I zihet në Belgjikë.

1512 - Trupat franceze nën Gaston de Foix shpëtojnë Bolonjën.

1649 - Princi i Uellsit emërohet si Mbreti Çarls II.

1663 - Tërmet në Kanada.

1679 - Perandori gjerman Leopold I nënshkruajnë traktat të paqes me Francën.

1783 - Suedia njeh pavarësinë e SHBA.

1859 - Vllahia dhe Moldavia bashkohen nën sundimin e Alexander John Cuza si Principatat e Bashkuara.

1897 - Marcel Proust takon Jean Lorrain në duel me pistoletë.

1900 - Shtetet e Bashkuara dhe Britania e Madhe nënshkruajnë traktatin për Kanalin e Panamasë.

1904 - Përfundon okupimi amerikan në Kubë.

1962 - Kryetari francez de Gaulle fton për pavarësi të Algjerisë.

A E DINI SE...

Kanadaja prodhon aq shumë shurup panje saqë sasia vjetore e tij do të mjaftonte të mbushe-shin 14 pishina olimpike. 9486 milionë gallone të këtij shurupi janë prodhuar vetëm në vitin 2016.



Në Gjirin Hudson në Kanada, graviteti është më ulët se në pjesët tjera të globit. Kështu, nëse një person 68 kilogramësh matet në këtë gji - do të peshojë disa gramë më pak se në pjesët tjera të botës.



Pyjet e Kanadasë do të mund të mbulonin Japoninë, Italinë, Kamboxhian, Nikaraguan, Francën, Gjermaninë, Ganën, Kamerunin, Suedinë, Korenë e Jugut, Uruguain dhe Mbretërinë e Bashkuar.



BARSOLETA

BURRI DHE PSIKIATRI

I ankohet burri psikiatrit:

- Më ndihmo doktor, nuk mund ta shoh më me sy gruan time!

- Po e shoh se paskan përfunduar ditët e mira në lidhjen tuaj. Gjërat do të bëhen keq e më keq. Mendoj se do t'ju ndihmonte nëse shkoni në det.

- Jo bre doktor. E keqja është se ajo di not.

THËNIA E DITËS

Unë nuk i kushtoj vëmendje botës që merr fund. Ka marrë fund për mua shumë herë, dhe pastaj ka rilindur përsëri në mëngjes.

(MAHATMA GANDI)